


HISTORIKU I BANKAVE NË SHQIPËRI

Shoqata Shqiptare e Bankave

Nëntor 2012



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Adresa : Blvd. Dëshmorët e Kombit,
Kullat Binjake, Kullal, kati 6, Tiranë
Tel : +355 4 22 80 371
Fax : +355 4 22 80 359
E-mail : sekretariat@aab-al.org
URL : www.aab.al

Shoqata Shqiptare e Bankave shpreh falënderimet më të mira për bashkëpunëtorët që bënë të mundur realizimin e këtij libri, me kontributin e tyre si vijon:

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi për Pjesën e parë - Periudha 1863 – 1944;
Pedagog Llazi Balliu për Pjesën e Dytë - Periudha 1944 – 1992;
Dr. Spiro Brumbulli për Pjesë e tretë - Periudha 1991- 2012;
Zj. Endrita Xhaferaj për materialin mbi Shoqatën Shqiptare të Bankave;
Prof. Asoc. Dr. Orfea Dhuci dhe Z. Edvin Libohova për Përmbledhjen,
Redaktimin dhe Përshtatjen e Materialit;
Zj. Junida Tafaj (Katrosi) për Koordinimin dhe Mbledhjen e Materialeve dhe Fotove.

Një falënderim i veçantë shkon për z. Artan Lame, Agjencinë Telegrafike Shqiptare dhe Arkivën e Shtetit Shqiptar që vunë në dispozicion materialet dhe fotot për ilustrimin e këtij libri.

Copyright © Shoqata Shqiptare e Bankave, 2012

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet, në asnjë formë ose me çdo mjet elektronik, fotokopjimi ose ndryshe, pa lejen paraprake me shkrim të Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Arti Grafik: Sonila Krashi
Fotograf: Gert Hoxha
Shtypi: Gent Grafik

Tabela e Lëndës

Parathënie	5
Përmbledhje.....	7
Pjesa e Parë: Periudha 1863 - 1944	11
Pjesa e Dytë: Periudha 1944 - 1991	43
Pjesa e Tretë: Periudha 1991 - 2012	71
Shoqata Shqiptare e Bankave.....	107
Bankat Anëtare	113

PARATHËNIE

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) bëri të mundur hartimin e këtij libri me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. I shkruar nga tre akademikë të njohur, ai mbulon historikun e bankave në vend që prej fillimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë deri më sot.

Institucionet e para bankare në Shqipëri ishin degët e Bankës Agrare Turke dhe Bankës (Perandorake) Kombëtare Otomane. Përgjatë viteve, shumë banka të tjera të huaja dhe shqiptare kanë investuar në vend, dhe sot AAB përfaqëson 16 banka të pronësive kombëtare dhe ndërkombëtare. Sistemi bankar shqiptar është i shëndoshë financiarisht dhe ofron një gamë të gjerë të shërbimeve dhe produkteve në përputhje me praktikën bankare moderne.

Unë falënderoj të gjithë ata që kontribuuan për këtë libër, veçanërisht dhe më së shumti tre autorët e tij: Prof. Ksenofon Krisafi, Pedagog Llazi Balliu, dhe Dr. Spiro Brumbulli, të cilët kanë dokumentuar dhe analizuar në mënyrë të shkëlqyer historinë tonë bankare. Mua personalisht, më jep një kënaqësi dhe krenari të jashtëzakonshme, si një turk/shqiptar dhe Drejtor i një banke historia e të cilës shtrihet në pjesën më të madhe të 100 viteve të fundit, mundësia e hedhjes së disa rreshtave në këtë libër.

Unë jam tërësisht i bindur që shekujt përpara nesh do të jenë më të ndritshëm e të begatë për popullin shqiptar dhe bankat do të vazhdojnë të kontribuojnë në këtë drejtim.

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave
Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare

PËRMBLEDHJE

Historiku i bankave në Shqipëri është përgatitur nga Shoqata Shqiptare e Bankave në kuadrin e njëqindvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Qëllimi kryesor i librit është të sjellë, për një rreth të gjerë lexuesish, fakte historike rreth veprimtarisë bankare, kryesisht rreth depozitimit, kreditimit dhe pagesave në Shqipëri. Faktet historike janë grupuar në tri periudha historike: periudha e parë me fakte rreth veprimtarisë bankare deri në vitin 1944; periudha e dytë me fakte historike rreth zhvillimeve në sistemin e bankave në Shqipëri në periudhën 1944 deri në 1991; dhe periudha e tretë me zhvillimet rreth bankave tregtare pas vitit 1991.

Pjesa e parë e librit përfshin historikun e bankave në Shqipëri në periudhën nga fillimet e shekullit XIX deri në vitin 1944 dhe është përgatitur nga Prof. Dr. Ksenofon Krisafi. Autori, në mënyrë kronologjike dhe në përputhje me zhvillimet politike dhe ekonomike, kombëtare dhe ndërkombëtare, trajton përpjekjet, sukseset dhe dështimet për periudha kohore të ndryshme: a) në fund të shekullit XIX dhe fillimet e shekullit XX, b) gjatë dhe pas luftës së parë botërore, c) në periudhën kaotike financiare të viteve 1921-1924, d) në periudhën e viteve 1925-1939 dhe e) në periudhën e luftës së dytë botërore gjatë viteve 1939-1944. Faktet historike të sjella në këtë pjesë të librit nxjerrin në pah vlerësimin dhe përpjekjet e mëdha të autoriteteve si edhe të publikut të gjerë për një monedhë shqiptare, për një sistem bankar shqiptar dhe një sistem pagesash shqiptar.

Autori fakton që, megjithëqë përpjekjet e para për monedhën, pagesat dhe bankat datojnë që në fillim të shekullit XIX, në fakt, vetëm nga fundi i këtij shekulli dhe fillimi i shekullit XX filluan veprimtarinë e tyre institucionet e para bankare me hapjen e degëve të Bankës Agrare (Bujqësore) Turke dhe të Bankës Kombëtare (Perandorake) Otomane. Në fillimin e shekullit XX shfaqen idetë për krijimin e një banke në Shqipëri, ku përveç ideve të rilindësve tanë, shfaqen dhe projektet e para. Natyrisht, me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë u shtua shumë interesimi jo vetëm i shqiptarëve, por edhe i të huajve për ngritjen e institucioneve bankare. Përpjekjet më serioze u bënë nga qeveria e kryesuar nga Ismail Qemali, me një projekt koncesionar për të huajt që rezultoi në ngritjen e bankës së parë në Shqipëri, megjithëse jetëshkurtër.

Me interes të veçantë është projekti i krijimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, një projekt që zë fill në vitin 1922, kur qeveria shqiptare iu drejtua Lidhjes së Kombeve për vlerësimin e mundësive për investime të huaja në Shqipëri, me përfundimet e raportit ku propozohej krijimi i një banke, me dërgimin e ekspertëve të huaj për ngritjen e bankës dhe që mbaron me marrëveshjen përkatëse dhe me fillimin e funksionimit të kësaj banke në vitin 1925. Po interes të veçantë, paraqesin edhe faktet rreth veprimtarisë së kësaj banke deri në vitin 1944. Kjo pjesë e librit paraqet

vështirësitë e shumta ekonomiko-politike të funksionimit të saj, por, në të njëjtën kohë, edhe një sërë arritjesh në fushën e monedhës e pagesave, të mobilizimit të depozitave dhe të kreditimit të ekonomisë.

Por, pas Pavarësisë, deri në vitin 1944, në Shqipëri kanë funksionuar edhe disa institucione të tjera bankare, të cilat përshkruhen me detaje nga autori. Shumë nga këto institucione kontrolloheshin vetëm nga kapitali i huaj, të tjerat nga kapitali i huaj dhe ai vendas.

Pjesa e dytë e librit përfshin periudhën 1944 deri në vitin 1991 është përgatitur nga pedagogu Llazi Balliu. Në këtë pjesë trajtohen me përparësi institucionet bankare me veçoritë përkatëse të tyre si dhe roli që ato kanë luajtur në fushën e mobilizimit të kursimeve të popullsisë, në fushën e kreditimit të ekonomisë (ndërmarrjeve shtetërore dhe kooperativave bujqësore), në fushën e pagesave brenda dhe jashtë vendit, si edhe në fushën e kontrollit të financimit të investimeve.

Banka me e rëndësishme në vend në këtë periudhë ishte Banka e Shtetit Shqiptar. Ajo ishte bankë e shtetit (bankë qendrore), por edhe bankë tregtare. Natyrshëm, duke u nisur nga qëllimi i librit, autori përshkruan vetëm funksionet e saj si bankë tregtare. Fillimisht kjo bankë ka pasur monopolin e kreditimit e të pagesave në Shqipëri, por shkallë-shkallë në përputhje me fazat e zhvillimeve ekonomike ky monopol iu hoq dhe disa nga veprimtaritë e saj iu kaluan bankave të tjera, si për shembull Bankës Bujqësore. Depozitimi nga popullsia i kursimeve të lira ishte një funksion monopol i Institutit të Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve. Ndërsa Banka Bujqësore gëzonte monopolin e kreditimit të ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore. Lidhjet ndërmjet këtyre institucioneve bankare ishin shumë të forta e të kushtëzuara. Depozitat e popullsisë në Institutin e Arkave të Kursimit e të Sigurimeve përdoreshin nga Banka e Shtetit Shqiptar dhe Banka Bujqësore për kreditimin e klientëve të tyre. Instituti i Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve nuk kreditonte ekonominë, kurse dy bankat e tjera nuk grumbullonin depozita nga popullsia.

Në këtë periudhë bankat jo vetëm që ishin shtetërore (kapitali i tyre i përkiste shtetit shqiptar), por ato kishin lidhje shumë të forta me shtetin: financimi i ndërmarrjeve dhe i kooperative bujqësore që ishin dhe huamarrësit pothuajse të vetëm të bankave, ishte ndërtuar në mënyrë që huatë bankare të plotësonin mungesën e fondeve që nuk përballoheshin nga buxheti i shtetit, pavarësisht se bankat mundoheshin që, nëpërmjet produkteve të ndryshme bankare, të kishin njëfarë pavarësie nga shteti. Kjo dëshkohet me disa fakte, si për shembull, me faktin që depozitat e ndërmarrjeve dhe kooperativave pranë bankave mund të prekeshin nga organet e ndryshme shtetërore, apo me faktin që bankat, përveç këshillimit të ndërmarrjeve dhe kooperativave bujqësore në hartimin e planeve financiare, ishin përgjegjëse edhe për hartimin e këtyre planeve, ashtu edhe për organizimin e rregullt të kontabilitetit të tyre.

Rol të madh ka pasur banka dhe në financimin e investimeve apo siç quheshin në atë kohë të investimeve themelore të ndërmarrjeve shtetërore e të kooperativave

bujqësore. Banka ka qenë institucioni që ushtronte kontrollin dokumentar që nga projektimi deri në përfundimin e plotë të investimit themelor jo vetëm për investimet në të cilat ajo jepte hua, por për të gjithë investimet themelore në ekonomi.

Bankat, në këtë periudhë kishin dhe monopolin e shërbimit të pagesave brenda vendit sepse të gjitha ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore kanë qenë të detyruara të mbanin fondet e lira vetëm pranë bankave nga ku bëheshin dhe pagesat përkatëse për të tretët. Megjithëqë veprimtaria e bankave ishte e kushtëzuar nga centralizimi i ekonomisë, bankat kishin zhvilluar mjete pagese debitore dhe kreditore duke dëshmuar për përpjekjet për t'u përshtatur me zhvillimet e vendeve të tjera në këtë fushë. Në fushën e pagesave ndërkombëtare bankat zbatonin të gjitha pagesat e njohura ndërkombëtarisht. Por, kishte edhe forma të tjera pagesash jo shumë të njohura në perëndim (si për shembull kleringu që përdorej brenda bllokut ekonomik lindor).

Pjesa e tretë e librit është përgatitur nga Dr. Spiro Brumbulli dhe paraqet ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të bankave tregtare pas vitit 1991, në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë; jepen me hollësi fakte të tilla si: ndarja e veprimtarisë së bankave tregtare nga shteti, ndarja e funksioneve të tyre nga funksionet e bankës qendrore, procesi i privatizimit të bankave, mbështetja nëpërmjet ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe rregullues të veprimtarisë së bankave, zhvillimi i rrjetit bankar, numri i bankave dhe kuotat e tregut të çdo banke, etj.

Sistemi i bankave tregtare në Shqipëri pas vitit 1991 dallohet për një hyrje shkallë-shkallë, por të konsiderueshme të bankave me kapital të huaj nga vende të ndryshme evropiane dhe vende të tjera. Kjo pjesë e librit me detaje përshkruan historikun e këtyre zhvillimeve duke filluar me banka që hynë në tregun shqiptar nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme, me banka që u futën nëpërmjet një procesi të pastër licencimi dhe me banka që u krijuan me kapital privat shqiptar.

Paraqet interes edhe ecuria e procesit të privatizimit të bankave ish-shtetërore si një nga proceset nga më të suksesshme dhe me rezultate pozitive në ekonominë reale të vendit për arsye se aksionarët e rinj sollën menjëherë kapitale, dije dhe teknologji të reja që patën ndikim shumë të madh edhe në vetë zhvillimin e shpejtë të industrisë bankare në vend.

Ndryshimet ligjore dhe rregulluese gjatë gjithë kësaj periudhe zënë një vend të rëndësishëm në libër. Legjislacioni për bankat ka ndryshuar shpesh, por çdo ndryshim ka qenë në përputhje me zhvillimet e pritshme duke paraprirë, kështu, nevojave të ekonomisë dhe zhvillimeve financiare lokale dhe ndërkombëtare.

Me shume interes është edhe paraqitja e rrethanave, kushteve në të cilat bankat e kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre dhe si ato kanë përballuar vështirësi si: skemat piramidale, disa kriza besimi (jo sistemike) dhe ndikimi i krizës financiare globale. Gjithashtu, lexuesi do të njihet me reforma të ndryshme strukturore që kanë ndihmuar në zhvillimin e shpejtë të bankave dhe përshtatjen e tyre me nevojat e ekonomisë reale dhe industrisë financiare. Po kështu jepet informacion edhe për

kërkesat e autoriteteve rregulluese për kapitalin minimal që duhet të kenë pasur bankat në këto 20 vitet e fundit.

Në këtë pjesë të librit lexuesit do të njihen edhe me reformën në sistemin e pagesave, si edhe me funksionimin e sotëm të sistemit të pagesave me vlera të mëdha dhe me vlera të vogla, por, natyrisht, si një sistem modern pagesash, i njëjtë me sistemet e pagesave në të gjithë vendet e tjera të zhvilluara.

Bazuar në fakte të kësaj periudhe, autori ecurinë e sistemit bankar e ka grupuar të lidhur me tre momente: a) krijimi i bankave të mirëfillta tregtare; b) zhvillimi i bankave pas rënies së firmave piramidale dhe c) zhvillimi i bankave pas nisjes së procesit të privatizimit të bankave shtetërore. Kjo pjesë është pajisur me shumë të dhëna dhe tabela në funksion të fakteve historike dhe pasqyrimin të zhvillimeve më kryesore të sistemit të bankave tregtare në Shqipëri në dy dhjetëvjeçarët e fundit.

Prof. Asoc. Dr. Orfea DHUCI

Periudha 1863 - 1944

I.	Përpyjekjet e para për krijimin e bankave në Shqipëri	13
II.	Pavarësia shqiptare dhe interesimi i të huajve për bankat	16
III.	Bankat në Shqipëri gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore	18
IV.	Situata kaotike bankare e financiare në vitet 1921-1924	19
V.	Projekti për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë.....	21
VI.	Aktet themeluese dhe kushtetimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë	23
VII.	Demarshe nga banka të huaja të tjera për depërtim në Shqipëri	27
VIII.	Filialet e Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe përrurimi i selisë qendrore të saj.....	30
IX.	Fillimi i veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe hedhja në qarkullim e monedhave të para	33
X.	Veprimtaria e Bankës në vitet 1925-1939.....	36
XI.	Banka Kombëtare e Shqipërisë – në kohën e Luftës së dytë Botërore.....	39

.....

Bankat dhe veprimtaria e tyre përbëjnë një ndër shtyllat themelore mbi të cilat mbështetet qëndrueshmëria e një shteti modern. Gjithashtu, bankat janë element i rëndësishëm, *conditio sine quoi non* i shtetformimit. Është kjo arsyeja pse çështja e ngritjes së bankës në Shqipëri u shtrua dhe u trajtua së bashku me gjithë komponentët e tjerë të ndërtimit të ngrehinës shtetërore, që në ditët e para të pavarësisë shqiptare në vitin 1912. E njëjta gjë u përsërit edhe me rastin e ringritjes dhe konsolidimit të shtetit shqiptar pas Luftës së Parë Botërore.

.....

I. PËRDPJEKJET E PARA PËR KRIJIMIN E BANKAVE NË SHQIPËRI

Në territoret shqiptare, pjesë e perandorisë osmane, edhe pse nuk ekzistonin ende banka apo degë të tyre, ishin hedhur në qarkullim dhe përdorshin kartëmonedhat turke të emetuara në vitin 1830, që në fakt ishin disa dëftesa me vlerë, të shkruara me dorë. Në vitin 1842, në kuadrin e reformave të njohura me emrin Tanzimat, nisi shtypja e tyre. U quajtën “kaime-i mutebere-i nakdijje” ose “kaime-i mutebere-i osmanijje”, dhe shërbyen si bankënota të zakonshme për pagesa në dorë.

Kaime 20 Kurush,
pjesa e përparme
dhe e pasme



Kaime 200 kurush, pjesa e përparme.



Kaime me vlerë një kurush.

Veprimtaria konkrete e institucioneve bankare në Shqipëri daton së paku nga viti 1839, kur dëshmohet se degë apo filiale të bankave osmane kryenin veprime në territoret shqiptare. Më 4 shkurt 1863 u themelua Banka Kombëtare (Perandorake) Otomane, statuti i të cilës u miratua në vitin 1875. Në fillimin e shekullit të XX, ajo çeli degët e veta në vilajetet e Janinës (1910), Manastirit (1903), Shkupit (1903) dhe të Shkodrës (1911). Ato funksionuan deri në vitin 1914, kur u mbyllën të gjitha, me përjashtim të degës së Janinës, e cila veprroi deri në vitin 1921. Banka Kombëtare Otomane kishte çelur një degë të vetën edhe në qytetin e Selanikut, ku vepronin dhe kishin bizneset e tyre mjaft shqiptarë. Disa vjet më vonë, në vitin 1888, një tjetër institucion bankar turk, që quhej Banka Agrare (Bujqësore) Turke, përuroi filialet e



Çek i emetuar në Shkodër më 1908 dhe i paguar në Budapest.



Çek i emetuar në Berlin më 1908 dhe i paguar në Shkodër.

veta në qytetet Shkodër, Kavajë, Tiranë, Elbasan, Berat, Korçë etj. Ato vepronin duke zbatuar legjislacionin financiar të Perandorisë Otomane, gjë që realizohej nëpërmjet një mbikëqyrësi të emëruar nga qeveria otomane. Kjo bankë rezultoi e suksesshme dhe mori tiparet e një institucioni modern financiar për kohën e vet. Dëshmohet se vetëm në vitin 1912, në vilajetet shqiptare kishte shpërndarë kredi në shuma të ndryshme, vlera e të cilave arrinte në 6.7 milionë grosh (kurush) ar.

Në trojet shqiptare nuk kishte një institucion qendror financiar që të luante rolin e bankës qendrore, çka shpjegohet me faktin e thjeshtë se ato ishin njësi administrative të Perandorisë Osmane. Është kjo arsyeja pse nuk kishte një sistem unik monetar dhe monedhat shkëmbeheshin me kurse dhe në forma që ndryshonin nga njëri qytet në tjetrin.

Megjithatë, idetë dhe projektet për ngritjen e një banke në Shqipëri nuk kanë munguar. Ato janë mjaft të hershme. Në një retrospektivë të shpejtë historike rezulton se i përkasin gjysmës së dytë të shekullit të XIX, periudhës kur rilindësit shqiptarë hartonin platformat e krijimit të shtetit shqiptar të pavarur, bashkë me programet e zhvillimit ekonomik të vendit. Njëri prej ideologëve më të shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Sami Frashëri, në veprën e tij madhore *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet*, trajton edhe domosdoshmërinë e çeljes së një banke në Shqipëri dhe emetimin e frangut shqiptar si monedha më e përshtatshme për kryerjen e operacioneve të zakonshme monetare. Më vonë, në prill të vitit 1901, avancohet ideja e ngritjes së një banke italiane në Mal të Zi, e cila do të vepronte edhe në Shqipëri. Dy vjet më pas, deputeti italian A. di San Giuliano, propozoi zhvendosjen dhe themelimin e saj në Shkodër. I njëjti propozim u rimor nga italiani Batista Pellegrini, i cili në librin e tij *Drejt luftës? Mosmarrëveshjet mes Italisë dhe Austrisë* - *“Verso la guerra? Il dissidio fra l'Italia e l' Austria”*, botuar në vitin 1906, iu kërkonte qeverisë dhe sipërmarrësve italianë të investonin për ngritjen e bankave në Shqipëri.

Ekonomisti shkodran, Gaspër Guga, do ta konkretizonte më tej idenë e bankës shqiptare në librin me titull *Shqipëria e dy Vilajeteve të Adriatikut. Çështje të morfologjisë dhe të antropogjeografisë në rajonin shqiptar. Marrëdhëniet e saj me Italinë dhe Austrinë. E ardhmja e saj ekonomike* - *“L'Albania dei due Vilajet Adriatici. Appunti di morfologia e d'antropogeografia nella regione albanese. I suoi rapporti con l'Italia e con l'Austria. Il suo avvenire economico”*, botuar në vitin 1909, në Venezia të Italisë. Në vitin 1907, *Banca Commerciale d'Oriente* kishte hapur në Shkodër filialin e vet me emrin *Banca “Tozzi and Company”*.

II. PAVARËSIA SHQIPTARE DHE INTERESIMI I TË HUAJVE PËR BANKAT

Interesimi serioz i bankave të huaja për tregun shqiptar nis me shpalljen e pavarësisë dhe krijimin e strukturave të para të shtetit. Qeveria e Përkohshme e Vlorës, e dalë nga Kuvendi Kombëtar në nëntorin e vitit 1912, shtroi nevojën e ngritjes së një banke në Shqipëri, e cila do të kontribuonte për ta nxjerrë vendin nga prapambetja dhe për të shpejtuar zhvillimin ekonomik të tij, e cila vështirësohej ndër të tjera edhe nga gjendja e vështirë financiare. Ismail Qemali, i cili kryesonte qeverinë shqiptare, mendonte se zhvillimi i shpejtë i vendit nuk mund të arrihej pa ndihmë financiare nga jashtë dhe pa përkrahjen e kapitalit të huaj. Në një bisedë që pati në Vlorë me përfaqësuesin francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Krajevskin, i tha se kishte bërë përpjekje në Londër e në Paris për të marrë kredi për shtetin e ri, por pa rezultat. Ismail Qemali e vlerësonte veçanërisht rolin e bankës, duke e konsideruar themelimin e saj si çlirimin e dytë të Shqipërisë nga pikëpamja ekonomike dhe politike. Në kushtet e pamundësisë objektive për krijimin e saj me forcat dhe kapitalet vendase, ai filloi negociatat me të huajt dhe dha porositë e nevojshme për përgatitjen e bazës së duhur juridiko-institucionale për themelimin e bankës. Qeveria e kryesuar prej tij ndërmori hapat e para, duke iu drejtuar Vjenës dhe Romës. Ajo hyri në bisedime për dhënien e disa koncesioneve, ndër të cilat ishte edhe ai për Bankën Kombëtare. Marrëveshja zyrtare për krijimin e asaj, që do të bëhej e para bankë kombëtare shqiptare, i takon 4 tetorit të vitit 1913. Atë e nënshkroi vetë Ismail Qemali, me Karol Pitner e Oskar Pollak, përfaqësuesit e bankës austriake *Viner-Bank Ferein*, me seli në Vjenë dhe me Pietro Fenolio e Guido Ansbaher, përfaqësuesit e Bankës Tregtare Italiane (*Banca Commerciale Italiana*), me seli në Milano. Marrëveshja koncesionare që do të themelonte atë që njihet me emrin Banka Kombëtare e Shqipërisë, pra e para bankë kombëtare e Shqipërisë, do ta shtrinte vlefshmërinë e saj për një periudhë prej 60 vjetësh. Ajo kishte parashikuar që në qoftë se një vit përpara përfundimit të këtij afati qeveria shqiptare nuk deklaronte mbarimin e vlefshmërisë, ajo ndërpriste veprimtarinë. Në të kundërt marrëveshja do të ripërtërihej dhe do të vepronte edhe për një periudhë tjetër 30 vjeçare. Kapitali do të ishte 10 milionë korona ose 10.5 milionë lira italiane, i ndarë në pjesë të barabarta aksionesh midis të dy grupeve.

Veprimtaria e saj do të drejtohej nga Këshilli Administrativ, në përbërje të të cilit kishte përfaqësues nga të dy palët themeluese. Bankës i ishte njohur e drejta ekskluzive të emetonte bankënota, kartëmonedha të shtypura në gjuhën shqipe dhe në gjuhën frënge. Ajo kishte detyrimin që të krijonte një rezervë në ar, sa një e treta e kartëmonedhave në qarkullim. Banka kishte të gjitha privilegjet dhe funksionet e një banke moderne të mirëfilltë. Ajo ishte agjenti financiar i qeverisë shqiptare brenda dhe jashtë Shqipërisë, kishte ekskluzivitetin e tregtimit për llogari të qeverisë

të bonove të thesarit dhe të letrave të tjera me vlerë të qeverisë shqiptare, kishte të drejtën që të vepronte në fushën e kreditit, të emisionit të obligacioneve të garantuara si dhe të kryente veprime hipotekare.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, qeveria shqiptare, e cila ishte tepër e interesuar për fillimin e menjëhershëm të veprimtarisë së saj, vuri në bankë fondet që dispononte, duke iu kërkuar edhe tregtarëve shqiptarë të depozitonin atje mjetet e tyre të lira.

Jeta e kësaj banke ishte e shkurtër. Ngjarjet që përshkuan jo vetëm Shqipërinë, por krejt rajonin, krijuan vështirësi që shkaktuan mbylljen e veprimtarisë së saj pas pak muajsh aktiviteti.

Më vonë, në vitin 1914, qeveria shqiptare, e kryesuar nga Turhan Pashë Përmeti, e ndodhur në vështirësi të shumta financiare, kërkonte marrjen e një huaje për përballimin e situatës së vendit. Thirrjes së princ Vidit, kryetarit të shtetit shqiptar të asaj kohe, që u caktua nga Fuqitë e Mëdha, iu përgjigjën disa qarqe financiare austriake. Kësaj nisme iu kundërvu Franca, nën pretekstin e pjesëmarrjes së barabartë të fuqive kryesore në kapitalin e bankës. Me projektin e ndërkombëtarizimit të bankës shqiptare u bashkua edhe Italia, çka e detyroi Austrinë të tërhiqej nga ideja e saj fillestare.

III. BANKAT NË SHQIPËRI GJATË DHE PAS LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shqipëria u shkel nga ushtritë e palëve ndërluftuese. Në vend nuk kishte një autoritet shtetëror qendror me kompetenca të njohura e të zbatuara në të gjithë territorin shqiptar. Shteti shqiptar kishte pezulluar ekzistencën e tij. Atributet administrative ushtroheshin nga komandat apo nga autoritetet e ushtrive të huaja që ndodheshin në pjesë të ndryshme të territorit të vendit. Për pasojë, nuk mund të flitet edhe për ekzistencën e një banke qendrore shqiptare. Megjithatë, duke përfituar nga amullia që sundonte në vend, hapën degët e tyre disa banka austriake, siç ishin *Viner Bank Ferein*, për të cilën u fol më lart, *Pester Bank* dhe *Ungarische Bank*. Veprimtaria e tyre u kufizua kryesisht në fushën e kreditimit.

Pas mbarimit të luftës, me ringritjen e shtetit të pavarur shqiptar, ndërsa vazhdonin demarshet për themelimin e një banke shqiptare, qeveritë e asaj kohe e drejtuan vëmendjen edhe në organizimin dhe sistemimin e situatës financiare. Mbi bazën e ligjit Nr. 41, të datës 6 maj 1920, u emetua huaja e brendshme e shtetit shqiptar me prerje 50 franga ari. Huaja përbëhej nga një radhë me 40 000 pjesë të një shume prej 2 milionë frangash ari. Në gusht të po atij viti, qeveria e kryesuar nga Sulejman Delvina, nisi negociatat me përfaqësues të qeverisë italiane për çështje me karakter ekonomik e financiar. Duke iu referuar Bankës Kombëtare të Shqipërisë të vitit 1913, përfaqësuesit shqiptarë theksuan se marrëveshja e krijimit të saj, e tetorit të vitit 1913, nuk ishte më e përshtatshme për kushtet e asaj kohe. U sugjerua që t'i propozohej ndonjë grupi financiar italian për të themeluar një bankë të shtetit shqiptar, me kapital të përbashkët shqiptaro-italian, si person juridik shqiptar. Pati edhe nisma të tjera të cilat përfunduan pa sukses.

Ndërkaq, qeveria shqiptare vazhdonte përpjekjet për vendosjen e rregullit dhe për stabilizimin e situatës financiare e bankare në vend. Në qershor të vitit 1921 u vendos që nxjerrja e të ardhurave shtetërore të bëhej mbi bazën e frangut ar, sipas kurseve që u caktuan për monedhat e tjera që ishin në qarkullim. Në mars të vitit 1922, u miratua ligji për emetimin e kartëmonedhës kombëtare në një shumë prej 3 milionë frangash ar, ligj i cili për shkaqe të ndryshme nuk arriti të hynte në fuqi.

IV. SITUATA KAOTIKE BANKARE E FINANCIARE NË VITET 1921-1924

Në vitet 1921-1924 financat në Shqipëri karakterizoheshin nga një situatë kaotike. Autorë të ndryshëm që kanë trajtuar historikun e bankave dhe të monedhave në Shqipërinë e asaj kohe, si Indro Montanelli, Bernd Fisher, Alessandro Roseli, Haxhi Shkoza, Sejfi Vllamasi, Iljaz Fishta, autorët e botimit “*Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri*”- 2003, Iljaz Fishta dhe Esmeralda Uruçi, etj pohojnë se vazhdonin të qarkullonin monedha të vlerave nga më të ndryshmet e të prejardhjeve më absurde, mbetje të monedhave turke, lira italiane, franga zvicerane dhe belge si dhe korona austriake, dhrahmi greke, dinarë serb, franga franceze, dollarë amerikanë, sterlina angleze etj. E gjithë kjo shumëllojshmëri monedhash ishte një pengesë e madhe që sillte shumë konfuzion në vend, si dhe humbje të pasurisë kombëtare në lidhje me zhvleftësimet e kursit në marrëdhëniet e jashtme.

Krijimi i sistemit monetar e të kreditit ishte evidentuar si domosdoshmëri e kohës. Në vijim të përpjekjeve për përmirësimin e gjendjes ekonomiko-financiare, në qershor të vitit 1922, qeveria shqiptare iu drejtua Lidhjes së Kombeve për të dërguar një ekip ekspertësh me qëllim që të vlerësoheshin mundësitë e vendit për investimet e huaja. Me këtë rast komiteti financiar i Lidhjes dërgoi në Shqipëri Albert Calmes, profesor i Universitetit të Luksemburgut, i cili në shtator të vitit 1922, i paraqiti komitetit në fjalë raportin e hollësishëm mbi situatën financiare. Sipas tij, në Shqipëri në atë kohë, kishte në qarkullim apo të thesarisuara 50 deri në 100 milionë franga ari, duke përjashtuar bizhuteritë dhe objektet e zbukurimit prej ari. Si konkluzion rekomandonte krijimin e një banke emisioni dhe krediti, me kapitale vendase e të huaja. Asaj duhet t’i jepej e drejta që të emetonte dhe të hidhte në treg monedha, e drejta për të kryer veprime krediti etj. Banka duhet të drejtohej nga të huajt dhe do të shërbente si instrument lehtësues për shfrytëzimin e pasurive të shumta që kishte vendi.

Qeveria shqiptare, në përmbushje të funksioneve të saj si dhe për të kontribuar në ringritjen e ekonomisë dhe në stabilizimin relativ të jetës së vendit, në fillimin e vitit 1923 miratoi një ligj me anë të të cilit autorizonte bashkitë e vendit të emetonin provizorisht kartëmonedhat e veta me prerje të ndryshme, në një shumë deri në 80 mijë franga ar. Ligji u vu në zbatim dhe bashkitë e Fierit, Korçës, Shkodrës, Vlorës etj vepruan, përgatitën e hodhën në qarkullim kartëmonedhat e veta. Kjo politikë nuk mund dhe nuk duhej të vazhdonte gjatë sepse binte ndesh me tendencën e përgjithshme që synonte të ndërtonte një shtet të centralizuar shqiptar për t’i bërë ballë situatave të vështira ekonomike e financiare nëpër të cilat ai po kalonte.



Kartmonedha regionale të emetuara nga Bashkitë Shkodër, Fier, Berat, Vlorë, Korçë në vitet 1918-1924 për të përballuar mungesën e kartmonedhës kombëtare.

Në vazhdim të përpjekjeve për ta ndihmuar Shqipërinë për krijimin e sistemit të vet bankar, sipas kërkesës së qeverisë shqiptare, Lidhja e Kombeve dërgoi një vit më vonë holandezin I. D. Hunger për të parashtruar projektin e krijimit të bankës.

Sipas projektit të propozuar prej Lidhjes së Kombeve, sugjerohej që në kapitalin themelues të bankës, të caktuar në shumën prej 5 milionë franga ari, të merrnin pjesë si aksionarë

- Anglia, Franca dhe Italia, me nga 25 % secila;
- Belgjika me 5 %;
- Shqipëria me 10 % dhe
- disa shtete të tjerë me 10 %.

Në të njëjtën kohë, prej qershorit deri në shtator të atij viti, u paraqitën disa projekte për krijimin e një banke kombëtare të Shqipërisë, si nga vendasit ashtu edhe nga të huajt. Janë me interes disa ide të shprehura nga Avni Rustemi në një artikull botuar në një të përditshme, në prillin e vitit 1924. Ai e përfytyronte bankën si një institucion financiar kombëtar me kapital tërësisht shqiptar.

V. PROJEKTI PËR KRIJIMIN E BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË

Ideja u vlerësua tërheqëse dhe interesante sidomos nga Italia, e cila u mundua të shmangte pjesëmarrjen e Anglisë e të Francës. Për këtë qëllim, drejtori i *Credito Italiano*, Mario Alberti, u ngarkua nga qeveria italiane të projektonte krijimin e një grupi italo-zvicerano-amerikan ose italo-zvicerano-holandez, i cili do të sugjerohej në Lidhjen e Kombeve, si alternativa më e përshtatshme për marrjen e koncesionit të themelimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Kapitali i Bankës do të financohej nga Instituti Kombëtar Italian për Shkëmbimet me Botën e Jashtme, duke i siguruar kapitalit italian pjesëmarrje të gjerë dhe pothuajse krejt kontrollin e Bankës. Idetë e mësipërme nisën të konkretizoheshin duke u zëvendësuar partnerët amerikanë apo holandezë me përfaqësues të një shoqërie belge.

Pas një odiseje të gjatë traktativash të vështira u arrit marrëveshja për krijimin e Bankës.

Shqipëria autorizoi Mufid Libohovën, i cili atëherë mbante portofolat e ministrit të financave dhe të zëvendësministrit të jashtëm në qeverinë shqiptare, kurse qeveria italiane Mario Albertin, nëpunës i lartë me titullin Grand Ufficiale dhe njëkohësisht përfaqësues i Grupit financiar Italian. Ata përgatitën marrëveshjen ku do të përcaktoheshin angazhimet e të dyja palëve, objekti i veprimtarisë së Bankës, selia, organet drejtuese, kapitali themeltar, modalitetet dhe procedurat e krijimit dhe të certifikimit të tyre përfundimtar nga organet më të larta të të dy shteteve etj.

Teksti i Konventës që përbënte njëkohësisht edhe aktin bazë të themelimit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, i nënshkruar më 11 mars 1924, ishte formuluar si më poshtë:

1. Grupi Italian i përfaqësuar nga Gr. Uff. Mario Alberti, do të formojë brenda nëntëdhjetë ditëve prej ratifikimit të kësaj konvente "Bankën Kombëtare të Shqipërisë" (Banca Nazionale d'Albania) me një kapital nominal prej franga ari 12,500,000 (dymbëdhjetë milionë e gjysmë), i ndarë në 495 (katërqindnëntëdhjetë e pesë) aksione të zakonshme me një vlerë secili 25 franga ari e në 100,000 (njëqind mijë) aksione themeltare me një vlerë secili prej 1.25 franga ari. Prej një kapitali të tillë nominal 2,500,000 franga ari do të jenë të nënshkruara menjëherë dhe Banka mund të fillojë aktivitetin e saj porsa t'i ketë dhënë provë qeverisë shqiptare se ka dërguar realisht pranë një banke më në zë në Zvicër, shumën prej 2,500,000 franga ari ose ekuivalenten e saj.
2. Shtetasit shqiptarë kanë të drejtën e pjesëmarrjes deri në masën 49 për qind të kapitalit aksionar.
3. Drejtoria qendrore e Bankës do të vendoset në kryeqytetin e Shqipërisë.
4. Kjo konventë ka një afat 50-vjeçar, me të drejtë zgjatjeje sipas një marrëveshjeje ndërmjet të dyja palëve.
5. Banka do të jetë në harmoni me ligjet e shtetit dhe mund të çelë degë, si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë.
6. Banka do të ketë këto të drejta, ashtu si lejohet në konventë:
 - a. të marrë mbi vete çdo lloj veprimi bankar e financiar;
 - b. privilegjin ekskluziv të nxjerrjes së kartëmonedhës, që do të ketë një kurs ligjor e një fuqi të patundshme për pagesat në Shqipëri;
 - c. të depozitohet fondet e shtetit, të ketë shërbimin e thesarit dhe të negociojë huan qeveritare të bashkive.
7. Çdo gjë që nevojitet për ndërtesën, për instalimet dhe për shtrimet në ndërtesat e Bankës, do të jetë e përjashtuar nga detyrimet doganore. Me përfundimin e koncesionit, ndërtesat e Bankës do të jenë në pronësi të shtetit shqiptar, sipas vlerës me të cilën do të çmohen. Çmimi do të përcaktohet nga një i tretë, i cili do të vendoset nga marrëveshja mes shtetit dhe Bankës.
8. Të gjitha kapitalet dhe vlerat private që vendosen pranë Bankës Kombëtare të Shqipërisë, do të jenë të lira prej çdo konfiskimi, direkt apo indirekt nga çdo sekuestrim apo kontroll prej shtetit, përveç rasteve të vendimeve formale ligjore të gjyqtarëve, për shkak se Banka u nënshtrohet ligjeve të Shtetit.
9. Drejtoria qendrore e Bankës, në kryeqytetin e Shqipërisë, do të përbëhet prej dy misave italianë, që do të kenë votën përfundimtare. Dy misat shqiptarë do të emërohen nga qeveria. Derisa Banka nuk do të ketë zhvillimin e nevojshëm, misat e drejtorisë qendrore të lartpërmendur mund të zbriten në dy misa, njeri italian me votë përfundimtare, tjetri shqiptar.
10. Në këshillin administrativ të Bankës, një mis e një komisioner do të përcaktohen nga Ministria e Financave të Shqipërisë.
11. Banka do të përgatisë një rezerve metalike (ar ose argjend, në shufra ose monedha) me vlerë sa një e treta e bankënotave të lëshuara.

Nënshkruar Mufid Libohova - Mario Alberti

VI. AKTET THEMELUESE DHE KUSHTETIMI I BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË

Në vijim, në mars të vitit 1925, u nënshkrua në Tiranë, konventa midis qeverisë shqiptare dhe grupit financiar italian. Ai vendosi kapitalin themeltar, të përbërë nga 100 000 aksione themeluese dhe 15 000 aksione të zakonshme.

Përveç tij, në themelimin e Bankës Kombëtare Shqiptare morën pjesë edhe disa nga bankat më të fuqishme italiane, si:

- *Banca Commerciale Italiana*, e Milanos, me 30 000 aksione të zakonshme;
- *Banca Nazionale di Credito*, e Milanos, me 30 000 aksione të zakonshme;
- *Banco di Roma*, e Romës, me 30 000 aksione të zakonshme; si dhe
- disa banka të tjera më të vogla, me 20 000 aksione të zakonshme.

Në grup përfaqësoheshin edhe

- një holding jugosllav, i përbërë nga *Banka Zadruga* e Beogradit, *Banka serbe* e Zagrebit, *Banka Adriatiko-Danubiane* e Beogradit dhe *Banka Serbo-Shqiptare* e Cetinjës, i cili zotëronte 10 % të kapitalit ose 50 000 aksione të zakonshme;
- disa holdinge të tjerë, si *Banka Tregtare e Bazelit*, me 50 000 aksione të zakonshme dhe *Banka belge me jashtë*, Degë e *Société Générale* të Belgjikës, me qendër në Bruksel, me 25 000 aksione të zakonshme.

Themelues të Bankës Kombëtare Shqiptare ishin edhe disa individë shqiptarë, të cilët zotëronin të gjithë së bashku 30 % të kapitalit. Ata ishin:

- Ajet Bej Libohova me 40 000 aksione të zakonshme;
- Ekrem Bej Vlora, me 58 000 aksione të zakonshme;
- Nexhet Pasha Vlora, me 52 000 aksione të zakonshme.

Krahas tyre ishin edhe italianët:

- Ugo Viali, me 40 000 aksione të zakonshme;
- Vincenzo Azzolini, me 25 000 aksione të zakonshme; dhe
- Massimo Aurelio me 30 000 aksione të zakonshme.

Banka do të kishte një kapital nominal prej 12 500 000 franga ari, që ndahej në 495 000 aksione të zakonshme me vlerë prej 25 franga ari secili dhe në 100 000 aksione themeltare me vlerë prej 1.25 franga ari secili.

Kapitali i përgjithshëm i Bankës numëronte gjithsej 595 000 aksione, ku *Credito italiano* kishte shumicën e aksioneve.

Edhe pse ndarja e kapitalit të Bankës, sipas konventës, ishte 51 % me 49 % në favor të italianëve, më vonë ajo ndryshoi. Pjesëmarrja e palës shqiptare u zvogëlua në shifra minimale. Kuota e nënshkruar nga shqiptarët arriti në 15 384 aksione, numër ky i barabartë me 3.1 % të krejt shumës së përgjithshme të aksioneve të Bankës.

Afati i vlefshmërisë të konventës ishte 50 vjet, me të drejtë zgjatjeje.

Drejtoria qendrore do të vendosej në kryeqytetin e Shqipërisë. Veprimtaria do të kryhej në përputhje me ligjet e shtetit shqiptar. Sipas pikës 11 të Konventës, Banka duhet të krijonte një rezervë metalike në ar ose në argjend, në shufra ose në monedhë, me vlerë sa një e treta e bankënotave të emetuara.

Më 23 qershor të vitit 1925, parlamenti shqiptar miratoi ligjin për rregullimin e monedhës, i cili i njihte Bankës Kombëtare të Shqipërisë të drejtën ekskluzive të nxjerrjes së kartëmonedhave si dhe të drejtën për prerjen e monedhave prej ari e argjendi. Ligji kaloi në Senat, më 5 korrik 1925, kurse më 12 korrik 1925, Ahmet Zogu, me cilësinë e kryetarit të shtetit shqiptar, firmosi dekretin që urdhëronte ekzekutimin e paketës ligjore të fillimit të veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë, të përbërë nga aktet e mëposhtme:

- a) konventa e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, e ratifikuar më 15 mars 1925 dhe e shpallur në Fletoren Zyrtare, më 18 prill 1925;
- b) konventa mbi huan për punët botore të Shqipërisë, prej 50 000 000 franga ari;



Foto Selia e BKS në Romë.

c) ligji organik i Bankës Kombëtare të Shqipërisë;

d) ligji mbi rregullimin e monedhës, me gjithë ndryshimet e bëra prej dy dhomave legislative në konventën dhe në ligjin organik të Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Pas përfundimit të procedurave të nevojshme dhe miratimit të akteve të mësipërme, më 2 shtator 1925, në Romë, në prani të aksionarëve dhe të përfaqësuesve zyrtarë të qeverive italiane, shqiptare e jugosllave, u përrua kushtetimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe u zgjodh Këshilli Administrativ i saj. Ai përbëhej nga këshilltarët administrativë, sindikët efektivë, sindikët plotësues, inspektorët në Romë dhe drejtorët e filialeve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Si këshilltarë administrativë u zgjodhën 8 persona, prej të cilëve 7 ishin të huaj dhe vetëm njëri do të ishte përfaqësues i qeverisë shqiptare.

Banka Kombëtare e Shqipërisë, pavarësisht se në kapitalin e vet themeltar kishte pjesëmarrje edhe nga sipërmarrës të huaj, publikë e privatë, ishte institucion shqiptar. Prova të shtetësisë shqiptare të ish Bankës Kombëtare të Shqipërisë janë një varg elementesh.

Në Këshillin Administrativ bënë pjesë:

- **Këshilltarë Administrativë**

President i Këshillit:

Mario Alberti, ministër i Plotfuqishëm i Italisë;

Zëvendëspresidentë të Këshillit:

Frederico Brunner dhe Chevalier de Wauters d'Oplinter;

Këshilltarë:

Pietro Fenoglio, Giuseppe Bianchini, Lale N.Zuber, Amadeo Gambino; vendi i një këshilltari i rezervuar për qeverinë shqiptare;

- **Sindikë efektivë:**

Vincenzo Azzolini, Ajet Libohova, Francesco Motta;

- **Sindikë plotësues:**

Giuseppe Marino, Massimo Aureli;

- **Inspektorët në Romë:**

Guido Cordova – inspektor; Umberto Picardi – kryekontabilist;

- **Drejtesit e filialeve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë:**

Bashkëdrejtore:

Giulio Gaudenzi dhe Loro Muzhani;

Zëvendësdrejtore:

Armando Battisti, Luigi Magnolli, Ettore Melis;

Prokuratorë:

Ugo Olmastroni, Rafaele Razzini, Francesco Evangelista, Giuseppe Romani, Giuseppe Terrusi.

Së pari, duhet përmendur emri i saj, Banka Kombëtare e Shqipërisë;
së dyti, ishte lloji i aktivitetit, i fokusuar veçanërisht në emetimin e biletave bankare me një kurs ligjor dhe pushtet të lirë që është edhe atributi kryesor i sovranitetit të shtetit;
së treti, vendi i zhvillimit të aktivitetit të saj në territorin shqiptar;
së katërti, vendndodhja e selisë në kryeqytetin e Shqipërisë;
së pesti, vendosja nën juridiksionin shqiptar për trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve që mund të kishte me të tretët dhe, lidhur ngushtë me këtë, detyrimi institucional për të zbatuar legjislacionin shqiptar;
së gjashti, njohja e të drejtës për të pranuar fondet e shtetit shqiptar;
së shtati, misioni për të kryer shërbimin e thesarit shqiptar;
së teti, pjesëmarrja e shtetit shqiptar në të ardhurat e saj dhe ndërhyrja e tij nëpërmjet caktimit të përfaqësuesve të vet në Këshillin Administrativ;
së nënti, publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë e të të gjithë operacioneve të saj më të rëndësishme në *Gazetën Zyrtare* të shtetit shqiptar dhe mbi të gjitha njohja e kësaj Banke me dekret të ish Presidentit të shtetit shqiptar.


Banka Kombëtare e Shqipërisë e kushtetuar juridikisht pas miratimit të akteve themeluese të saj konsiderohet si ringritja dhe vazhdimi i bankës së parë kombëtare shqiptare, të krijuar më 4 tetor të vitit 1913, e cila për shkak të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, funksionoi si e tillë për një interval të shkurtër kohor.

Të vështruara në kuadrin e historikut të bankave në Shqipëri, tetori i vitit 1913 dhe marsi i vitit 1925 shënojnë dy ngjarje me rëndësi të veçantë në zhvillimin e përgjithshëm të shtetit shqiptar, drejt konsolidimit të tij dhe drejt përsheptimit të ritmeve për progresin ekonomik të vendit.

VII. DEMARSHE NGA BANKA TË HUAJA TË TJERA PËR DEPËRTIM NË SHQIPËRI

Gjatë periudhës 1920 - 1939 pati jo pak përpjekje nga të tjera institucione bankare të huaja, për të hyrë në Shqipëri. Duke lënë mënjanë orvatjet e viteve 1920-1925, ndërhyrjet dhe diskutimet e vazhdueshme, në të cilat, siç u tha më lart, u përfshi edhe Lidhja e Kombeve dhe duke u ndalur në fillimet e vitit 1925, nuk mund të mos të përmenden ofertat e kapitalit britanik, francez, belg, zviceran, holandez, jugosllav, grek etj. Përfaqësuesit e tyre, me gjithë vështirësitë e shumta me të cilat iu duhej të përballeshin, i vijuan përpjekjet.

Në shkurt të vitit 1925, ndodheshin në Shqipëri një grup sipërmarrësish britanikë, të Grupit Midland, përfaqësuesit e të cilëve përgatitën edhe skemën e një marrëveshjeje për koncesionin e Bankës dhe propozuan krijimin e Bankës me një kapital prej 500 000 sterlinash. Por bisedimet, të cilat tërthorazi fokusoheshin dhe ngecnin tek çështja e shumës që do të jepej si rryshfet për qeveritarët shqiptarë, dështuan. Një muaj më vonë, në mars - prill të vitit 1925, ishin Banka Serbo-Shqiptare me qendër në Cetinjë dhe Banka e Athinës, që tentuan të vendoseshin në Shqipëri. Banka e Cetinjës e mori autorizimin përkatës më 3 prill 1925, çka u legalizua në maj të po atij viti.



Dokument i BANKA SERBO-SHQIPTARE, Shkodër 1925.



Banka e Napolit, Shkodër.



Banka e Napolit në Tiranë.

Më 6 maj 1934 nisi punën në Tiranë filiali i Bankës së Eksportit, me qendër në Beograd. Në nëntor 1937, mbërriti Banka e Napolit, e cila shumë shpejt do të shndërrohej në një konkurrente të fuqishme edhe të vetë Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Nga ana tjetër nuk kanë munguar përpjekjet e sipërmarrësve shqiptarë për t'u përfshirë së bashku me sipërmarrjen e huaj në iniciativat për krijimin e bankave në Shqipëri. Nisur nga politika që ndiqej ndaj kapitalit vendas nga Banka Kombëtare e Shqipërisë, në fushën e kreditit, në vitin 1927 sipërmarrës shqiptarë të përqendruar sidomos në rajonin e Korçës, bënë publik propozimin për krijimin e një banke me kapitale të përbashkëta.

Në qershor të vitit 1931 vjen propozimi i avancuar nga Mehmet Konica, ish ministër në qeverinë e Ahmet Zogut dhe shkodrani Mark Kakarriqi. Të nxitur edhe nga përfaqësues të sipërmarrësve britanikë, ata propozuan krijimin e një banke anglo-shqiptare, të quajtur "*Anglo-Albanian Bank Ltd*".

Në atë kohë, gjithmonë në kuadrin e përgjithshëm të gjetjes së alternativave të tjera pozitive për zhvillimin e vendit dhe avancimin e tregut bankar e financiar, disa biznesmenë nga Tirana dhe Durrësi formuan një komision të përbërë nga Isuf Beshiri, Aleksander Hobdari, Vlash Dovana etj., për të përgatitur projekt-aktet për themelimin e një banke tregtare të Shqipërisë, me seli qendrore në qytetin e Durrësit. Ishte parashikuar që ai t'i parashtrohej për diskutim paraprak Kongresit të Dhomave të Tregtisë por projekti nuk avancoi dhe përgjithësisht këto orvatje rezultuan pa sukses.

Deri në kohën e pushtimit fashist të Shqipërisë, në vend ishin vendosur dhe operonin Banka Kombëtare e Shqipërisë, e cila kishte 8 degë dhe agjenci, Banka e Napolit, me 4 të tilla, Banka Bujqësore e Shtetit, gjithashtu me 4 degë dhe agjenci dhe filiali i Bankës së Eksportit të Beogradit, e cila kishte vetëm një degë.

VIII. FILIALET E BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË DHE PËRURIMI I SELISË QENDRORE TË SAJ

Banka Kombëtare e Shqipërisë e shtriu veprimtarinë e vet pothuajse në të gjithë territorin e vendit, nëpërmjet hapjes së degëve ose të filialeve të saj. Dega e parë u hap në Durrës më 29 nëntor 1925, më vonë në qytetin e Shkodrës në 1 nëntor 1926, pastaj në Vlorë më 15 nëntor 1926 dhe në vijim në qytetet e Beratit, Elbasanit, Korçës, Prizrenit (pas pushtimit italian të Shqipërisë) dhe Sarandës.

Pas kalimit të rreth 13 vjetëve nga themelimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, në historikun e saj do të shënohej një ngjarje e veçantë. Më 30 tetor të vitit 1938 u përrua selia qendrore e Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, ndërtuar në sheshin "Skënderbej", sheshi kryesor i kryeqytetit shqiptar, Tiranë, çka solli edhe transferimin e saj nga Durrësi në Tiranë. Ajo ishte projektuar nga arkitekti italian Vittorio Ballio Morpurgo. Stili arkitektonik i përket rrymës së racionalizmit, tipik për gjysmën e parë të shekullit të kaluar në Evropë. Ai shquhet për vëllimet e mëdha dhe për linjat e forta në fasada, të cilat dallohen me lehtësi edhe sot në ndërtesën e Bankës së Shqipërisë. Korpusi i saj është ndërtuar në formën e një harku, i detyruar nga pozicioni në hyrje të sheshit kryesor të qytetit. Hyrja kryesore është realizuar me një portal madhështor, të mbështetur në kolona të forta, që përfshin gjithë lartësinë e fasadës dhe është zbukuruar me murale në argjilë të pjekur në ngjyrën karakteristike të saj, që në kompleks i jep një paraqitje shumë dinjitoze godinës. Ajo ishte dhe mbetet një vepër arti dhe një vlerë e spikatur për urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Tiranës.

Në vitin 2011 filloi restaurimi dhe rikonstrukcioni i disa mjediseve të tjera në hapësirën ekzistuese të ndërtesës qendrore të Bankës së Shqipërisë. Ndërhyrjet janë projektuar nga një studio arkitektësh italianë, duke u mbështetur mbi projektet fillestare të saj.



Dega e Bankës Kombëtare në vitet '20, përpara se të ndërtohej selia e re pranë Portit, Durrës.




Dega e Bankës Kombëtare në Vlorë në vitin 1915.



Dega e Bankës Kombëtare në vitet '20, në rrugën e Pjacës, Shkodër.



Dega e Bankës Kombëtare në Vlorë në vitet '20, përpara se të ndërtohej selia e re në Sheshin e Flamurit.



Dega e Bankës Kombëtare në Korçë në vitet '30.

IX. FILLIMI I VEPRIMTARISË SË BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË DHE HEDHJA NË QARKULLIM E MONEDHAVE TË PARA

Më 12 shtator të vitit 1925, Banka nisi veprimtarinë e vet zyrtare. Siç u tha, në Shqipëri, përpara se të krijohet Banka Kombëtare, nuk kishte një sistem monetar kombëtar. Në vend të kartëmonedhave përdorshin monedha ari ose argjendi. Pagesat për shitblerjet e ndryshme bëheshin direkt në napolona floriri ose në korona argjendi. Për këtë shkak, vështirësitë financiare të shkaktuara nga Lufta e Parë Botërore, Shqipëria nuk i provoi në ato përmasa që i kaloi mbarë Evropa. Madje në krahasim me shumë vende të tjera, Shqipëria pati një rezervë të konsiderueshme ari e argjendi, monedha të huaja etj. Kjo do të thoshte se Banka Kombëtare e Shqipërisë nuk e filloi veprimtarinë në vakuum. Megjithatë, autoritetet drejtuese të saj gjykuan me të drejtë se duhej krijuar dhe hedhur në qarkullim monedha zyrtare shqiptare. Ato caktuan që si e tillë të ishte frangu ar, monedhë që u pre me disa nënfisha e shumëfisha. Nënfishat ishin leku dhe qindarka. 1 (një) frang ar ishte baras me 5 (pesë) lekë dhe 100 (njëqind) qindarka, kurse shumëfishat e frangut ishin monedhat prej 5 (pesë), 20 (njëzet) dhe 100 (njëqind) franga ar.



5 Franka Ari, emetim i vitit 1925.



100 Franga Ari,
emetim i vitit 1927,
me portretin
e Ahmet Zogut



100 Franga Ari,
emetim i vitit 1928,
me shqiponjën
dykrenore



Marrëveshja ia kishte njohur palës italiane (grupit financiar italian) të drejtën e emetimit të kartëmonedhave, e cila do të merrte 50% të fitimeve që rridhnin nga prerja dhe hedhja në qarkullim e monedhave, shumë kjo e barabartë me atë që do të merrte edhe shteti shqiptar.

Banka Kombëtare e Shqipërisë do të vepronte në një mjedis specifik, ku njerëzit të ndodhur përpara një shumëllojshmërie monedhash që vinte që prej kohës së Perandorisë Osmane dhe Luftës së parë Botërore, preferonin më shumë të vepronin me monedha prej ari dhe argjendi se sa me kartëmonedha. Prandaj Banka zbatoi të ashtuquajturin standard të cinguar ose standard i arit shufër dhe i devizës, i cili në atë kohë vepronte edhe në vende të tjera. Aplikimi i tij jepte mundësinë që kartëmonedhat të ktheheshin në ar ose në valuta të forta të huaja, si p.sh. në dollarë, në lira, në sterlina, në franga etj.

Banka Kombëtare e Shqipërisë, të cilës i ishte dhënë ekskluziviteti për të emetuar bankënota, në bazë të ligjit për rregullimin e monedhës, do të përkujdesej gjithashtu edhe për emetimin e monedhave prej ari, në prerjet 100 franga ar, 20 franga ar dhe 10 franga ar, si dhe prej argjendi në prerjet 5 franga ar dhe 0.50 franga ar.

Statuti dhe ligji organik i Bankës përcaktonte se kartëmonedhat mund të shkëmbeheshin në valutë ari të shtetit shqiptar, në kartëmonedha të vendeve ku do të shkëmbeheshin, në ar dhe në çeqe. Shkëmbimi në monedha ari të shtetit shqiptar ose në valutë të huaj mund të bëhej vetëm në Durrës, ku ishte selia qendrore e Bankës. Shkëmbimi në monedha ari dhe në valutë të huaj do të bëhej sipas normave të caktuara nga Këshilli Administrativ i Bankës dhe vetëm me autorizimin e tij.

Për të përballuar deficitin e bilancit të tregtisë së jashtme si dhe për të ruajtur rezervat e arit, Banka ndaloi eksportimin e arit jashtë vendit, me përjashtim të sasive të autorizuara prej saj për prerjen e monedhave prej ari të shtetit shqiptar.

Në zbatim të dispozitave të marrëveshjes italo-shqiptare për themelimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë u porositën dhe përgatitën te firma angleze Bradbury Wilkinson & Co. Ltd. në Londër kartëmonedhat dhe monedhat metalike. Sasia e parë e kartëmonedhave u transportua me anije drejt degës së Barit të Banca d'Italia më 19 dhjetor 1926. Kartëmonedhat e para, me një vlerë të përgjithshme prej 5,000 franga ar, me prerje prej 20 frangash ar, u hodhën në qarkullim më 28 shkurt 1926. Gjatë vitit u hodhën në qarkullim edhe kartëmonedha të tjera me prerje 1 frang ar (5 lekë), 5 franga ar, 20 franga ar dhe 100 franga ar. Po në atë vit, në 10 mars 1926 u hodhën në qarkullim edhe monedhat metalike prej nikeli me prerje 0.5 lekë, me një vlerë prej 331,000 franga ari.

Më 31 gusht 1927 u hodh në qarkullim një sasi monedhash ari me prerje 100 franga ar me vlerë prej 27,000 franga ar. Grafiku i hedhjes në qarkullim të kartëmonedhave apo të monedhave vazhdoi gjatë vitit 1928 me 10,095,000 franga ar kartëmonedha dhe 422,000 franga ar monedha. Hedhja në qarkullim e tyre bëri që një sasi e konsiderueshme e monedhave të vjetra të zëvendësohej me monedha të reja, megjithatë përdoreshin dhe qarkullonin ende korona prej argjendi. Tërheqja nga

qarkullimi dhe zëvendësimi i tyre u diskutua për vite me radhë. Kongresi i Tregtarëve Shqiptarë, në mbledhjen e qershorit 1930, arsyetoi se zëvendësimi duhej bërë ndër të tjera edhe sepse mungesa e monedhave metalike bëhej shkak për vështirësi të shumta në transaksionet brenda vendit. Ky fakt kishte sjellë rritjen artificiale të çmimit të koronave të argjendit. Një marrëveshje ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj italiane, e nënshkruar në mars të vitit 1936, vendosi hedhjen në qarkullim në tregun shqiptar të 1 (një) milionë frangave ar, veprim i cili e lehtësonte disi situatën, por nuk e zgjidhte atë.

X. VEPRIMTARIA E BANKËS NË VITET 1925-1939

Banka Kombëtare e Shqipërisë për shqiptarët identifikohet me të drejtë si një faktor i rëndësishëm progresi dhe pavarësimit ekonomik, që duhet të përshpejtonte ritmet e zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe të ndikonte në prosperitetin dhe në mirëqenien e tyre. Por veprimtaria e saj u shoqërua me një ritmikë problematike.

Në vitin 1926, që mund të konsiderohet edhe si viti i parë i fillimit të veprimtarisë së saj, pati një shtim të kënaqshëm të depozitave të Bankës. Ato ishin 1,734,000 franga ar. Nëpërmjet vënies në qarkullim të kartëmonedhave, ajo akumuloi sasi të rëndësishme ari dhe devizash të huaja. P.sh. gjatë periudhës nga tremujori i fundit i vitit 1925 deri më 31 dhjetor 1926, kur u mbyll ushtrimi i parë financiar, ajo emetoi bileta banke kundrejt blerjes së arit në një sasi prej 277.000 franga ari dhe të devizave të huaja të konvertueshme në ar (dollarë, sterlina dhe franga zvicerane) në një shumë prej 2.962.000 franga ari. Gjatë vitit 1927, duke shtuar më tej emetimin e biletave, ajo grumbulloi ar dhe deviza të huaja të konvertueshme në ar, në shumën 13.464.000 franga ari. Ato vazhduan të rriteshin çdo vit dhe në 1936 arritën në 20,775,000 franga ari, që ishte niveli më i lartë deri në atë kohë.

Një pjesë e tyre formohej nga depozitat e enteve publike, të bankave dhe të institucioneve financiare, të cilat përdornin fondin e huas SVEA, të huas prej 100,000,000 franga ar, që iu dha qeverisë shqiptare nga Italia për t'u përdorur për punët botore, për mbulimin e deficitit buxhetor etj. Ndikoi gjithashtu krijimi i fondit për kapitalin e Bankës Bujqësore të shtetit shqiptar, në bazë të akteve përkatëse të miratuara nga qeveria shqiptare, përkatësisht në maj 1930 dhe në dhjetor 1936. Në depozitat e Bankës u arkëtua pothuajse e gjithë sasia e monedhave të forta që qarkullonin në tregun shqiptar, e cila në vitin 1922 ishte vlerësuar, siç u tha, ndërmjet 50 deri në 100 milionë franga ari. Ajo grumbulloi gjithashtu devizat e huaja që hynin në Shqipëri çdo vit, veçanërisht ato që dërgonin emigrantët, të cilat në atë kohë vlerësoheshin në rreth 6.000.0000 dollarë amerikanë në vit. Nëpërmjet operacioneve të ndryshme të ndërmarra nga Banka, grumbullimit të objekteve prej ari e argjendi, sendeve të zbukurimit, bizhuterive etj, rriteshin gjithashtu rezervat e arit që depozitoheshin në kasafortat e Bankës.

Më vonë ecuria e kësaj rritjeje jo vetëm që do të ngadalësohej por do të binte në nivele tepër të ulëta. P.sh. në vitin 1938 depozitat kishin zbritur në nivelin e 12,155,000 franga ari.

Duhet shënuar se në vitet 1925-1939 Banka investoi një pjesë të rëndësishme të mjeteve të veta monetare në obligacionet dhe në titujt e tjerë të shtetit italian. Për të krijuar një ide të përmasave të kësaj veprimtarie, mjafton të përmendim se nga 5,300,000 franga ar që ishin në vitin 1926, investimet e Bankës Kombëtare të Shqipërisë në titujt e shtetit italian arritën në 8,500,000 franga ar në vitin 1938.

Në këtë kohë Bankës iu drejtua edhe qeveria shqiptare, e cila i kërkoi dhënien e një huaje modeste prej 2,500,000 franga ar për të përballuar nevojat e buxhetit të shtetit, por përgjigja ishte negative. Politika e kreditit e Bankës synonte të mbështeste kryesisht veprimtarinë e bizneseve italiane në industri, bujqësi, ndërtim, tregti etj, por pa lënë pas dore edhe disa tregtarë shqiptarë, sidomos ata që kishin marrëdhënie preferenciale me entet italiane.

Të dhënat mbi bilancet e çdo ushtrimi financiar të Bankës, prej vitit 1926 e deri në vitin 1943 dëshmonin se emetimi i biletave bankare bazohej kryesisht në depozitat e kursimeve të shqiptarëve, në blerjet e arit dhe të devizave të huaja, si edhe në operacionet e kreditit. Kohët e fundit të aktivitetit të saj, Banka Kombëtare Shqiptare kishte në aktivin e bilancit të vet një shumë prej 8.062.826 franga ari, e cila ishte mbulesa e biletave bankare që Banka kishte vënë në qarkullim. Si të gjitha bankat e emisionit, edhe ajo gëzonte të drejtën që të emetonte kartëmonedha, të cilat kishin vlerë ligjore brenda vendit. Kjo e drejtë do të përdorej duke ruajtur një raport proporcional midis sasisë së kartëmonedhave të emetuara dhe rezervës në ar e argjend. Ashtu si për mjaft shtete edhe në Shqipëri ishte vendosur rregulli që "Banka do të ruante një rezervë në metal (ar dhe argjend, në monedha dhe në shufra) me një vlerë të barabartë me 1/3 e biletave bankare të emetuara." Ai ishte fiksuar edhe në nenin 11 të konventës së përfunduar midis grupit financiar italian dhe qeverisë shqiptare, më 15 mars 1925, si edhe në nenin 22 të Statutit të Bankës.

Në vitin 1927, Amadeo Gambino, anëtar me ndikim në Këshillin Administrativ të



Librezë Kursimi - BANKA KOMBËTARE E SHQIPNIS, Tiranë 1937.

Bankës, duke mbajtur parasysh nivelet e varfërisë, çeqet në qarkullim dhe ritmin e ulët të qarkullimit monetar, dilte në përfundimin se në Shqipërinë e asaj kohe çdo shqiptari i mjaftonte një qarkullim monetar mesatar në vlerën e 25 franga ar, çka do të thoshte se sasia e përgjithshme e monedhës duhet të ishte rreth 20 milionë franga ar. Kjo sasi, sipas tij, do të vinte duke u rritur bashkë me zhvillimin ekonomik, duke arritur në 45 - 50 franga ar për person, ose një sasi të përgjithshme prej 32 - 40 milionë franga ar, e cila nuk u arrit.

Veprimtaria dhe ecuria problematike e mëvonshme e Bankës do të ndikohej edhe më tej nga kriza e përgjithshme botërore e viteve 1929-1933. Pasojat e saj në Shqipëri vazhduan deri në mesin e vitit 1935. Frangu shqiptar u zhvleftësua me 5-6%, çka shkaktoi panik tek tregtarët dhe industrialistët, të cilët filluan të shkëmbenin kartëmonedhat me monedha ari shqiptare.

Të dhëna të ndryshme dëshmojnë se përpara Luftës së Dytë Botërore, frangu shqiptar ishte ndër monedhat më të forta në Evropë. P.sh., në vitin 1939, qarkullimi monetar kishte një mbulesë në ar dhe në valuta të huaja të forta prej 245.93 %, nga e cila vetëm në ar 71.94 %. Ekspertët e kohës kanë arsyetuar se kjo mbulesë e fortë shpjegohet pikërisht me politikën deflacioniste që ndiqej nga Banka Kombëtare e Shqipërisë, e cila shprehej ndër të tjera në mbajtjen e monedhës në qarkullim nën nivelin e nevojave të vendit, në grumbullimin e detyruar të arit dhe të argjendit shqiptar, në rritjen e vlerës së frangut dhe rishpërndarjen e të ardhurave kombëtare. Duke iu referuar gjuhës së shifrave, kjo politikë deflacioniste shprehej në zvogëlimin e sasisë së monedhave në qarkullim. P.sh. nga 14 020 000 franga ari që ishin në qarkullim në prill të vitit 1933, sasia zbriti në 10 529 000 franga ari në vitin 1938. Ose nga rreth 325 000 franga ari që shkëmbeheshin mesatarisht çdo vit, në vitet e para të veprimtarisë së Bankës, u arrit në rreth 8 000 franga ari në vit në periudhën 1932-1933, për të zbritur në 2 220 franga ari në vit në periudhën 1934-1935. Politika deflacioniste do të vazhdonte edhe më vonë.

XI. BANKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË – NË KOHËN E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Pas 7 prillit 1939, veprimtaria e Bankës Kombëtare të Shqipërisë kushtëzohet nga rrethanat e veçanta të pushtimit të vendit. Formalisht Banka iu nënshtrua veprimit të dispozitave të konventës ekonomiko-doganore dhe valutore, shqiptaro-italiane. Ajo sanksiononte ndryshime serioze në sistemin monetar dhe të kreditit në Shqipëri, i cili tashmë u shndërrua në një shtojcë të sistemit monetar dhe të kreditit italian. Grupe të ndryshme bankare që vepronin në Shqipëri në këtë kohë, duke përfutur nga rrethanat e veçanta të luftës, u përfshinë në një konkurrencë të fuqishme për zotërimin e sistemit të kreditit. Ato synonin sidomos zgjerimin e rrjetit bankar në vend, tërheqjen e depozitave bankare, shpërndarjen e kreditit bankar etj. Në këtë konkurrencë, Banka Kombëtare e Shqipërisë bëri përpjekje të shumta që të ruante pozitën dominuese në tregun bankar e financiar, duke rritur numrin e degëve dhe të agjencive në qendrat kryesore, me popullsi më të madhe në vend. Ajo përballonte me vështirësi të mëdha konkurrencën e shtuar që i vinte nga fuqizimi i Bankës së Napolit, e cila kishte filluar veprimtarinë e vet në Shqipëri që në vitin 1937.

Në atë kohë vihen re edhe një varg zhvillimesh, disa prej të cilave ndikuan në jetën dhe funksionimin e bankave në Shqipëri. Duhet përmendur së pari thithja, në majin e vitit 1939, e Bankës Bujqësore të Shtetit nga ana e Bankës së Napolit, e fuqizuar së tepërmi gjatë kësaj kohe dhe mbyllja në vitin 1939, e filialit të Bankës së Eksportit të Beogradit, që ishte goditur rëndë nga efektet e konkurrencës së imponuar.

Zhvillim tjetër ishte hapja në Tiranë e filialit të Bankës Kombëtare të Punës (*Banca Nazionale del Lavoro*), e cila u shndërrua shumë shpejt në një konkurrente të fortë të Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe të Bankës së Napolit.

Ndërkohë, në fillimin e vitit 1941, u hodh për diskutim shtrirja e veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë edhe në territorin e Malit të Zi. Kjo nismë parashikonte hapjen e filialeve të saj në Cetinjë e në Tivar dhe me pas krijimin e një banke shqiptaro-malazeze, e cila do të emetonte një monedhë të përbashkët të quajtur *ALMO*, shkurtim i emrave Albania dhe Montenegro. Projekti nuk u realizua.

Periudha e Luftës i imponoi Bankës Kombëtare të Shqipërisë ndjekjen e një politike inflacioniste, që çoi në rritjen në përpjesëtime të mëdha të sasisë së monedhave në qarkullim. Bilanci i 31 dhjetorit 1944 i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, tregon se kjo shtesë ishte 381 592 000 franga shqiptare. Domethënë nga 11 939 000 franga shqiptare që ishte sasia e monedhës në qarkullim me 6.4.1939, kishte arritur në 393 492 000 franga shqiptare më 31.12.1944.

Me kapitullimin e Italisë, autoritetet italiane në largim e sipër, më 11 shtator 1943, urdhëruan pezullimin e veprimtarisë së bankave në Shqipëri, me përjashtim të disa operacioneve të kufizuara që mund të kryente Banka Kombëtare e Shqipërisë.

Urdhri, fuqia vepruese e të cilit zgjati deri më 20 shtator 1943, paralizoi krejt sistemin bankar në vend dhe shkaktoi dëme të mëdha në ekonominë shqiptare. Në



Banka Kombëtare e Punës (Banca Nazionale del Lavoro) në Tiranë në vitin 1940.

zbatim të tij, bankat ndaloheshin t'u kthenin klientëve depozitat e veta dhe të hapnin depozita të reja. Llogaritë rrjedhëse bankare u konsideruan të ngrira dhe nuk mund të bëhej fjalë për funksionimin e sistemit të kreditit bankar e për dhënie kredish. Dy bankat italiane që vepronin në atë kohë në vend, Banka Kombëtare e Punës dhe Banka e Napolit, përfunduan veprimtarinë dhe praninë e tyre në Shqipëri. Banka Kombëtare e Shqipërisë, e cila vazhdonte të funksiononte, ishte në kushte të vështira për shkak të situatës së krijuar nga pushtimi nazist i vendit.

Në 12 shtator 1943, hynë në Shqipëri ushtritë gjermane. Sipas urdhrimit të Komitetit të Përkohshëm Ekzekutiv të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, rifilloi veprimtaria e saj duke u orientuar kryesisht në financimin dhe në kreditimin e komandës ushtarake gjermane dhe të qeverisë që ishte instaluar në vend. Wehrmacht-i gjerman deri në fund të vitit 1943, mori 50 milionë franga shqiptare kredi, kurse deri në tetorin e vitit 1944, ushtria gjermane mori edhe 99 milionë franga ari kredi. Banka Kombëtare e Shqipërisë u detyrua të kthehej në financuesin e vetëm të Wehrmachtit dhe trupave ushtarake gjermane.

Autoritetet gjermane, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të tyre, urdhëruan gjithashtu edhe marrjen e rezervës në ar, të rezervës së kartëmonedhave, të klisheve të stampimit dhe të rezervave në devizë, të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, që ndodheshin të depozituara në Romë. Kartëmonedhat u nisën me avion për në Tiranë, kurse ari, argjendi dhe klishe të stampimit u dërguan në Berlin. Më 16 shtator 1943, organi drejtues i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, i quajtur Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm, miratoi urdhrin "Mbi rregullimin e raporteve midis shtetit shqiptar dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë", sipas të cilit Banka do t'i kalonte shtetit shqiptar gjithë fitimin e saj, kundërvleftën e monedhave divizionale në qarkullim deri në 10 shtator 1943, do të derdhte 4 % të shumës së kartëmonedhave në qarkullim deri në 10 shtator 1943, etj. Më 3 nëntor 1943 u kërkuar që rezerva e arit që u mor në Romë, më 16 shtator 1943 dhe u depozitua në Berlin, t'i kthehej Shqipërisë. Në muajt nëntor-dhjetor 1943 u zhvilluan në Berlin bisedime shqiptaro-gjermane për problemet ekonomiko-bankare, në të cilat u diskutua për kthimin në Shqipëri të thesarit (rezervës në ar, argjend etj.) të Bankës të devizave dhe klisheve që u morën në Romë, për huat, kursin e shkëmbimit midis frangut shqiptar dhe markës gjermane etj. Diskutimet vazhduan pa rezultat edhe disa herë të tjera gjatë gjysmës së parë të vitit 1944.

Në muajt shtator – nëntor 1943, Banka Kombëtare e Shqipërisë, e urdhëruar nga autoritetet ushtarake gjermane u detyrua t'iu jepte atyre edhe disa dhjetëra milionë franga shqiptare në formë "huaje". Gjatë vitit 1944 ajo vazhdoi financimin e ushtrive gjermane, të cilat më 30 tetor 1944 morën krejtësisht thesarin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë si dhe gjithë rezervat e gjetura në franga ar dhe në franga shqiptare në degët e Bankës në Vlorë (ku ishin edhe rezervat e degëve të Gjirokastrës e të Sarandës), në Korçë, Berat, Elbasan, Prizren, Shkodër, Tiranë etj.

Përgatiti: Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Periudha 1944-1991

I.	Banka e Shtetit Shqiptar	44
i.	Kreditit bankar	47
ii.	Kontrolli bankar për financimin e investimeve themelore	56
iii.	Sistemi i pagesave me xhirim në llogari	57
iv.	Organizimi i pagesave ndërkombëtare	59
II.	Banka Bujqësore.....	61
III.	Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit.....	63
IV.	Instituti i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve.....	64
V.	Banka e Kursimeve	66
VI.	Banka Shqiptare e Tregtisë.....	67
VII.	Rrjeti i Bankës së Shtetit Shqiptar sipas viteve.....	69

I. BANKA E SHTETIT SHQIPTAR

Çlirimi i vendit më 29 Nëntor 1944, e gjeti Shqipërinë në një gjendje, jo vetëm shumë të prapambetur ekonomike dhe kulturore, por edhe të shkatërruar rëndë nga lufta. Shqipëria hyri në një periudhë të re historike. Në këto rrethana, një nga problemet me të ngutshme ishte normalizimi dhe rindërtimi i gjithë jetës ekonomike e kulturore të vendit. Për zgjidhjen e problemeve të shumta, përveç të tjerash, nevojiteshin mjete të shumta materiale e financiare.

Pak ditë pas çlirimit të Tiranës, Këshilli Nacionalçlirimtar i qarkut, me porosi të Qeverisë së Përkohshme Antifashiste, në atë kohë me seli në Berat, vendosi bllokimin e veprimtarisë së Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Njëkohësisht u bllokuan edhe arkivat e këtij institucioni dhe një repart i ushtrisë partizane mori në ruajtje godinën e Bankës Kombëtare.

Një ndër aktet e para të miratuara pas çlirimit, lidhet me aktivitetin e Bankës. Më 15 dhjetor 1944, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar miratoi ligjin nr. 20, datë 15.12.1944, i cili ndalonte eksportimin e arit, të argjendit, të platinës dhe të gurëve të çmuar. Ligji synonte frenimin e inflacionit të mëtejshëm të frangut shqiptar, goditjen e kontrabandës së arit në tregun e brendshëm dhe moslejimin e daljes së tij jashtë kufijve të vendit.

Po më 15 dhjetor 1944 u vendos edhe kontrolli shtetëror mbi prodhimin dhe shpërndarjen, që mund të konsiderohej edhe si masë përgatitore për shtetëzimin e mjeteve kryesore të prodhimit. U shtetëzuan minierat dhe pasuria e të arratisurve politikë dhe një muaj më vonë u miratua ligji mbi konfiskimin e pasurive të shtetasve italianë e gjermanë në Shqipëri. Pasuria e 111 shoqërive aksioniste të huaja kaloi pa shpërblim në pronësi të shtetit shqiptar.

Më 13 janar 1945, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar miratoi ligjin **mbi anulimin e konvencionit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë** dhe të aksioneve të saj dhe në të njëjtën kohë ajo u shtetëzua. Shteti nuk njohu detyrimet e ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë kundrejt të tretëve për depozitat në ar dhe në valutë të huaj, dhe u anulua marrëveshja e marsit të vitit 1925, ndërmjet Qeverisë së Ahmet Zogut dhe grupit financiar italian.

Po më 13 janar 1945, u miratua ligji organik për **Bankën e Shtetit Shqiptar**, me 8 kapituj dhe 26 nene, i nënshkruar për Kryesinë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar nga kryetari Dr. Omer NISHANI dhe nga sekretari Koço TASHKO. President i BSHSH u emërua Sejfulla MALËSHOVA, ndërsa Drejtor i Përgjithshëm Kostandin BOSHNJAKU, i njohur për aftësitë e tij profesionale dhe organizative. Ai ka lënë mbresa të pashlyeshme në kujtesën e ish-punonjësve të Bankës së Shtetit dhe është kujtuar me respekt edhe nga brezat e mëvonshëm.

Gjatë vitit 1945 u morën edhe 2 vendime specifike për mbylljen e veprimtarive të bankave të huaja në Shqipëri. Më 12 gusht u mbyll dhe u likuidua Banka Kombëtare

BANKA KOMBËTARE E SHQIPNIS

BANKA E SHQIPTAR
BANCA NAZIONALE D'ALBANIA

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

KAPITAL Fr. A. 12.500.000 CAPITALE

Tirane 1 Janar 1946

DREJTORISË SË DEGËS S'ONË

SHKODER

PERSONELI

Shtesë vjetëraie konvencionale dhe rroga

Z. Asim Ijokajt.-Nëpunës. i I. rë

Në bazë të Qarkores "Personeli" Nr.5 bis datë 14 Shta -
tuer 1945, të naltparmenunit i shtohet vjetërsija konvencionale
për periudhën e shërbimit gjashtëmuor, prej datës 1 Korrik deri
ne datën 31 Dhetuer 1945, si edhe për klasifikimin "shum i mirë"
gjithashtu dhe rroga, konform tabelës së orientimit të caktimit
të rrogave, si vijon :

.....6..... muej për periudhën e shërbimit-nga data 1 Korrik deri ne
31 Dhetuer 1945.

.....=..... muej për klasifikim "shum i mirë".

.....6..... +.....4.....vjet e6.....muej gjithsejt vjetërsi konvencio-
nale.Si mban vjetërsisë në fjalë rroga bazë FrShq.....1.100.....=.....

plus shtesë për kualifikim grade "=.....
Gjithsejt rroga bazë shuma Fr.Shq.....1.100.....=.....

Shtesa e vjetërsisë dhe e rrogës konsiderohet qysh prej
datës 1 Kallnuer 1946.-

DREJTORIJA E PËRGJITHSHMË

KORRY VETEMORATIKET } PËRTRIMORË TË
KORRY VETEMORATIKET } PËRTRIMORË TË
(MASHINARA KORRY VETEMORATIKET)
KORRY VETEMORATIKET } PËRTRIMORË TË
KORRY VETEMORATIKET } PËRTRIMORË TË

Dokument i vitit 1946 që pasqyron kalimin nga BANKA KOMBËTARE E SHQIPNIS në BANKA E SHQIPTAR (shiko vulën e kuqe)

e Punës (Banca Nazionale del Lavoro) dhe me 6 nëntor u mbyll dhe u likuidua edhe Banka e Napolit (Banca di Napoli).

Më 21 janar 1945, u zhvillua ceremonia e përrurimit për Bankën e Shtetit Shqiptar. Fjalën e rastit e mbajti Sejfulla Malëshova, në cilësinë e Presidentit të saj.

Banka e Shtetit Shqiptar e filloi veprimtarinë e saj me 22 janar 1945, brenda 10 ditëve nga miratimi i ligjit. Administrimi i Bankës së Shtetit Shqiptar bëhej nga Këshilli i Administratës, i cili emërohej nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Financave. Veprimtaria e Bankës kontrollohej nga Komisioni i Kontrollit që emërohej nga Ministri i Financave. Banka kishte bilancin e vet vjetor, i cili miratohej nga Këshilli i Administratës, kontrollohej nga Komisioni i Kontrollit dhe i dërgohej Ministrisë së Financave. Shteti garantonte të gjitha veprimet që kryheshin nga Banka e Shtetit Shqiptar, në bazë të ligjit të saj organik.

Ndër funksionet kryesore të Bankës së Shtetit Shqiptar, sipas ligjit organik të datës 13 janar 1945, mund të përmendim edhe:

- nxjerrja e kartëmonedhës në qarkullim, e cila duhet të garantohej të paktën baras me një të tretën e monedhave të emetuara me ar e argjend (në monedha ose shufra) të depozituara brenda ose jashtë shtetit, me valuta të huaja, etj;
- dhënia e kreditit afatshkurtër e afatgjatë, për privatët, shoqëritë dhe entet publike, në formën e paradhënive me afat të shkurtër në llogari rrjedhëse, paradhënie të garantuara në formë pengu mbi fonde publike shqiptare dhe paradhënie për dokumente malli në udhëtim. Qeverisë mund t'i jepej paradhënie ose t'i çelej kredi në llogari rrjedhëse pa interes, për një shumë deri në 30 milionë franga shqiptare.
- shërbimi i arkëtimit dhe i pagesave për llogari të privatëve dhe të institucioneve;
- shërbimi i arkës së shtetit dhe i thesarit të shtetit;
- qendër për mbajtjen e llogarive rrjedhëse, për pranimin e depozitave të kursimit dhe për ruajtjen e depozitave në para, në tituj, në monedha ari e argjendi, etj.;
- shitblerja e arit, e argjendit dhe e metaleve të çmuara;
- këmbimi i valutave të huaja për llogari të vet ose për llogari të të tretëve, si dhe pranimi i depozitave në valutë të huaj;
- nënshkrimi i marrëveshjeve të huave;
- ngritja e magazinave të përgjithshme për bllokimin e mallrave, për të cilat kishte dhënë kredi që nuk ishin paguar në afat nga klientët.

Pra, në kushtet e ekzistencës së një banke të vetme, BSHSH kryente jo vetëm funksione të bankës qendrore, por edhe të bankave tregtare. Në vijim do të hedhim një vështrim të përgjithshëm mbi disa nga funksionet kryesore që BSHSH kryente në rolin e një banke tregtare. Ato ishin:

- **Kredit bankar;**
- **Kontrolli bankar mbi investimet themelore;**
- **Sistemi i pagesave me xhirim në llogari;**
- **Organizimi i pagesave ndërkombëtare.**

i. Krediti bankar

Banka e Shtetit Shqiptar, praktikisht e vetmja bankë që vepronte në Shqipëri, përveç të tjerave kishte edhe monopolin e kreditit bankar. Sipas ligjit organik të janarit 1945, ajo kishte të drejtën të zbatonte forma të ndryshme kreditimi me afat të shkurtër, të njohura për kohën, në formën e paradhënies, të skontimit të titujve, etj., si dhe të bënte negociata huash.

Në vitin e parë të veprimtarisë së saj, krediti bankar i kushtohej pothuajse tërësisht sektorit privat, kryesisht për tregtarët. Kreditimi për sektorin shtetëror filloi nga fundi i vitit 1945 dhe për sektorin kooperativist nga fillimi i vitit 1946. Pesha e kreditit për sektorin shtetëror ndryshoi me ritme të shpejta, duke filluar nga muaji janar 1946. Në mars, krediti për sektorin shtetëror dhe kooperativist zinte 37 për qind, kundrejt 63 për qind në sektorin privat. Në fund të vitit 1946, sektori shtetëror dhe kooperativist përfituan 98 për qind, ndërsa sektori privat vetëm 2 për qind.

Në shtator të vitit 1948 u miratua urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 20.09.1948, duke vendosur një sistem të ri kreditimi, ku vihej theksi mbi kreditimin e ndërmarrjeve ekonomike shtetërore, brenda kufijve të kreditit të planifikuar. Kreditimi për sektorin privat dhe veçanërisht për kredi afatmesme ose afatgjata, praktikisht erdhi drejt shuarjes.

Kreditimi i ekonomisë ishte një funksion i rëndësishëm i Bankës së Shtetit Shqiptar. Sistemi i kreditimit iu përshtat kushteve të reja dhe orientimeve me karakter politik. Objektet e kredisë dhe rregullat përcaktoheshin në urdhëresa, të cilat, edhe pse përgatiteshin nga specialistë të Bankës, emetoheshin nga Këshilli i Ministrave. Banka e Shtetit Shqiptar, me politikën ekonomike e financiare të saj, po shndërrohej gradualisht në një levë të fuqishme për forcimin dhe zgjerimin e sektorit shtetëror dhe kooperativist të ekonomisë.

Sistemi i ri i kreditit bankar, i vendosur në shtator të vitit 1948, nga përmbajtja përbënte një reformë të rëndësishme në veprimtarinë e Bankës së Shtetit Shqiptar. Në sistemin e ri të kreditit bankar u vendosën parimet bazë të kreditit bankar, sipas të cilave ndërmarrjet ekonomike shtetërore dhe organizatat e tjera ekonomike, kreditoheshin brenda kufijve të kreditit të planifikuar për objekte të caktuara dhe për nevoja reale e të dokumentuara. Për çdo kredi të dhënë caktoheshin afate konkrete kthimi, ndërsa kredia duhet të garantohej me mallra.

Objektet e kredisë dhe rregullat përkatëse u përmirësuan në vazhdimësi, në përputhje me kushtet e zhvillimit të ekonomisë, por edhe të përvojës së fituar nga BSHSH. Kështu, ndryshime të rëndësishme u bënë në vitet 1954, 1956, 1958, 1966, etj.

Në vitin 1977, aktiviteti i kredisë për BSHSH rregullohej me një sërë urdhëresash të Këshillit të Ministrave:

- urdhëresa nr. 2, datë 15.03.1977, “Mbi kredinë me afat të shkurtër për ndërmarrjet”;



Poster propagande për blerjen e obligacioneve të huasë shtetërore, Tiranë 1954

- urdhëresa nr. 3, datë 15.03.1977, “Mbi kredinë me afat të gjatë për zgjerimin e prodhimit në ndërmarrjet”;
- urdhëresa nr. 4, date 15.03.1977, “Mbi kredinë me afat të gjatë për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve në qytet dhe në fshat”.

Krediti për ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore rregullohej me dispozitat përkatëse dhe zbatohet nga Banka Bujqësore, duke filluar nga data 1 janar 1970.

a. Krediti afatshkurtër për ndërmarrjet

Krediti afatshkurtër për sektorin shtetëror erdhi vazhdimisht duke u rritur dhe pati peshën kryesore të kreditit bankar në ekonomi. Kredia me afat të shkurtër në fund të vitit 1989 arriti në mbi 6.4 miliardë lekë, nga rreth 7.4 milionë lekë kredi gjithsej, ose mbi 86 për qind e totalit, nga rreth 192 milionë lekë në fund të vitit 1950 dhe 1.3 miliardë lekë në fund të vitit 1960.

Krediti afatshkurtër synonte plotësimin e nevojave të përkohshme financiare të subjekteve ekonomike. Objektet e kredisë afatshkurtër evoluan në kohë, duke filluar nga paradhëniet dhe skontimi i titujve në fillimet e veprimtarisë, deri në plotësimin e nevojave për para të kushtëzuara për realizimin e detyrave të planit, në varësi të veçorive të ndërmarrjeve të ndryshme.

Në vitin 1982 BSHSH u jepte kredi afatshkurtër ndërmarrjeve për këto objekte :

- a) për blerje e grumbullime materialesh e mallrash stinore;
- b) për të përballuar shpenzimet e procesit stinor të prodhimit;
- c) për materiale, produkte të gatshme e mallra në ndërmarrjet e prodhimit, të ndërtimit, të tregtisë etj.;
- d) për gjendjen e planifikuar të mallrave të eksportit në ndërmarrjet e tregtisë së jashtme;
- e) për gjendjen faktike të mallrave dhe të materialeve të importit në ndërmarrjet e furnizimit materialo-teknik;
- f) për meremetime të mëdha, kundrejt fondit vjetor të amortizimit që do të krijohet sipas planit;
- g) për situacione të paraqitura punëdhënësve për punime të kryera;
- h) për mallra të nisura, punime e shërbime të kryera në drejtim të blerësve ose të porositësve që ndodheshin jashtë juridiksionit të degës së Bankës.

Për nevoja të përkohshme, kur gjykohej e nevojshme, jepej kredi për vlerat materiale në formën e lëndëve të para, të materialeve kryesore, të materialeve ndihmëse, të lëndëve djegëse dhe të prodhimit në proces, që ishin përkohësisht mbi nevojat e normuara të mjeteve xhiruese. Kjo kredi jepej nga dega e Bankës për një afat deri në gjashtë muaj, por Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar kishte të drejtë të shtynte afatin e kthimit të kredisë edhe deri në tre muaj të tjerë.

Banka e Shtetit Shqiptar, kur vërente se ndërmarrjet blinin ose prodhonin materiale e mallra të planifikuara ose mbi plan, të cilat mund të shndërroheshin në mbinormativa, me qarkullim të ngadalshëm ose stoqe, si edhe kur prodhoheshin me humbje të paplanifikuara, nuk jepte kredi të mëtejshme për këto vlera materiale.

Banka e Shtetit Shqiptar, kur konstatonte se krediti nuk ishte përdorur për qëllimin e dhënë, kishte të drejtë të ndërpriste menjëherë kreditimin e mëtejshëm dhe të kërkonte kthimin para afatit të kreditit të dhënë. Njëkohësisht, kur krediti nuk kthehej në afat ose kur nuk garantohej me vlera materiale, BSHSH kishte të drejtë të ndërpriste, të kufizonte dhënien e mëtejshme të kreditit ose të kërkonte kthimin e menjëhershëm të tij. Për kreditin e pakthyer në afat, interesi bankar dyfishohej.

Krahas ndryshimeve në objektet e kreditit, në përputhje me etapat e zhvillimit, bankieret kërkonin edhe forma teknike kreditimi, që konsideroheshin si më të përshtatshme. Ndër format teknike më të përdorshme ishin:

- **Kreditimi për tepricë** realizohej në varësi të gjendjes së planifikuar të tepricave të vlerave të kreditueshme të materialeve e të mallrave në një datë të caktuar. Kjo mënyrë pati përdorim të gjerë në ndërmarrjet e sferës së prodhimit material dhe funksiononte e lidhur me llogarinë rrjedhëse të ndërmarrjes që kreditohej.
- **Kreditimi për xhiro** realizohej duke marrë parasysh jo lëvizjen e tepricës së vlerave të kreditueshme të materialeve e të mallrave, por xhiron e tyre, hyrjet dhe daljet eventuale të këtyre vlerave materiale. Kjo formë kreditimi përdorej kryesisht për ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike të sferës së qarkullimit.
- **Kreditimi i diferencuar**, me të cilën BSHSH i trajtonte ndërmarrjet ekonomike shtetërore dhe organizatat kooperativiste në mënyrë të diferencuar. Ndërmarrjeve ekonomike shtetërore dhe organizatave kooperativiste që plotësonin detyrat e planit, por që mund të ndodheshin në vështirësi financiare për arsye objektive, Banka u jepte kredi për nevoja të përkohshme me afat maksimal 30-ditësh, për pagimin e faturave e të situacioneve të pranuar, për pagesën e pagave, etj.

Kreditë që jepte Banka klasifikoheshin në tri lloje:

- **Kredi të planifikuara.** Këto kredi u jepeshin ndërmarrjeve për të plotësuar planet e tyre të prodhimit e të qarkullimit. Në këtë kategori bënin pjesë kreditë kundrejt rezervave të planifikuara. Për këto kredi caktoheshin kufij veçmas për secilin objekt dhe kërkohej respektimi i tyre.
- **Kredi pagesash:** Kjo kategori përbëhej kryesisht nga krediti për dokumente në udhëtim (mallrat e nisura). Këtë lloj kredie e përfitonin gati të gjitha ndërmarrjet. Ajo jepej pa kufi dhe kishte mënyra specifike rregullimi.
- **Kredi të paplanifikuara:** Në këtë kategori trajtoheshin kreditë për nevojat e përkohshme. Ato u jepeshin ndërmarrjeve në rastet kur gjatë procesit të plotësimit të planit u lindnin nevoja plotësuese, të cilat buronin nga shkaqe objektive që nuk vareshin prej tyre.

b. Kredi bankar afatgjatë për zgjerimin e prodhimit për ndërmarrjet

Ndryshe nga krediti afatshkurtër, krediti bankar afatgjatë në sektorin shtetëror të ekonomisë kishte përdorim shumë të kufizuar, për arsye se financimi i investimeve përballohej tërësisht me mjetet e buxhetit të shtetit.

Nga shtatori i vitit 1956, në bazë të urdhëresës nr. 13, datë 13.09.1956, Banka e Shtetit Shqiptar, me qëllim që të ndihmonte përdorimin e teknikës së re, për mekanizimin dhe përsosjen e teknologjisë së prodhimit, u jepte kredi afatgjatë ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike për të përballuar këto shpenzime, kur nuk ishin parashikuar në planin e investimeve. Kredi afatgjatë për zhvillimin e teknikës së re jepej në shumë të kufizuara që arrinin nga 50 deri në 100 mijë lekë, me një afat të shkurtër, jo më shumë se tre vjet. Përveç kësaj, kërkesat e Bankës ishin tepër strikte dhe për rrjedhojë, edhe kërkesat për këtë kredi ishin shumë të pakta. Statistikat për përdorimin dhe për tepricat e kredisë afatgjatë e dëshmojnë qartazi këtë realitet. Teprica më e lartë e kredisë afatgjatë për ndërmarrjet ishte vetëm 9 milionë lekë, në fund të vitit 1975, në një kohë që teprica e kredisë afatgjatë për kooperativat bujqësore në këtë datë ishte rreth 445 milionë lekë.

Ndryshimet e mëvonshme ndikuan në përkeqësimin e mëtejshëm, deri sa teprica në fund të vitit 1980 u bë “zero”, për t’u rishfaqur në vitin 1987 në sasinë prej vetëm rreth 1 milion lekë dhe në vitin 1989 në rreth 2 milionë lekë.

Ndryshimi rrënjësor i qëndrimit shtetëror për këtë kredi u bë në vitin 1990, me urdhëresën nr. 3, datë 25.05.1990 të Këshillit të Ministrave, për të cilën flitet në vijim.

c. Kredi bankar afatshkurtër për kooperativat bujqësore

Deri në vitin 1961, Banka e Shtetit Shqiptar u jepte kooperativave bujqësore kredi me afat të shkurtër për të përballuar shpenzimet e prodhimit bujqësor e blegtoral, kryesisht për blerjen e materialeve dhe të shërbimeve nga të tretët.

Në vitin 1961, u eksperimentua në disa rrethe dhënia e kreditit afatshkurtër për çdo muaj, kundrejt ditëve të punës të kryera realisht nga anëtarët e kooperativave bujqësore deri në masën 50 për qind të shumës së caktuar në planin financiar për një ditë pune. Nga 1 janari i vitit 1965, kjo formë krediti u shtri për të gjitha kooperativat bujqësore, kurse masa e paradhënies u rrit deri në 65 për qind të shumës së caktuar në planin financiar, për një ditë pune.

Duke filluar nga 1 janari 1967, u ndryshua koncepti i kreditimit për ditë pune, duke u konsideruar si qëndrim i gabuar (revizionist) dhe u zëvendësua me paradhënien kundrejt të ardhurave që parashikoheshin të realizoheshin nga kooperativat bujqësore, por jo më shumë se 70 për qind të të ardhurave në para të planifikuara për t’iu ndarë anëtarëve gjatë vitit.

d. Krediti bankar afatgjatë për kooperativat bujqësore

Kooperativat bujqësore përfitonin kredi kryesisht për investime me karakter prodhues, pa ndonjë kufi të caktuar pjesëmarrjeje. Parimi i pjesëmarrjes respektohej në varësi të gjendjes ekonomiko-financiare për secilën kooperativë bujqësore në veçanti.

Kooperativat bujqësore përfitonin kredi për këto objekte kryesore:

- ndërtimin dhe meremetimin e objekteve me karakter prodhimi (hangarë, stalla, depo, shtretër të nxehtë, sera, etj.);
- ndërtimin e kanaleve dhe të veprave të tjera ujitëse e bonifikuese që u përkisnin vetë kooperativave bujqësore;
- krijimin e blloqeve me dru frutorë, me ullinj, me vreshta, me agrume, si dhe kryerjen e shërbimeve deri sa hynin në prodhim;
- blerjen e makinerive (si traktorë, kombajna etj.), e veglave të ndryshme bujqësore, mjete transporti, etj.
- çeljen e tokave të reja, të sistemimeve agrare dhe për punime të thella me mjetet e mekanizuara të shtetit (SMT – Stacioni i Makinave dhe Traktorëve);
- blerjen e farërave shumëvjeçare;
- ndërtimin e veprave energjetike dhe elektrifikimin e fshatit;
- blerjen e kafshëve të punës dhe të prodhimit, të shpendëve, të bletëve dhe të zgjojeve.

Kreditë jepeshin sipas destinacionit, për shërbimet nga të tretët, kundrejt dokumenteve që paraqiteshin në Bankë prej tyre, ndërsa ishte përjashtuar kontributi i vetë kooperativave bujqësore nëpërmjet punës së anëtareve të saj.

Afatet e kthimit për kredinë afatgjatë vareshin nga objekti i kreditueshëm, dhe mund të shkonin deri në 25 vjet, nga data e fillimit të shlyerjes së saj.

e. Krediti bankar për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve

Banka e Shtetit Shqiptar filloi të japë kredi afatgjatë për ndërtimin dhe për meremetimin e banesave që në vitin 1950. Punonjësve u jepej kredi në masën deri 7.500 lekë, me një afat kthimi deri në 7 vjet.

Në vitin 1954, kredia u jepej punëtorëve, nëpunësve dhe anëtarëve të kooperativave të artizanatit në qytet, për ndërtimin e banesës deri në 70 për qind të vleftës së saj, por jo më shumë se 7.500 lekë dhe me afat kthimi deri në 15 vjet, ndërsa për meremetim, kredia jepej deri në 90 për qind të vleftës së meremetimeve, por jo më tepër se 5.000 lekë, me afat kthimi deri në 8 vjet.

Duke filluar nga 1 janari 1959, krediti mund të jepej për të ndërtuar banesa të reja, për të mbaruar një banesë të filluar, si dhe për zgjerime dhe meremetime banesash



Nënshkrimi i huasë shtetërore në Uzinën "Enver", mars 1952.



për punëtorët, nëpunësit, pensionistët, anëtarët e kooperativave të artizanatit, për personat që u shpronësohej banesa për nevojat e institucioneve, të ndërmarrjeve dhe të organizatave kooperativiste e shoqërore, ose u dëmtohej nga fatkeqësitë e natyrës, si dhe për personat që u shembej banesa sipas planit rregullues të qytetit. Krediti për ndërtim jepej deri në 25.000 lekë dhe me një afat kthimi gjer në 20 vjet, kurse për meremetim banesash krediti jepej deri në 5.000 lekë dhe me afat kthimi deri në 15 vjet. Dhënia e kreditit kushtëzohej me depozitën bankare për një shumë prej jo më pak se 25 për qind të kreditit të kërkuar, e cila duhej të qëndronte në bankë si depozitë të paktën 6 muaj. Përrjashtohej nga ky kusht dhënia e kreditit për meremetimin e banesës, kur ajo ishte e domosdoshme dhe e ngutshme.

Në këtë periudhë, krediti afatgjatë dha efekte pozitive, sidomos në Tiranë dhe në disa qytete të tjera të mëdha. Ndryshimet e mëvonshme, në vitin 1961 dhe veçanërisht në vitin 1963, i dhanë një goditje jo të vogël kreditit afatgjatë, veçanërisht për ndërtimin e banesave të reja, duke e kushtëzuar këtë vetëm kur qytetarët mund të ndërtonin banesë në mënyrë kolektive, me dy ose më tepër kate, por jo më të vogla se për 6 familje. Për rrjedhojë, teprica e kredisë për përmirësimin e kushteve të banimit në qytete u rrit pothuajse tre herë në vitet 1960-1975. Në vitet e mëvonshme u rrit me ritme shumë të ulëta, deri në vitin 1980, pas të cilit kjo tepricë njeh vetëm rënie.

Shlyerja e kreditit për punonjësit që ishin në marrëdhënie pune, në marrëveshje me ta, bëhej me ndalesa mujore nga paga, të cilat derdeshin në bankë nga qendra e

punës ditën e tërheqjes së pagave. Për kreditin e dhënë vihej hipotekë mbi banesën për të cilën ishte dhënë krediti. Shtëpitë e meremetuara ose të rindërtuara me kredi, nuk mund të shiteshin nga pronarët e tyre para se të ishte shlyer krediti i marrë nga Banka.

Banka e Shtetit Shqiptar kishte të drejtë të ndërpriste përkohësisht ose përfundimisht dhënien e kreditit dhe të kërkonte me anë padie edhe kthimin para afatit të tij, kur vërtetohej se krediti shpërdorohej dhe nuk përdorej për qëllimin e caktuar.

Në bazë të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 15.03.1977, ndryshuar me urdhëresën nr. 4, datë 21.09.1982, u vendosën kritere dhe rregulla të reja për dhënien e kreditit afatgjatë për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve në qytet.

f. Krediti bankar në vitin 1990

Ndryshimet e shpejta, por edhe pamundësia për plotësimin e nevojave për investime nga buxheti i shtetit, veçanërisht kur kërkoheshin fonde në valutë, në fund të viteve '80 imponuan ndryshime edhe në objektet e kreditit, përfshirë edhe kreditin afatgjatë.

Sipas urdhëresës nr. 3, datë 25.05.1990 të Këshillit të Ministrave, Banka e Shtetit Shqiptar mund t'u jepte ndërmarrjeve që merreshin me tregti të jashtme dhe atyre që prodhojnë për eksport, kredi afatshkurtër dhe afatgjatë në valutë të lirë, për këto qëllime:

- a) për të shfrytëzuar koniunkturën e favorshme të çmimeve të importit, sidomos të atyre me karakter stinor dhe për të blerë e rishitur mallra me fitim në valutë të lirë;
- b) për të stimuluar shtimin e prodhimit të mallrave për eksport ose të artikujve të rinj, kur kishin treg shitjeje në valutë të lirë;
- c) për të blerë disa mallra importi të konsumit të gjerë, shitja e të cilave krijonte të ardhura suplementare në valutë;
- d) për të blerë mjete, makineri, pjesë ndërrimi e materiale importi që shërbenin për rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat ndikonin në shtimin e të ardhurave në valutë të lirë;
- e) për linja, makineri e pajisje që përmirësonin procesin teknologjik të prodhimit në degë të ndryshme të ekonomisë, nëpërmjet të cilave kurseheshin fondet valutore të importit;
- f) për raste të tjera që do të gjykoreshin me leverdi nga Banka e Shtetit Shqiptar.

Kredia afatgjatë u jepej këtyre ndërmarrjeve për investime në objekte, linja, makineri e pajisje etj., kur këto kishin leverdi ekonomike, kur krijoheshin të ardhura suplementare në valutë ose kur kishte efekte pozitive në pakësimin e shpenzimeve në valutë.

Në bazë të urdhëresës nr. 6, datë 25.05.1990 “Për kreditin bankar” Banka e Shtetit Shqiptar u jepte ndërmarrjeve kredi afatshkurtër për plotësimin e planit të prodhimit, të shpërndarjes dhe të qarkullimit për këto qëllime :

- a) për plotësimin me pjesëmarrje të nevojave të planifikuara të mjeteve xhiruese, pasi përcaktohej normativa e mjeteve të veta të xhiros për elementet materiale, të llogaritura mbi bazën e nevojave të tremujorit më të vogël;
- b) për nevoja të përkohshme, për tejkalimin e nevojave të planit, për përmirësimin e cilësisë, për vlera materiale që ishin përkohësisht mbi nevojat e normuara të mjeteve të veta xhiruese, të rrjedhura nga faktorë që nuk vareshin nga puna e ndërmarrjes, por që nuk përbënin vlera materiale me qarkullim të ngadalshëm e stoqe.

Këto ndryshime të imponuara nga rrethanat e kohës, patën jetë të shkurtër dhe zbatimi i tyre në praktikë nuk qe pa vështirësi, të imponuara nga gjendja e buxhetit të shtetit dhe veçanërisht nga mungesat në valutë. Për rrjedhojë, efektet e këtyre ndryshimeve qenë të papërfillshme.

Rrethanat specifike në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1990, sidomos pas eksodit të 2 korrikut, imponuan gjithashtu nevojën për kreditimin e sektorit privat, edhe pse në hapat e parë. Në maj të vitit 1990 ishin miratuar ligjet e reja për Bankën e Shtetit Shqiptar dhe për Bankën Bujqësore, por që hynin në fuqi në vitin 1991. Në këto kushte, Banka e Shtetit Shqiptar propozoi disa ndryshime në ligjin nr. 7377, datë 08.05.1990, të cilat u miratuan.

Sipas ligjit të miratuar në maj 1990, Banka e Shtetit Shqiptar mbante llogari bankare për pagesat dhe arkëtimet, për ndërmarrjet dhe organizatat shtetërore, të cilave u jepte edhe kredi. Me ndryshimet e propozuara, fjalët “ ndërmarrje dhe organizata shtetërore” u zëvendësuan me fjalët “klientët e saj”.

Në këtë mënyrë, dekreti nr. 7440, datë 01.12.1990 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7377, datë 08.05.1990 “Për Bankën e Shtetit Shqiptar”, parashikonte t’u jepte kredi afatshkurtër klientëve të saj, për zhvillimin e veprimtarisë së tyre, ndërsa kredi afatgjatë u jepte klientëve për investime të reja, blerje e rikonstruksione teknike e teknologjike të objekteve prodhuese, të shërbimeve e të aktiviteteve të tjera që gjykoreshin prej Bankës të leverdishme ekonomikisht. Kreditimi për sektorin privat rinisi nga fillimi i vitit 1991.

ii. Kontrolli bankar për financimin e investimeve themelore

Në bazë të dekretit nr. 440, datë 08.08.1947, duke filluar nga 1 shtatori i këtij viti, krahas me funksionin si arkë e përgjithshme e shtetit, Bankës së Shtetit Shqiptar iu ngarkua edhe kontrolli mbi pagesat e shpenzimeve që i përkisnin buxhetit të shtetit dhe ndërmarrjeve për financimin e ekonomisë dhe të investimeve nën limit, si dhe të meremetimeve të mëdha, si detyrim i Bankës për të ushtruar kontrollin me anë të lekut.

Nga 1 janari 1950, në bazë të dekretit nr. 744, datë 26.11.1949, Banka e Shtetit Shqiptar u ngarkua edhe me financimin dhe kontrollin e ndërtimeve mbi limit. Kontrolli bankar për financimin e investimeve e të meremetimeve, sipas dispozitave të mësipërme vazhdoi deri në vitin 1965.

Në vitin 1976, Këshilli i Ministrave nxori urdhëresën nr. 8, datë 15.11.1976 “Mbi studimin, projektimin, planifikimin dhe financimin e investimeve e të ndërtimeve themelore”. Me këtë urdhëresë përcaktoheshin detyra konkrete për organet investitore, projektuese e zbatuese, si dhe për organet e planit, të financës dhe të bankës.

Banka e Shtetit Shqiptar kishte për detyrë të njihte mirë rregullat dhe kompetencat e organeve të ndryshme shtetërore dhe të ekonomisë që lidheshin me planifikimin dhe miratimin e veprave, me projektimin dhe realizimin e preventivave, me sheshet e ndërtimit, etj. dhe të kërkonte paraqitjen e dokumenteve të nevojshme para se të lejonte financimin e shpenzimeve të kryera.

Banka kishte për detyrë të ushtronte kontroll dokumentar mbi të gjitha hallkat që lidheshin me investimet, nga projektuesit e preventivuesit, zbatuesit për sigurimin e dokumentacionit të plotë, deri te sheshet e ndërtimit dhe fondet e nevojshme të planifikuara deri në përfundimin e veprës. Kontrolli dokumentar plotësohej me kontrollin në vend, aty ku ndërtohej vepra apo ku montoheshin makineritë dhe pajisjet e ndryshme për të parë konkretisht organizimin e punimeve, zbatimin e projekteve, të grafikëve të punimeve, shkallën e mekanizimit të punimeve, cilësinë e punimeve, respektimin e normativave të harxhimit të materialeve, trajtimin e administrimit të materialeve në objekt etj. Kur e gjykonte të nevojshme, Banka bënte edhe matje metrike të punimeve të raportuara, duke i krahasuar të dhënat e kontrollit të saj me ato që tregoheshin në situacionet e paraqitura.

Banka e Shtetit Shqiptar kishte për detyrë të ndiqte në vazhdimësi zbatimin e planit të shtetit dhe dispozitat ligjore që rregullonin investimet dhe ndërtimet themelore. Ajo ushtronte kontroll mbi investitorët dhe mbi ndërmarrjet ndërtuese për respektimin e ligjshmërisë në financimin e investimeve dhe për krijimin e përdorimin e fondeve për financimin e tyre.

Banka e Shtetit Shqiptar nuk lejonte tejkalimin e vleftave të plota të veprave, të fondeve vjetore të planifikuara në zërat përkatës të investimeve të depozituara nga investitori, përdorimin e fondeve të një vepre për qëllime të tjera, kryerjen e

investimeve që nuk ishin në planin e shtetit, përdorimin e mjeteve të veta xhiruese për investime, kryerjen e punimeve pa projekt zbatim dhe preventiv përfundimtar, etj. Për shkëljen e dispozitave, Bankës i ishte dhënë e drejta të ndërpriste financimin e mëtejshëm të investimeve e të ndërtimeve dhe të kërkonte nga organet përkatëse marrjen e masave ndaj shkaktarëve.

Për rëndësinë që kishin investimet në sektorin e naftës, Bankës së Shtetit Shqiptar iu caktuan detyra të posaçme. Ajo kryente financimin e punimeve të shpim-kërkimit dhe të shpim-shfrytëzimit vetëm mbi bazën e dokumentacionit të nevojshëm, të miratuar nga organet përkatëse, për pusët dhe për metrazhin e projektuar, dhe sidomos për avancimin e mëtejshëm të punimeve për arritjen e rezultatit të kërkuar.

iii. Sistemi i pagesave me xhirim në llogari

Sistemi i pagesave me xhirim në llogari ishte tërësia e normave, e kushteve dhe e kriterëve bazë që rregullonin marrëdhëniet e pagesave midis ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore, institucioneve dhe organizatave politike e shoqërore, si dhe marrëdhëniet e pagesave midis këtyre dhe organeve financiare. Ai organizohej dhe drejtohej në mënyrë të centralizuar nëpërmjet Bankës së Shtetit Shqiptar.

Në bazë të dekretit nr. 101, datë 03.08.1946, marrëdhëniet financiare midis ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore rregulloheshin nëpërmjet Bankës së Shtetit Shqiptar. Rregulla të plota për sistemin e pagesave u përcaktuan në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë, 16.12.1964, si dhe në ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 70, datë 11.03.1985.

Të gjitha ndërmarrjet, institucionet, organizatat kooperativiste, etj. ishin të detyruara të mbanin mjetet e tyre monetare në llogaritë përkatëse pranë Bankës. Si rregull, fondet përdoreshin vetëm me urdhër të titullarëve. Mjetet monetare në llogaritë likuiduese ose rrjedhëse mund të përdoreshin edhe me iniciativë të Bankës, kur vihej në zbatim një titull ekzekutiv, kur urdhërohej organi drejtues administrativ i ndërmarrjes, kur urdhërohej organi shtetëror për zbatimin e dispozitave mbi nxjerrjen e të ardhurave shtetërore, për likuidimin e faturave të paraqitura me kërkesë arkëtimi të ndërmarrjes ose institucionit dhe të pranuar prej tyre, për shlyerjen e interesit bankar, për shlyerjen e kredisë bankare së cilës i kishte kaluar afati etj.

Banka nuk mund të prekte me iniciativën e saj mjetet monetare që kishin ndërmarrjet dhe institucionet e ndryshme në llogaritë e tyre, kur nga ana e tyre ishte paraqitur kërkesë me shkrim për rezervim fondesh të nevojshme për pagimin e pagave, kontributin e sigurimeve shoqërore shtetërore dhe çdo ndalesë tjetër nga pagat.

Format e pagesave që përdoreshin me anë të Bankës ishin :

- *me kërkesë arkëtimi të pranuar*
- *me urdhër xhirimi*

- *me pagesë të planifikuar*
- *me kompensim të detyrimeve.*

Pagesa me kërkesë arkëtimi të pranuar ishte forma kryesore e pagesave me xhirim në llogari. Kërkesë arkëtimi ishte një dokument i parapërgatitur nga Banka, i cili plotësohej nga shitësi me të dhënat e nevojshme dhe paraqitej në degën e Bankës që i shërbente atij (ku kishte llogaritë). Pranimi ishte pëlqimi që blerësi i jepte Bankës (degës që i shërbente) për pagimin e kërkesës së arkëtitimit të paraqitur nga shitësi. Pranimi bëhej duke u mbështetur në dokumentet që paraqiteshin për arkëtim në Bankë dhe jo mbi mallrat.

Njiheshin tre forma pranimi: *pranimi në heshtje, pranimi me shkrim dhe pranimi i mëvonshëm.*

Pranimi në heshtje, nënkuptonte që klienti debitor (blerësi) pranonte kryerjen e pagesës pa qenë nevoja të njoftohej Banka, me kalimin e afatit të caktuar prej saj në çdo dokument të paraqitur. Pranimi në heshtje ishte më i përhapur, sepse shmangte korrespondencën e panevojshme midis klientëve dhe bankës.

Krahas pranimit në heshtje përdorej rrallë edhe pranimi me shkrim, ku ndërmarrja blerëse duhet të njoftonte me shkrim bankën nëse ishte dakord të pranonte shumën sipas dokumenteve të paraqitura në ngarkim të saj.

Pagesa me kërkesë arkëtimi me pranim të mëvonshëm përdorej për pagimin e kërkesë arkëtitimit, kur shitësi dhe blerësi i mbanin llogaritë në të njëjtën degë banke. Pranimi quhej i mëvonshëm, sepse ndërsa pagesa kryhej nga banka në momentin e paraqitjes së dokumenteve nga shitësi, blerësi kishte të drejtë të jepte pëlqimin e vet për veprimet e bankës brenda afatit të caktuar në secilin dokument.

Kërkesa e arkëtitimit ishte dokumenti bazë bankar me të cilin shitësi i dërgonte bankës së blerësit dokumentet justifikuese për kërkesën e paraqitur (fatura, situacione, fletëdalje, fletëngarkesa, procesverbale rakordimi, etj.).

Pagesa me urdhërshirimi. Kjo formë pagese kishte në bazë urdhrin që blerësi i jep bankës së vet për të paguar nga llogaritë e tij, një shumë të caktuar të shitësit për blerjen e mallrave, shërbimeve, etj.

Urdhërshirimi përdorej nga ndërmarrjet dhe institucionet edhe për derdhjen e detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit, për krijimin e fondeve të investimeve, për shtesën ose plotësimin e mungesës së mjeteve xhiruese, për derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore shtetërore, për xhirimin e depozitave të kursimit të punonjësve në favor të arkave të kursimit etj.

Pagesa të planifikuara. Kjo formë pagese me xhirim në llogari përdorej midis ndërmarrjeve dhe institucioneve, të cilat kishin marrëdhënie të përditshme ose të shpeshta midis tyre dhe kryhej në dy mënyra, me xhirim kuotash të planifikuara për periudha të caktuara dhe me paradhënie të planifikuara.

Mënyra e pagesës me xhirim kuotash të planifikuara për periudha të caktuara mbështetej në marrëveshjen që lidhej midis shitësit dhe blerësit, e cila duhet të pranohej edhe nga banka. Marrëveshja përcaktonte të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe vllente për bankën si autorizim për të xhiruar me iniciativë shumat përkatëse,

nga llogaritë e blerësit në ato të shitësit, në shumat dhe në afatet e caktuara.

Pagesa me kompensim të detyrimeve. Kjo formë pagese përdorej për shlyerjen e detyrimeve që lindnin midis ndërmarrjeve për furnizime të ndërsjella mallrash dhe materialesh, kryerje punimesh e shërbimesh etj. Në këtë rast ndërmarrjet, në vend që t'i shlyenin detyrimet midis njëra-tjetrës me anë të bankës për çdo veprim ekonomik, i shënonin të drejtat dhe detyrimet në një llogari të vetme, të cilën e rakordonin rregullisht midis tyre.

Banka e Shtetit Shqiptar kishte të drejtë të ushtronte kontrolle edhe në fushën e pagesave, si për kontrollin e dokumenteve, ashtu edhe në trajtimin e problemeve ekonomike e financiare të ndërmarrjeve me paftësi paguese. Ajo analizonte shkaqet dhe rekomandonte masat që duheshin marrë për të përmirësuar gjendjen, siç ishin përgatitja në kohë e faturave dhe e situacioneve, paraqitja e tyre në Bankë, shpërndarja e mallrave sipas planit, krijimi i kushteve të përshtatshme për mirëmbajtjen e mallrave në ruajtje për llogari të të tretëve, pavarësisht nga arsyet dhe likuidimi i kundërvleftës së mallrave të përdorura, administrimi dhe shpërndarja e mallrave nga qendrat tranzite, sidomos në stacionet hekurudhore etj.

iv. Organizimi i pagesave ndërkombëtare

Banka e Shtetit Shqiptar kishte gjithashtu monopolin për pagesat ndërkombëtare të cilat i përshtateshin marrëdhënieve tregtare me shtetet përkatëse. Me disa vende përdorshin pagesa me klering, me monedhë llogaritëse rublën ose dollarin, kryesisht me vendet e kampit socialist, ndërsa me disa të tjerë, kryesisht vendet perëndimore, pagesat bëheshin në valutë të lirë.

Për pagesat me klering, Banka e Shtetit Shqiptar lidhte marrëveshje bankare, në bazë dhe për zbatim të marrëveshjeve qeveritare. Secila nga bankat evidentonte në llogarinë përkatëse transaksionet për vlerën e mallrave të importuara dhe të eksportuara, në valutën llogaritëse, si dhe detyrimet e tjera për transportin e jashtëm të këtyre mallrave, shpenzimet e sigurimit gjatë transportit, si dhe shpenzime të tjera me karakter tregtar dhe jo tregtar.

Pagesat me valutë të lirë realizoheshin nëpërmjet bankave korrespondente të Bankës së Shtetit Shqiptar në disa shtete.

Format teknike kryesore të pagesave të përdorura në marrëdhëniet me vendet e tjera ishin :

Pagesa e menjëhershme. Si rregull, ajo zbatohet për të gjitha pagesat me klering, me monedhë llogaritëse rublën. Ndërmarrja eksportuese paraqiste dokumentet që vërtetonin nisjen e mallrave në bankën e vet. Kur kjo e fundit i gjente në rregull dokumentat, kryente menjëherë pagesën nëpërmjet llogarisë së kleringut. Dokumentet e pranuar i dërgoheshin prej saj bankës së vendit të blerësit. Banka e blerësit regjistronte gjithashtu menjëherë vleftën e dokumenteve në llogarinë klering dhe ia përcillte ato blerësit, i cili nga ana e vet, brenda 14 ditë-pune, kishte të drejtën



Nënshkrimi i marrëveshjes mes R.P. të Shqipërisë dhe R.P. të Çekosllovakisë, prill 1957, Tiranë.



Nënshkrimi i marrëveshjes për shkëmbimet tregtare dhe pagesat midis RPSH dhe Italisë, viti 1955, Tiranë.

të reklamonte pagesën kur konstatonte parregullsi në respektimin e kontratës nga shitësi.

Pagesa me kredi dokumentare (akreditiv). Ajo zbatohet me vendet me të cilat pagesat kryheshin në valutë të lirë, si dhe me disa vende me të cilat marrëdhëniet tregtare e të pagesave kryheshin në klering dhe si monedhë llogaritëse përdorej dollari amerikan. Pagesat dokumentare bëheshin në përputhje me standardet e pranura ndërkombëtarisht.

Pagesa me kërkesë arkëtimi (inkaso). Kjo formë pagese zbatohet për likuidimin e detyrimeve, që lindnin midis shitësit dhe blerësit, kryesisht për marrëdhënie të rastit ose vlera relativisht të vogla, për të cilat nuk kërkohet nga shitësi çelja e kredisë dokumentare.

Sipas kësaj forme pagese, shitësi dërgonte për arkëtim në bankën e vendit të blerësit dokumentet që vërtetonin nisjen e mallit ose dokumente të tjerë justifikues. Banka e blerësit i dorëzonte dokumentet këtij të fundit dhe kryente pagesën vetëm me pëlqimin e tij. Pra, pagesa me kërkesë arkëtimi nuk kishte garanci pasi banka nuk merrte përsipër asnjë detyrim. Në bazë të kësaj forme pagese qëndronte besimi midis palëve, shitësit dhe blerësit.

Forma të tjera të pagesave. Forma të tjera të pagesave ishin edhe ato me urdhërshirim dhe me çek, të cilat zinin një peshë të parëndësishme të pagesave dhe përdoreshin kryesisht për veprimet jo tregtare dhe për eksportin e perimeve në Perëndim.

II. BANKA BUJQËSORE

Banka Bujqësore u krijua në bazë të dekretit nr. 4613, datë 12.12.1969, si institucion shtetëror krediti për kooperativat bujqësore, si pjesë e sistemit financiar të vendit. Veprimtarinë e saj, Banka Bujqësore e filloi më 1 janar 1970. Funksionet, detyrat dhe mënyra e organizimit të Bankës Bujqësore u përcaktuan në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 23.12.1969.

Banka Bujqësore ishte person juridik, kishte llogari të pavarur, bilancin e vet si dhe fondin e saj të themelimit (i pa përcaktuar).

Banka Bujqësore zbatonte politikën shtetërore të kreditit për kooperativat bujqësore, organizonte grumbullimin e mjeteve monetare përkohësisht të lira të kooperativave dhe, së bashku me mjetet e tjera që viheshin në dispozicion nga shteti, i drejtonte në mënyrë të planifikuar për dhënien e kredive me afat të shkurtër dhe të gjatë, duke u mbështetur në parimet dhe kriteret bazë të miratuara.

Banka Bujqësore funksiononte si qendër llogarie për kooperativat bujqësore dhe kryente shërbimin e arkëtimit dhe të pagesave. Megjithatë, shërbimi i kontabilitetit realizohej nga Banka e Shtetit.

Banka Bujqësore ndihmonte dhe përgjigjej për hartimin dhe miratimin e planit financiar në kooperativat bujqësore. Ajo shqyrtonte planet financiare të hartuara nga kooperativat bujqësore dhe i ndihmonte për përmirësimin e treguesve ekonomikë e financiarë të planifikuar.

Banka Bujqësore gjithashtu kishte për detyrë të ndiqte organizimin e rregullt dhe zbatimin e saktë të llogarisë dhe të kontabilitetit në kooperativat bujqësore, për zbatimin e planit kontabël dhe të sistemit të mbajtjes së llogarive. Implementimi i kontabilitetit, përgatitja, shqyrtimi dhe analiza në kohë dhe me cilësi e bilanceve tremujore e vjetore dhe të anekseve të tyre, si dhe përcaktimi i masave për përmirësimin e treguesve ekonomikë-financiarë, ishin disa nga çështjet më kryesore në këtë drejtim.

Me dekretin nr. 5530, datë 25.02.1977, sfera e veprimtarisë së Bankës Bujqësore, përveç kooperativave bujqësore, u shtri edhe mbi ndërmarrjet dhe institucionet e sistemit të bujqësisë, që ishin nën drejtimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të komiteteve ekzekutive të rretheve. Njëkohësisht u përsosën më tej edhe funksionet e detyrat e Bankës Bujqësore, të cilat konsistonin në këto drejtime kryesore :

- Banka Bujqësore vetë ose në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe me seksionet e bujqësisë të komiteteve ekzekutive të rretheve, kishte për detyrë të bënte analiza e studime për rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, për domosdoshmërinë e leverdinë ekonomikë-shoqërore të investimeve e të ndërtimeve në ndërmarrjet dhe institucionet e sistemit të bujqësisë dhe në kooperativat bujqësore.

- Banka Bujqësore ushtronte kontroll për përdorimin e fondit të pagave në ndërmarrjet bujqësore.
- Banka Bujqësore shqyrtonte dhe i paraqiste Bankës së Shtetit Shqiptar, të dhënat e nevojshme për hartimin e planit të arkës, për të ardhurat dhe shpenzimet që kishin të bënin me ndërmarrjet e institucionet e sistemit të bujqësisë dhe me kooperativat bujqësore.

Njëkohësisht u bë edhe riorganizimi i Bankës Bujqësore në qendër e në rrethe dhe varësia e Bankës Bujqësore i kaloi Ministrisë së Financave. Në qendër u krijua Këshilli i Bankës, përbërja e të cilit u miratua nga ministri i Financave, ndërsa degët e saj në rrethe vareshin drejtpërdrejt nga Drejtoria e Përgjithshme, me qendër në Tiranë.

Fondi i themelimit të Bankës Bujqësore u caktua në shumën prej 250 milionë lekë. Shteti garantonte të gjitha detyrimet e Bankës Bujqësore që rridhnin nga veprimet e kryera në bazë të dekretit për Bankën Bujqësore. Bilanci vjetor i Bankës Bujqësore miratohej nga Këshilli i Ministrave dhe e ardhura e saj i kalonte buxhetit të shtetit.

Banka Bujqësore trashëgoi të gjitha llogaritë, për kredi e depozita, të kooperativave bujqësore që deri në atë kohë shërbeheshin nga Banka e Shtetit. Krijimi i Bankës Bujqësore i dha një hov te ri kreditimit të kooperativave bujqësore dhe më vonë edhe ndërmarrjeve bujqësore.

Banka Bujqësore u jepte kooperativave bujqësore kredi me afat të shkurtër, me afat jo më shumë se një vit, për të përballuar shpenzimet sezonale, por edhe për paradhënie kundrejt realizimit të të ardhurave, e cila përdorej për të përballuar pagesën e anëtareve të kooperativës si paradhënie për ditë pune.

Ajo u jepte kooperativave bujqësore edhe kredi me afat të gjatë, për të plotësuar nevojat për investime, sipas objekteve të miratuara nga urdhëresat përkatëse të Këshillit të Ministrave. Në ndryshim nga Banka e Shtetit, e cila nuk mund ti ndihmonte ndërmarrjet me kredi afatgjatë, pesha e kredisë afatgjatë për kooperativat bujqësore ishte e rëndësishme.

Tabelë I: Teprica e kredisë për kooperativat bujqësore

Viti	Me afat të gjatë	Me afat të shkurtër
1970	349 milionë lekë	170 milionë lekë
1975	445 milionë lekë	362 milionë lekë
1989	758 milionë lekë	831 milionë lekë

Rritja me ritme më të shpejta e kredisë afatshkurtër ishte tregues i përkeqësimit të situatës financiare të kooperativave bujqësore.

Drejtori i Përgjithshëm i parë i Bankës Bujqësore u emërua Simo MILO. Në vijim, me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm janë emëruar Andon THIMJO, Skender KUCI dhe Orfea DHUCI.

III. BANKA E BUJQËSISË DHE E ZHVILLIMIT

Me ligjin nr. 7520, datë 16.10.1991 u krijua Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit si institucion i pavarur, pjesë e sistemit bankar. Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit trashëgoi të gjithë veprimtarinë e Bankës Bujqësore dhe varej nga Ministria e Financave.

Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit u ngarkua edhe me pranimin e depozitave të kursimit të popullsisë dhe të personave juridikë a fizikë vendas ose të huaj në lekë e në valutë.

Fondi i themelimit të Bankës së Bujqësisë dhe Zhvillimit u caktua në shumën prej 450 milionë lekë.

Organet drejtuese të Bankës përbëheshin nga Këshilli i Bankës, drejtori i Përgjithshëm dhe Komisioni i Kontrollit. Këshilli i Bankës ishte organ vendimor i cili organizonte, kontrollonte dhe përgjigjej për të gjithë veprimtarinë e saj, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm emërohej nga Këshilli i Ministrave. Komisioni i Kontrollit kontrollonte zbatimin e statutit dhe të vendimeve të Këshillit të Bankës. Drejtore të Përgjithshëm të Bankës së Bujqësisë dhe të Zhvillimit ndër vite kanë qenë Orfea Dhuci dhe Niko Gjokoreci.

IV. INSTITUTI I ARKAVE TË KURSIMIT DHE SIGURIMEVE

Në 1 gusht 1949, e nisur si shtojcë dhe në varësi të BSHSH-së, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të saj u krijua Drejtoria e Arkave të Kursimit, më vonë i njohur si Instituti i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve.

Instituti i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve grumbullonte kursimet e shtetasve shqiptarë, duke i pajisur me librezë kursimi. Krahas depozitimeve në para, prurjet më të mëdha të kursimeve vinin nga ndalesa nga paga që u bëheshin kryesisht punonjësve të ndërmarrjeve dhe të institucioneve shtetërore. Depozituesit përfitonin interesa, edhe pse në shuma simbolike (norma e interesit për depozitat me afat ishte 2 për qind dhe në disa raste 4 për qind).

Instituti i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve i depozitonte paratë pranë Bankës së Shtetit Shqiptar, ndërsa në arkat e veta mbante shuma të kufizuara. BSHSH paguante interesa, me të cilat Instituti përballonte interesat për depozituesit, shpenzimet e veprimtarisë (paga, kancelari, energji elektrike, etj.) dhe siguronte një fitim modest.

Instituti i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve mori përsipër edhe pagesën e pensioneve të qytetit dhe të fshatit, si dhe veprimtarinë modeste të sigurimeve shtetërore mjaft të kufizuara për kohën, kryesisht për marrëdhëniet me kooperativat bujqësore, për disa rreziqe të kufizuara.



Librezë Kursim - Arka Shtetërore e Kursimit dhe sigurimeve, vitet '50-'60.

Instituti i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve kishte rrjetin e vet në të gjitha qytetet, ku vepronte edhe Banka e Shtetit Shqiptar. Përveç kësaj, në qendrat e punës, kryesisht në qendrat e mëdha, kishte agjentët e vet (një punonjës i ngarkuar edhe me këtë detyrë nga qendra e punës), i cili kryente veprimet përkatëse, për llogari të Institutit të Arkave të Kursimit, përfshirë edhe pagesën e depozituesve nga kursimet e tyre.

Disa nga Drejtorët e Institutit të Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve kanë qenë: Ramadan ÇITAKU, i njohur me pseudonimin “baca”, Seit BUSHATI, Fadil KEPI, Kostaq POSTOLI, etj.

V. BANKA E KURSIMEVE

Me ligjin nr. 7505, datë 31.07.1991, nga ndarja e Institutit të Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve u krijua Banka e Kursimeve si institucion shtetëror i pavarur, pjesë e sistemit bankar.

Funksionet dhe detyrat kryesore të Bankës së Kursimeve ishin:

- a) veprimtari për depozitat e kursimit të mjeteve monetare në lekë dhe në valutë për shtetasit shqiptarë dhe të huaj;
- b) Kredi afatshkurtër dhe afatgjatë;
- c) Shërbime të ndryshme bankare.

Rregullat, kushtet dhe afatet për depozitat e kursimit, si dhe objektet e kredisë dhe rregullat e kushtet për dhënien dhe kthimin e saj caktoheshin nga vetë Banka e Kursimeve.

Për të ushtruar veprimtarinë e saj, Banka e Kursimeve kishte fondin e themelimit prej 50 milionë lekësh, fondin rezervë dhe fondin e mjeteve kryesore. Organet drejtuese të Bankës ishin Këshilli i Bankës, Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Këshilli i Ministrave dhe zëvendësit e tij.

Banka e Kursimeve kontrollohej nga Kontrolli i Shtetit dhe bilanci i saj, pasi miratohej nga Këshilli i Bankës paraqitej përpara Këshillit të Ministrave.

Banka e Kursimeve hyri në tregun bankar, krahas me Bankën Kombëtare Shqiptare (më vonë Banka Kombëtare Tregtare, BKT) e ndarë nga Banka e Shtetit Shqiptar, duke trashëguar depozitat e Institutit të Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve dhe shume shpejt u bë banka më e madhe në vend, duke përfituar edhe nga hyrja me vonesë dhe pa përvojën e duhur të Bankës Kombëtare Tregtare në tregun e depozitave. Fondet e Bankës së Kursimeve depozitoheshin pranë Bankës Kombëtare Tregtare, duke vazhduar traditën nga koha e Institutit të Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve.

Banka e Kursimeve e vazhdoi me sukses veprimtarinë, deri në privatizimin e saj nga Raiffeisen Bank, Austri, në vitin 2004.

Drejtori i parë i Bankës së Kursimeve u emërua Edvin LIBOHOVA, i cili kishte eksperiencë pune në Bankën e Shtetit Shqiptar. Në vijim drejtues të Bankës së Kursimeve janë emëruar Bedri COLLAKU, Artan SANTO dhe Ardian KAMBERI.

VI. BANKA SHQIPTARE E TREGTISË

Me dekretin nr. 7493, më datë 01.12.1990 u krijua Banka Shqiptare e Tregtisë, si person juridik që kishte për qëllim kryerjen e veprimtarisë bankare me qendër në Tiranë dhe me rrjetin e saj në rrethe. Banka Shqiptare e Tregtisë trashëgoi një pjesë të veprimtarisë së Bankës së Shtetit Shqiptar, kryesisht në fushën e tregtisë së jashtme dhe të valutës.

Banka Shqiptare e Tregtisë kishte këto të drejta e detyra :

- merrte pjesë në veprimtari dhe në marrëveshje me karakter ekonomik e financiar që personat juridikë a fizikë shqiptarë zhvillonin dhe përfundonin me personat juridikë a fizikë të huaj;
- hynte në marrëdhënie dhe lidhte marrëveshje bankare me bankat e tjera për çeljen dhe mbajtjen e llogarive në klering ose në valutë të lirë, si dhe pranonte dhe vendoste depozita bankare;
- mbante llogari bankare për arkëtimet dhe pagesat në valutë të huaj dhe në monedhë kombëtare për llogari të klientëve të saj, si dhe kryente arkëtimet dhe pagesat për veprime tregtare e jo tregtare;
- kryente këmbime valutore për nevojat e veta dhe të klientëve të saj brenda dhe jashtë shtetit;
- tregtonte tituj me vlerë dhe dokumente tregtare e financiare;
- ndihmonte dhe kontrollonte klientët e saj në veprimtarinë e tyre, si dhe për zbatimin e ligshmërisë në përdorimin e fondeve në valutë dhe në monedhën kombëtare;
- lëshonte dhe pranonte garanci bankare;
- kryente investime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- krijonte banka të përbashkëta dhe ndërmarrje të ndryshme me fondet e saj;
- jepte kredi në valutë dhe në monedhë kombëtare me afatet dhe kushtet e përcaktuara prej saj.

Këshilli Administrativ i Bankës Shqiptare të Tregtisë drejtohej dhe përfaqësohej nga drejtori i Përgjithshëm, i cili vepronte në përputhje dhe brenda kompetencave të caktuara nga Këshilli Administrativ ose nga statuti. Banka Shqiptare e Tregtisë gjithashtu, kishte të drejtë të çelte degë ose përfaqësi jashtë shtetit. Degët e Bankës në rrethe vareshin nga drejtori i Përgjithshëm dhe jepnin llogari para tij.

Banka Shqiptare e Tregtisë kishte një fond themelimit prej 600 milionë lekë, fond rezervë prej 200 milionë lekë, si dhe fondin e mjeteve kryesore. Ajo kontrollohej nga Kontrolli i Shtetit, bilanci i saj i paraqitej Këshillit të Ministrave pasi miratohej nga Këshilli Administrativ. Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Shqiptare të Tregtisë u emërua Agron SALIU.

Banka Shqiptare e Tregtisë ushtronte veprimtarinë e saj kryesisht në Tiranë dhe në Durrës ku ishin të përqendruara edhe një pjesë e mirë e ndërmarrjeve dhe magazinave të tregtisë së jashtme.



Banka e Shtetit Shqiptar, dega në Korçë, viti 1950.

VII. RRJETI I BANKËS SË SHQIPTAR SIPAS VITEVE

Shpërndarja e rrjetit të degëve dhe agjencive të Bankës së Shtetit Shqiptar në qytete dhe sipas viteve të ndryshme paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 2. Rrjeti i Bankës së Shtetit Shqiptar sipas viteve

Nr	Degë banke	1980		1985		1989	
		Agjenci	Zyra	Agjenci	Zyra	Agjenci	Zyra
1	Berat		3		5		5
2	Qyteti Stalin						
3	Dibër		10		13		13
4	Bulqizë						
5	Durrës	1	2	1	2	1	2
6	Kavajë						
7	Elbasan	1	5	1	9	1	9
8	Fier	1	4	2	5	2	5
9	Gramsh		4		4		4
10	Gjirokastër		4		7		7
11	Kolonjë		3		4		4
12	Korçë	2	9	3	8	3	8
13	Krujë		2		4		4
14	Laç						
15	Kukës		5		7		7
16	Lezhë		3		3		3
17	Librazhd		3	1	5	1	5
18	Lushnje		1		4		4
19	Mat		4		5		5
20	Mirditë		4		4		4
21	Përmet		3		4		5
22	Pogradec		3		3		3
23	Pukë		2	1	3	1	3
24	Sarandë	1	8	1	8	1	8
25	Skrapar		3		4		4
26	Shkodër		7		9		11
27	Tepelenë		4		5		5
28	Tiranë		4		4	1	4
29	Tropojë		3		3		3
30	Vlorë		8		10		10
Total	30	6	111	10	142	11	145

Përgatiti: Pedagog Llazi Balliu



Banka e Shtetit Shqiptar, dega në Kukës, vitet 1959-1962

Periudha 1991 – 2012

I.	Bankat në prag të sistemit të ri demokratik.....	72
II.	Krijimi i sistemit dynivelor.....	73
III.	Krijimi i bankave me pjesëmarrje të kapitalit të huaj.....	74
IV.	Ristrukturimi dhe privatizimi i bankave shtetërore.....	76
V.	Ndryshimet në legjislacion dhe rritja e numrit të bankave	81
VI.	Përballimi i kërcënimeve financiare.....	90
VII.	Standarde të reja dhe plotësime strukturore në mbështetje të forcimit të veprimtarisë bankare	93
VIII.	Transferimi i fondeve dhe kryerja e pagesave.....	96
IX.	Kërkesa për kapital minimal.....	100
X.	Ecuria e sektorit bankar.....	102

I. BANKAT NË PRAG TË SISTEMIT TË RI DEMOKRATIK

Në fund të vitit 1991, struktura e sistemit bankar në Shqipëri ishte tipike për një ekonomi të centralizuar. Ky sistem përmblihte institucionet shtetërore të mëposhtme:

- a) *Banka e Shtetit Shqiptar*, e krijuar me ligjin nr. 7377, datë 8.5.1990 “Për Bankën e Shtetit Shqiptar”, kryente, njëkohësisht, funksione të cunguara të një banke qendrore dhe funksione të një banke tregtare;
- b) *Banka e Kursimeve*, e krijuar me ligjin nr. 7505 “Për Bankën e Kursimeve”, e destinuar për mbledhjen e depozitave të individëve në lekë dhe valutë, për dhënien e kredive afatshkurtra dhe afatgjata dhe për kryerjen e shërbimeve të ndryshme;
- c) *Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit*, e krijuar në tetor 1991 duke trashëguar gjithë veprimtarinë e Bankës së Bujqësisë, me funksion kreditimin e drejtpërdrejtë të fermave dhe të kooperativave bujqësore;
- d) *Banka Shqiptare e Tregtisë*, e krijuar në janar të vitit 1991, me dekretin “Për Bankën Shqiptare të Tregtisë” nr. 7493, datë 1.12.1990, me qëllim administrimin e të gjitha marrëveshjeve dypalëshe të kleringut me vendet e Evropës lindore si dhe realizimin e të gjitha transaksioneve të tregtisë së jashtme.

II. KRIJIMI I SISTEMIT DYNIVELOR

Sistemi bankar dynivelor u krijua në prill 1992, me miratimin në Kuvendin Popullor të ligjit nr. 7559, datë 22.04.1992 “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili shfuqizoi ligjin nr. 7377, datë 8.5.1990 “Për Bankën e Shtetit Shqiptar”; dhe të ligjit nr. 7560, datë 28.04.1992 “Për Sistemin Bankar në Shqipëri”. Banka e Shtetit Shqiptar u shndërrua në Banka e Shqipërisë dhe fitoi të gjitha funksionet e një banke qendrore të modelit të vendeve perëndimore, kurse aktivitetin tregtar do ta kryente Banka Kombëtare e Shqipërisë që u krijua në qershor 1992. Me këtë vendim të rëndësishëm hapet rruga e transformimit të plotë të sistemit bankar në Shqipëri, sipas modelit të vendeve të Evropës perëndimore, duke u shkëputur përfundimisht nga sistemi monobankar socialist.

Në 1 Janar 1993, Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe Banka Shqiptare e Tregtisë u bashkuan duke krijuar Bankën Kombëtare Tregtare të Shqipërisë. Në Tetor 1993, Banka e Zhvillimit dhe e Bujqësisë shndërrohet në Banka Tregtare Agrare dhe të gjitha aktivet dhe depozitat i kalojnë bankës së re. Drejtues të Bankës Tregtare Agrare ndër vite kanë qenë Lulzim Sharku dhe Adrian Dabulla.

Të gjitha bankat tregtare zyrtarisht u lejuan të ushtronin funksionet e tyre si banka tregtare, duke marrë depozita dhe duke dhënë kredi si te individët, ashtu edhe te ndërmarrjet.

III. KRIJIMI I BANKAVE ME PJESËMARRJE TË KAPITALIT TË HUAJ

Sistemi i ri ligjor për bankat krijoi për herë të parë mundësinë e lejimit të bankave me kapital privat. Ligjet e prillit 1992 krijuan hapësirën ligjore që të realizohej një zhvillim i ri në sistemin bankar. Në dhjetor 1992, Banka e Shqipërisë i dha licencën Bankës Italo-Shqiptare (BIA), e cila u krijua si një bankë e përbashkët midis Bankës Kombëtare Tregtare dhe Banca di Roma. Banka filloi aktivitetin në korrik 1993. Në mënyrë të veçantë, BIA do të zhvillonte në favor të Shqipërisë, dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë, sipas kërkesës së qeverisë shqiptare, funksionet e organizimit e të administrimit të ndihmave dhe të financimeve ndërkombëtare, dhe në mënyrë të veçantë, do të ndihmonte me mjete financiare procesin e privatizimit të ekonomisë. Kapitali shoqëror ishte 10 milionë dollarë amerikanë, i ndarë me nga 5 milionë dollarë për secilën palë dhe në 100 aksione me vlerë 100,000 dollarë secili.

Krahas Bankës Italo-Shqiptare, në dhjetor të vitit 1992 u dha licenca edhe për një bankë tjetër të tipit *joint-venture* midis Bankës Kombëtare Tregtare (40 për qind të kapitalit) dhe Bankës së Zhvillimit Islamik (15 për qind të kapitalit). Kjo bankë u quajt Banka Arabo-Shqiptare Islamike (BASHI). Pjesën tjetër të aksioneve e zotëronin individë dhe institucione nga vendet arabe.

Po kështu, në dhjetor të vitit 1993 u lejua zhvillimi i aktivitetit nga banka private kosovaro-shqiptare Dardania.



Banka Italo - Shqiptare, dega Durrës.

Në fund të vitit 1993, për herë të parë, sistemi bankar paraqitej i larmishëm nga pikëpamja e pronësisë dhe i shtuar nga pikëpamja numerike. Tabela 3 paraqet sistemin bankar dynivelor në fund të vitit 1993.

Tabela 3: Sistemi bankar në fund të vitit 1993

Nr	Bankat	Pronësia	Niveli
1	Banka e Shqipërisë	Shtetërore	I parë (banka qendrore)
2	Banka Kombëtare Tregtare	Shtetërore	I dytë (bankë universale)
3	Banka e Kursimeve	Shtetërore	I dytë (bankë universale)
4	Banka Tregtare Agrare	Shtetërore	I dytë (bankë universale)
5	Banka Italo-Shqiptare	Joint-venture	I dytë (bankë universale)
6	Banka Arabo-Shqiptare Islamike	Joint-venture	I dytë (bankë universale)
7	Banka Dardania	E huaj private	I dytë (bankë universale)

IV. RISTRUKTURIMI DHE PRIVATIZIMI I BANKAVE SHTETËRORE

Edhe pse me hartimin e paketës së re ligjore u bënë ndryshime të rëndësishme për zhvillimin e sektorit bankar, një problem mbeti i pazgjidhur. Bankat shtetërore në librat e tyre mbartnin të gjithë portofolin e kredive dhënë ndërmarrjeve shtetërore, disa prej të cilave nuk ekzistonin më. Midis paraqitjes në libra dhe faktit real kishte mospërputhje. Kjo kërkonte plotësimin e aktivitetit të bilancit me mjete të reja, që do të balanconin realisht detyrimet. Lindi kështu problemi i pastrimit të librave të bankave shtetërore, proces i cili u konsiderua si pjesë e *ristrukurimit* dhe *rikapitalizimit* të bankave shtetërore. Për këtë qëllim, në fund të vitit 1992, Qeveria pranoi t'u falte ndërmarrjeve shtetërore borxhin e krijuar para Korrikut 1992 nëpërmjet emetimit të obligacioneve nga ana e Ministrisë së Financave për të zëvendësuar 4.3 miliardë lekë të shumës së kredive pa shpresë arkëtimi të regjistruara në librat e Bankës Kombëtare Tregtare (BKT).

Me zhvillimin e reformave ekonomike dhe procesit të privatizimit masiv në periudhën 1994 – 1996, u bë e nevojshme që ky proces të shtrihej edhe në fushën e sektorit bankar. Në vitin 1996, bankat tregtare me kapital shtetëror dominonin tregun bankar, duke qenë se mbi 90 për qind e aktivitetit të krejt sektorit bankar zhvillohej prej tyre. Nga ana tjetër, problemet e trashëguara nga periudha e ndërmarrjeve shtetërore dhe ato të krijuara rishtazi gjatë viteve të para të ekonomisë së tregut të lirë, dëshmonin se bankat shtetërore nuk mund të kryenin me sukses rolin e tyre ndërmjetësues, pa u shkëputur nga metodat e vjetra, pa një mënyrë të re të drejtimit, në kushtet e riskut të plotësimit të treguesit të kapitalit dhe në mungesë të plotë të teknologjisë dhe të infrastrukturës së nevojshme për garancinë operacionale.

Dokumenti më i rëndësishëm i miratuar për procesin e privatizimit të bankave shtetërore është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 655, datë 23 shtator 1996, “Për miratimin e strategjisë së privatizimit të bankave shtetërore”. Ky dokument përcaktoi objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të qeverisë për privatizimin e bankave, rolin e qeverisë, të Bankës së Shqipërisë dhe të vetë bankave, metodat e shitjes së bankave, fazat e detajuara të procesit të privatizimit, konsideratat për formulën dhe radhën e privatizimit, si dhe drejtuesit dhe këshilltarët e këtij procesi. Strategjia e privatizimit të bankave shtetërore kërkonte që ky proces të paraprihej nga rregullimi i kuadrit ligjor si fazë e parë dhe, më pas, si fazë e dytë, nga përgatitja e bankave për privatizim. Kështu, si banka e parë për t'u privatizuar u përcaktua Banka Tregtare Agrare, e ndjekur nga Banka Kombëtare Tregtare dhe, më pas, nga Banka e Kursimeve. Privatizimi tërësor i këtyre bankave duhej të realizohej brenda vitit 2000. Procesi do të drejtohej nga Ministria e Financave dhe nga Ministria e Privatizimit, në bashkëpunim me bankat që do të privatizoheshin, me këshilltarët e huaj dhe me Bankën e Shqipërisë.

Përgatitja e bankave për privatizim filloi me hartimin e një pakete masash të domosdoshme për secilën bankë, në përputhje me situatën e veçantë të secilës prej tyre. Këto masa lidheshin me huat, mjaftueshmërinë e kapitalit, kuadrin e brendshëm rregullues, licencimin sipas kërkesave të ligjit nr. 8075, datë 22.02.1996 “Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë”, të ushtruarit e veprimtarisë në përputhje me rregulloret e Bankës së Shqipërisë, riorganizimin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e procedurave kontabël.

Pjesë e këtyre masave ishte edhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 9 dhjetor 1996, “Për riorganizimin e veprimtarisë së Bankës së Kursimeve, Bankës Kombëtare Tregtare dhe Bankës Tregtare Agrare”. Ky dokument shënoi hapin e parë konkret në drejtim të ristrukturimit të rrjetit të degëve të këtyre bankave, duke lejuar transferimin e një numri të konsiderueshëm degësh, agjencish dhe zyrash bankare nga Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Tregtare Agrare në Bankën e Kursimeve. Ristrukturimi i kësaj të fundit do të ndodhte në një fazë të dytë. Vendimi kishte për qëllim që dy bankat e para në radhën e privatizimit të paraqiteshin me një rrjet bankar tërheqës për investitorët. Banka e Shqipërisë do të vëzhgonte dhe mbikëqyrte efektet në situatën financiare të secilës bankë nga transferimet e rrjetit bankar.

Ndërsa Qeveria po merrte masa për përgatitjen për privatizim të bankave shtetërore, ecuria e këtyre bankave vetëm po përkeqësohej. Huat e dhëna u bënë prirje e përgjithshme për mospagim, zhvillimi i tregut informal të grumbullimit të parave me fajde dhe destabilizimi i vendit nga ngjarjet e vitit 1997 e përkeqësuan situatën financiare të bankave shtetërore. Kjo i detyroi autoritetet përkatëse të pezullonin huadhënien nga bankat shtetërore pas vitit 1997, me qëllim mos-rëndimin e situatës financiare të tyre dhe në kuadrin e përgatitjes për privatizim. Situata kishte degraduar aq keq, sa në dhjetor të vitit 1997, në kuadër të zbatimit të programit të privatizimit të bankave, u mor vendimi për mbylljen e Bankës Tregtare Agrare, vendim që u realizua në tremujorin e parë të vitit 1998, ku një pjesë e aktivitetit ju kalua Bankës së Kursimeve dhe pjesa tjetër Agjencisë së Trajtimit të Kredive. Pastrimi i librave të Bankës Kombëtare Tregtare dhe të Bankës së Kursimeve, nëpërmjet transferimit të Agjencia e Trajtimit të Kredive, u krye sipas ligjit nr. 8584, datë 15 mars 2000, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8339, datë 30.04.1998 “Për krijimin e Agjencisë së Trajtimit të Kredive”.

Procesi i privatizimit vazhdoi me dy bankat e tjera shtetërore – Bankën Kombëtare Tregtare dhe Bankën e Kursimeve. Sipas strategjisë së privatizimit, Ministria e Financave përzgjodhi dhe emëroi një administrator të huaj (*IDI - International Development Ireland Limited, Dublin, Ireland*) në Bankën Kombëtare Tregtare në vitin 1998, kurse për Bankën e Kursimeve, përveç nënshkrimit të kontratës së menaxhimit me këshillin drejtues të bankës për përgatitjen e saj për privatizim, një shoqëri e huaj u zgjodh për zbatimin e kësaj kontrate. Administratorëve të huaj iu dha e drejta e vetos në lidhje me vendimet që kishin të bënin me huadhënien dhe personelin.

Me realizimin e ftesës për shpallje interesi dhe, më pas, për pjesëmarrje në tenderin e organizuar për shitjen 100 për qind të aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare gjatë vitit 1999, u arrit të shitej Banka Kombëtare Tregtare. Me ligjin nr. 8634, datë 6 Korrik 2000, u miratua marrëveshja e shitjes së aksioneve të shoqërisë anonime “Banka Kombëtare Tregtare” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konsorciumit të Investitorëve Ndërkombëtarë të përbërë nga Kentbank (Turqi), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Pronësia e aksionarëve të rinj hyri në fuqi më 17 tetor 2000.

Shitja e Bankës Kombëtare Tregtare u bë pa kapital, vetëm duke barazuar aktivin me detyrimet. Qeveria shqiptare e shiti bankën të pakapitalizuar, me kusht që blerësit të vendosnin kapital dhe të plotësonin kushtet e Bankës së Shqipërisë për mjaftueshmërinë e kapitalit. Në fakt, blerësit depozituan 10 milionë dollarë, përpara marrjes së Bankës në dorëzim. Kështu u realizua njëkohësisht edhe shitja e Bankës duke e shpëtuar atë nga alternativa e likuidimit, siç ndodhi me Bankën Tregtare Agrare, dhe duke e kapitalizuar atë – gjë që i kurseu buxhetit të shtetit një shumë të konsiderueshme të kapitalit për privatizim.

Privatizimi i suksesshëm i Bankës Kombëtare Tregtare ishte një eksperiencë që mund të zhvillohej më tej në rastin e Bankës së Kursimeve, si banka më e madhe në vend.

Privatizimi i Bankës së Kursimeve

Sipas ligjit të miratuar nga Parlamenti Shqiptar në dhjetor 1999, Banka e Kursimeve do të privatizohej 100%, duke kombinuar pjesëmarrjen e investitorit strategjik (jo më pak se 35% të aksioneve) me institucionet financiare ndërkombëtare (jo më shumë se 49% të aksioneve) si edhe me pjesëmarrjen e kapitalit privat vendas (jo më shumë se 24% të aksioneve).

Rregullime të tjera kërkoreshin në përgatitjen e kësaj banke, ku veçojmë miratimin e ligjit nr. 8726, datë 26.12.2000 “Për mbulimin me bono thesari të detyrimeve të shtetit kundrejt Bankës së Kursimeve dhe rikapitalizimin e saj me bono thesari”. Ndërsa, më 28.12.2000 u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 737 “Për përcaktimin e termave dhe të kushteve të bonove të thesarit për detyrimin e shtetit dhe për rikapitalizimin e Bankës së Kursimeve sh.a.”, që ka të bëjë me mbulimin faktik të detyrimeve të shtetit dhe rikapitalizon bankën me bono thesari në shumën prej 17.2 miliardë lekësh. Kjo shumë siguronte respektimin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Me këto masa, Banka e Kursimeve përmirësonte pozicionin e saj të kapitalit dhe rriste vlerën në treg.

Në fund të qershorit 2001, Ministria e Financave shpalli tenderin ndërkombëtar për privatizimin e Bankës, ku faza e parë duhej të përfundonte brenda shtatorit 2001. Por situata e pafavorshme e tregut financiar në Evropë (proceset e bashkimit dhe të shit-blerjes së bankave, përgatitjet intensive për kalimin në sistemin e euros), angazhimi i shume bankave me emër në rajonin e Evropës Jug-Lindore, situata e destabilizuar në rajon (Maqedoni e Kosovë), zgjedhjet parlamentare të tejkujtura

në vend dhe, së fundi, ngjarjet tronditëse të 11 shtatorit në SHBA – të gjitha këto ndikuan negativisht tek investorët për shprehjen e interesit në privatizimin e Bankës.

Në këto kushte, Ministria e Financave dhe Komiteti i Privatizimit gjykuan se procesi duhej shtyrë, duke përcaktuar si afat për këtë privatizim muajt mars dhe maj të vitit 2002. Ndërkohë, duke pasur parasysh madhësinë e Bankës dhe vështirësinë e drejtimit të saj në periudhën e parë post-privatizimit, një proces masash strukturimi dhe përmirësimi duhej të zbatoheshin deri në privatizim. Këtu përfshiheshin :

- rritja e efektivitetit të degëve dhe agjencive;
- ulja e numrit të punonjësve;
- shtrirja dhe zgjerimi i sistemit informatik;
- transferimi tek Albapost sh.a. i një pjese të pagesës së pensioneve;
- transferimi tek ATK-ja i portofolit të kredive të këqija;
- rivlerësimi i mjeteve të Bankës me asistencën e ekspertëve të huaj;
- regjistrimi i mjeteve fikse në emër të Bankës;
- auditimi i veprimtarisë së Bankës nga një shoqëri e huaj.

Procesi i tenderit për privatizimin e Bankës gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2002 u zhvillua normalisht sipas parashikimit. Grupi i privatizimit ndërmori disa *road-show* për të takuar disa nga bankat më prestigjioze në Itali, Austri, etj., me qëllim prezantimin e Bankës dhe zgjimin e interesit të investorëve për privatizimin e saj.

Pas një procesi përzgjedhjes, dy bankat më të mëdha italiane – Intesa dhe SanPaolo di Torino - vazhduan garën duke përfunduar me një proces të kujdesshëm *Due Dilligence*. Por, në momentet e fundit, përpara hapjes së tenderit, të dyja këto banka u tërhoqën nga gara dhe procesi dështoi përsëri.

Procesi i privatizimit u zhvillua sërish gjatë vitit 2003 dhe në garë u përballën RZB e Austrisë dhe OTP e Hungarisë. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 1, datë 7.1.2004 “Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe



Foto nga ceremonia e shitjes së Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank Austri.

Raiffeisen Zentralbank, Austri, për shitjen 100 për qind të aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a.” miratoi shitjen e aksioneve të Bankës së Kursimeve për 126 milionë dollarë. Shitja u zyrtarizua në Prill 2004, ku pronësia 100 për qind e aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve u transferua te Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft. Në gusht të po atij viti, Banka e Shqipërisë miratoi kërkesën për transferimin e 100 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës së Kursimeve nga Raiffeisen Zentralbank Österreich AG tek Raiffeisen International Bank-Holding AG. Të dyja këto subjekte janë pjesë e Grupit Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB – Group). Transferimi i kapitalit kishte si qëllim ruajtjen e strukturës së përgjithshme të zotërimit të Grupit RZB dhe nuk sillte ndryshim në kontrollin e Bankës së Kursimeve, i cili vazhdon të ushtrohet nga RZB.

Edhe pse me shitjen e Bankës së Kursimeve thuhet se përfundoi privatizimi i bankave shtetërore, në fakt, pjesëmarrja e shtetit në sektorin bankar ekzistonte akoma. Qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Financave, mbante aksione në dy bankat me kapital të përbashkët: Banka Italo-Shqiptare dhe Banka Arabo-Shqiptare Islamike. Në mënyrë që shteti shqiptar të mos zotëronte më aksione në sektorin bankar, duheshin shitur edhe këto aksione. Në maj të vitit 2006 u miratua shitja e 80 për qind të aksioneve të kapitalit aksionar të Bankës Italo-Shqiptare, që i përkisnin 40 për qind Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe 40 për qind Capitalia S.A., Itali, tek aksionari i ri SanPaolo IMI S.p.A., Itali. Hapi i dytë dhe i fundit u ndërmor në vitin 2009, kur Ministria e Financave i shiti Bankës Islamike për Zhvillim 40 për qind të aksioneve në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë (ish Banka Arabo-Shqiptare Islamike). Me këto dy veprime përfundon edhe historia e pjesëmarrjes së shtetit në sektorin bankar. Sektori bankar paraqitet tërësisht i zotëruar nga aksionarë privatë. Tabela 4 paraqet sektorin bankar nga pikëpamja e origjinës së aksionarëve sipas të dhënave të 31 dhjetorit 2011.

Tabela 4: Sektori bankar sipas origjinës së aksionarëve

Numri i bankave	Origjina	Pesha specifike sipas		
		Aktiveve	Depozitave	Huave
4	Greqi	21.0%	18.9%	26.7%
2	Itali	13.1%	12.4%	10.9%
2	Shqipëri	9.4%	9.8%	12.5%
2	Vendet arabe	0.7%	0.5%	0.4%
1	Austri	28.2%	30.0%	23.9%
1	Turqi	17.6%	18.3%	14.9%
1	Francë	5.0%	5.1%	5.4%
1	Gjermani	3.5%	3.4%	4.2%
1	Bullgari	0.8%	0.8%	0.7%
1	Malajzi	0.8%	0.7%	0.4%
16		100.0%	100.0%	100.0%

V. NDRYSHIMET NË LEGJISLACION DHE RRYTJA E NUMRIT TË BANKAVE

Ndryshimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor ka ecur për krah zhvillimit të ekonomisë dhe forcimit të institucioneve.

Ndryshimi i parë në legjislacionin bankar u krye në vitin 1992, kur Kuvendi Popullor miratoi ligjet “Mbi Bankën e Shqipërisë” dhe “Për Sistemin Bankar në Shqipëri”.

Ligji nr. 7559, datë 22.4.1992 “Për Bankën e Shqipërisë” sanksionoi si objektiv primar të Bankës së Shqipërisë, ruajtjen e vlerës së monedhës kombëtare nëpërmjet zbatimit të një politike monetare të përshtatshme, si dhe kompetenca për emetimin e monedhës vendase dhe për përcaktimin e regjimit të këmbimeve valutore. Ligji ofroi siguri për një pavarësi relative të Bankës së Shqipërisë, ku asnjë organ shtetëror nuk mund t’i jepte direktiva Bankës së Shqipërisë, të merrte vendime në emër të saj, apo të anulonte ndonjë vendim të saj. Po kështu, elementë të pavarësisë lidheshin me emërimin e guvernatorit dhe të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

Aprovimi i ligjit të sipërpërmendur i dha Bankës së Shqipërisë të drejtën dhe autoritetin për të nxjerrë udhëzime dhe rregullore në zbatim të ligjit. Ndër to mund të veçohet paketa e rregullave për licencimin e bankave tregtare në maj 1994 lidhur me veprimtarinë, informacionin mbi gjendjen financiare, personalitetin dhe besueshmërinë e kërkuesit, si dhe me reputacionin, aftësinë profesionale dhe besueshmërinë e pronarëve dhe të drejtuesve. Në qershor 1994, rregullorja “Për mjaftueshmërinë e fondeve të veta të bankave” përcaktoi se për bankat me kapital të shtetit shqiptar, për bankat e përbashkëta të shtetit shqiptar dhe kapitalit të huaj, si dhe për degët e bankave të huaja që u përkisnin vendeve të OECD-së, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit do të ishte jo më pak se 8 për qind, ndërsa për bankat e tjera kjo normë u vendos jo më pak se 15 për qind.

Ndryshimi i dytë u realizua në shkurt të vitit 1996 me dy ligjet e reja: ligji nr. 8075 “Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 8076 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” përcaktoi qartë dhe pa ekuivoke pavarësinë institucionale të bankës qendrore. Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë përcaktohej ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Ligji, gjithashtu, përcaktoi politikën e këmbimeve dhe të administrimit të rezervave valutore, të organizimit dhe të administrimit të Bankës së Shqipërisë dhe kufirin për kredinë e bankës qendrore për qeverinë.

Ligji “Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë” sanksionoi rregullat për licencimin e bankave të nivelit të dytë dhe të institucioneve të tjera financiare, organizimin dhe drejtimin e bankave duke saktësuar piramidën e vendimmarrjes që nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve dhe funksionet e këshillit drejtues,



Pamje aktuale e degës së BKT në Durrës, ndërtesë e përruar më 30 nëntor 1925.

përgjegjësitë për administrimin dhe drejtimin e bankës, operacionet e lejuara të veprimtarisë bankare në varësi të madhësisë së kapitalit, pjesëmarrjen në operacionet e tregut të letrave me vlerë, marrjen në kujdestari dhe likuidimin e bankave në harmoni me rregullat dhe kriteret që zbatohen për falimentimet, rregullat për mbikëqyrjen dhe raportimin nga firmat dhe institucionet jo bankare që kryejnë operacione bankare, dispozita për kualifikimin dhe cilësitë e administratorëve, sekretin, konfliktet e interesave, parandalimin e pastrimit të parave me origjinë nga aktivitetet kriminale si droga, tregtia e armëve, etj.

Pas miratimit të këtyre dy ligjeve, u bë i domosdoshëm rishikimi i gjithë kuadrit rregullues dhe mbikëqyrës të sistemit bankar. Ndër ndryshimet më të rëndësishme që ndodhën, mund të përmendim cilësimin që bankat duhet të jenë shoqëri aksionare, ku kapitali të jetë i ndarë në aksione me vlerë nominale, kapitali minimal të jetë njësoj për të gjitha bankat pavarësisht natyrës së aksionarit, licencimi të ndodhë në dy faza (faza paraprake dhe pastaj licenca përfundimtare), si dhe kërkesa të tjera lidhur me planin e biznesit të një banke të re, për administratorët, për aksionarët që kanë më shumë se 10 për qind të aksioneve, etj.

Ndryshimet, rregullimet, përmirësimet dhe plotësimet për mënyrën e licencimit të një banke, ishin një kërkesë e domosdoshme në kushtet e rritjes së kërkesave për të marrë licencë për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë. Vetëm në vitin 1996 u paraqitën shtatë kërkesa me dokumentacion të plotë për t'u licencuar si bankë dhe disa të tjera në proces të plotësimit të dokumentacionit. Me licencë përfundimtare u pajisën Banka Kombëtare e Greqisë, si banka më e madhe e Greqisë, dhe Banka e Pireut, si banka e parë private e huaj në Shqipëri, ndërkohë që licenca paraprake ju dha investitorit malajzian të propozuar me emrin International Commercial Bank dhe tjetra për hapjen e degës së Alpha Credit Bank në Tiranë. Në shqyrtim të dokumentacionit ishte kërkesa e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve dhe Commercial Bank of Greece. Të gjitha këto e rritën numrin e bankave në 8 në fund të vitit 1996. Konkretisht:

Banka me kapital shtetëror:	Banka me kapital të përbashkët	Banka me kapital privat:	Banka me kapital të huaj privat:	Banka me kapital të huaj shtetëror:
1. Banka Kombëtare Tregtare	1. Banka Italo-Shqiptare	1. Banka Dardania	1. Banka Tirana	1. Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë
2. Banka Tregtare Agrare	2. Banka Arabo-Shqiptare Islamike			
3. Banka e Kursimeve				

Ndryshimi i tretë i kuadrit ligjor për bankat u realizua në vitin 1997.

Zhvillimet në vitin 1996 dhe sidomos ato në vitin 1997 treguan dobësi në pavarësinë e Bankës së Shqipërisë. Prandaj shfuqizimi i ligjit nr. 8076, datë 22.02.1996 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ishte më shumë kërkesë e forcimit real dhe

formal të pavarësisë së bankës qendrore të sanksionuara në ligjin e ri nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”. Ky ligj, i ndryshuar, vazhdon të jetë në fuqi.

Ndryshimi i tretë i ligjit për bankat u realizua në vitin 1998. Ligji nr. 8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” shfuqizoi ligjin nr. 8075, datë 22.02.1996 “Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë”. Ligji i ri pasqyroj ndryshimet e ndodhur në sistemin bankar dhe plotësoi mangësitë e vërejtura gjatë zbatimit të ligjit, në mënyrë që të sigurohej kapitalizimi i duhur i bankave dhe rregullat e duhura për hyrjen dhe daljen nga sistemi bankar. Minimumi i kapitalit rregullues për bankat u rrit nga 200 milionë lekë që ishte në 1996, në 350 milionë lekë në 1997 dhe më tej në 700 milionë lekë në prill 1998 (bankat ekzistuese paguan kapitalin minimal prej 500 milionë lekë brenda shtatorit të vitit 1999 dhe plotësuan shumën prej 700 milionë lekë në mars 2001). Kërkesat për licencim u përforcuan dhe kërkonin përfshirjen e informacioneve shtesë lidhur me planet e biznesit dhe kualifikimin e drejtuesve. Të gjitha bankat tregtare të licencuara për të ushtruar aktivitet bankar në Shqipëri iu nënshtruan shqyrtimit për të përmbushur me përpikëri kriteret e reja të vendosura.

Këto ndryshime ndikuan në ringjalljen e sistemit bankar dhe në forcimin e rëndësisë së tyre për jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit. Gjatë vitit 1998 u dhanë edhe dy licenca të reja duke e çuar në 10 numrin e bankave përbërëse të sektorit bankar (shih Tabela 5).

Tabela 5: Sektori bankar në vitin 1998

Bankat	Numri i degëve	Kapitali i paguar ndaj pasivit, në %	Totali i depozitave ndaj pasivit, në %	Totali i kredive ndaj aktivitetit, në %	% e kredive të këqija ndaj totalit të kredive	L/V (bono thesari) në % ndaj sektorit bankar
Banka shtetërore						
Banka Kombëtare Tregtare	10	12.3	74.3	5.2	84.1	0.7
Banka e Kursimeve	33	0.3	88.4	6.3	50.7	97.6
Bankat private dhe me kapital të përbashkët						
Banka Italo-Shqiptare		19.9	63.4	41.4	8.4	0.5
Banka Arabo-Shqiptare Islamike		90.1	10.9	0.0	0.0	0.0
Banka Dardania		4.3	12.6	2.4	16.5	0.0
Banka Tirana	2	15.7	63.3	18.0	20.3	0.5
Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë		7.0	81.1	0.0	0.0	0.3
Banka Tregtare Ndërkombëtare		58.8	48.8	31.0	0.0	0.1
Dega e Bankës Alpha Kredit		14.7	44.5	12.5	0.0	0.2
Banka Amerikane e Shqipërisë		32.8	44.5	0.0	0.0	0.0

Bankat, në përgjithësi, zhvillojnë një aktivitet universal, duke bërë përjashtim vetëm Banka Arabo-Shqiptare Islamike, e cila operon me parimet bankare islamike, duke mos pranuar depozita me afat dhe duke mos dhënë kredi. Megjithatë, përsëri dominuese në sektorin bankar mbetet Banka e Kursimeve. Kjo, kryesisht, në pranimin e depozitave dhe në investime në bono thesari, të cilat përfaqësojnë respektivisht 78.8 për qind dhe 97.6 për qind të totalit të depozitave dhe të investimeve në bankat e nivelit të dytë.

Licencimi i bankave të reja vazhdoi edhe në vitin 1999. Numrit të bankave ju shtuan tri banka të reja private: Banka FEFAD, Banka e Parë e Investimeve – Dega Tiranë dhe Banka Ndërtregtare. Në Tetor të vitit 2000, me privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., sektorit iu shtua edhe një bankë tjetër private. Kurse në vitin 2002 u licencua “Banka e Kreditit të Shqipërisë”.

Tregu bankar pësoi zhvillime të rëndësishme gjatë vitit 2003, që konsistojnë në shtimin e numrit të bankave, në ndryshimet e aksionarëve dhe në ndryshime emri. Kështu:

- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori vendimin për dhënien e licencës për Bankën “Credins” për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.
- Banka e Shqipërisë i dha leje Bankës Amerikane të Shqipërisë për hapjen e një dege banke jashtë vendit, në Athinë, Greqi.
- Bankës Popullore Pulieze iu dha licencë për hapjen e një zyre përfaqësimi në Tiranë.
- Banka e Shqipërisë miratoi ndryshimin në strukturën e aksionarëve të Bankës Tirana.
- U miratuan ndryshime të emrave të Bankës Arabo-Shqiptare Islamike në Banka e Bashkuar e Shqipërisë dhe Bankës FEFAD në Banka ProCredit.

Viti 2004 shënon ndryshime të tjera të rëndësishme. Kështu, në shkurt hyri në tregun bankar, Banka Popullore sh.a., banka e dytë me kapital tërësisht shqiptar. Në prill u miratua transferimi i 100 për qind të pronësisë së aksioneve të Bankës së Kursimeve tek Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft, si kurorëzim i procesit të privatizimit të kësaj banke. Kurse Banka Tregtare e Greqisë, Shqipëri ndryshoi emrin në Banka Emporiki.

Në fund të vitit 2004, numri i bankave në Shqipëri ishte 16, nga të cilat 2 banka me kapital tërësisht vendas dhe në 14 bankat e tjera ku mbizotëronte kapitali i huaj.

Në qershor të vitit 2005 u miratua shitja e 100 për qind të aksioneve të kapitalit të bankës Dardania tek një individ dhe një bankë me origjinë italiane si dhe u dha miratimi për ndryshimin e emrit në “Banka Italiane e Zhvillimit”.

Që nga viti 1998, deri në vitin 2005, sektori bankar duket i tjetërsuar nga pikëpamja e përbërjes dhe e rolit që luajnë bankat private në ekonomi. Ndryshimet e ndodhura e bënë të domosdoshme ndërhyrjen në ligjin përkatës.

Ndryshimi i katërt për sektorin bankar u realizua në vitin 2006.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” duke shfuqizuar ligjin nr. 8365, datë 2.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Ligji i ri rregullon veprimtarinë e bankave dhe të degëve të bankave të huaja, që veprojnë në vend. Ligji ishte fryt i përvojës së zhvillimeve disavjeçare në sektorin bankar shqiptar dhe i harmonizimit të saj me praktikatat dhe përvojat më të mira evropiane. Ai parashikon në mënyrë më të detajuar kërkesat për licencimin e bankave dhe të degëve të bankave të huaja, për transparencën e bankave me publikun, për standarde më të mira për përgjegjshmërinë në drejtimin e bankave, për procesin e kujdestarisë dhe të likuidimit, për ekspertët kontabël të autorizuar, për nevojat për kapital, për mbikëqyrjen e konsoliduar, etj., me qëllim përmbushjen e objektivit për sigurimin e stabilitetit financiar.

Viti 2006 karakterizohet nga disa ndryshime të tjera të vullshme në sektorin bankar, në favor të forcimit të aksionarëve. Ndryshimet e ndodhura janë:

- Në muajin maj u miratua shitja e 80 për qind të aksioneve të kapitalit aksionar të Bankës Italo-Shqiptare, që i përkisnin Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Capitalia S.A., Itali, tek aksionari i ri SanPaolo IMI S.p.A., Itali.
- U miratua transferimi i pronësisë së 60 për qind (plus 2 aksione) të aksioneve të kapitalit aksionar të Bankës Kombëtare Tregtare nga Kent Bank/Bayindir Bank, tek aksionari i ri institucional turk, Çalik-Seker Konsorsiyum Yatirim Anonim.
- Në gusht u miratua transferimi i pronësisë së 11.25 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës ProCredit nga BERZH tek ProCredit Holding AG (aksionar ekzistues).
- Në tetor u miratua transferimi i 71.97 për qind të aksioneve të kapitalit të Bankës Emporiki S.A. të Greqisë tek aksionari Credit Agricool S.A., Francë. Ky transferim ndikon edhe në pjesëmarrjen indirekte të Credit Agricool S.A. tek kapitali aksionar i Bankës Emporiki të Shqipërisë sh.a., në të njëjtën masë.
- U dha miratimi për dy degë të bankave jashtë territorit të Shqipërisë.
- Me licencimin e Bankës Union, shkon në tre numri i bankave me kapital tërësisht shqiptar dhe në 17 numri total i bankave.

Gjatë vitit 2007, sektori bankar u përball me ndryshime të rëndësishme strukturore në industrinë bankare. Numri i bankave me kapital privat tërësisht shqiptar pësoi ulje (vetëm dy banka - Banka Union dhe Banka Credins) nga tre që ishin një vit më parë, për shkak të interesimit në rritje të grupeve të fuqishme bankare evropiane për të qenë prezent në tregun shqiptar. Kështu:

- Në muajin qershor u miratua shitja e 80 për qind të aksioneve të kapitalit aksionar të Bankës Amerikane të Shqipërisë, zotëruar nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve, SHBA tek aksionari i ri Intesa Sanpaolo S.p.A., Itali.
- Në muajin korrik iu dha licenca përfundimtare për ushtrimin e veprimtarisë bankare, Bankës së Parë të Investimit, Albania sh.a. Banka u krijua si rezultat

i transformimit nga degë në filial të Bankës së Parë të Investimit në Bullgari.

- U miratua shitja e 75.006 për qind e aksioneve të kapitalit aksionar të Bankës Popullore, që i përkiste 32 aksionarëve shqiptarë, tek Banka Societe General, Francë.
- Në muajin gusht u miratua transferimi i pronësisë së 76.129 për qind të aksioneve të kapitalit aksionar të Bankës Italo-Shqiptare sh.a., nga aksionari SanPaolo IMI S.p.A., Itali tek aksionari Intesa Sanpaolo S.p.A., Itali. Ky transferim konsistoi në bashkimin me përthithje të shoqërisë SanPaolo IMI S.p.A., Itali me shoqërinë Intesa S.p.A., Itali dhe krijimin mbi këtë bazë të shoqërisë Intesa Sanpaolo S.p.A., Itali.
- Në muajin dhjetor u dha miratimi i bashkimit me përthithje të Bankës Italo Shqiptare në Bankën Amerikane të Shqipërisë.
- ProCredit Holding AG, Gjermani rriti pjesëmarrjen e tij në kapitalin aksionar të Bankës ProCredit, nëpërmjet blerjes së aksioneve që zotëroheshin nga IFC dhe FEFAD Shqipëri. Pas këtij transaksioni, pjesëmarrja në kapitalin e bankës e shoqërisë ProCredit Holding AG, Gjermani do të jetë 80 për qind.

Këto prirje të konsolidimit të sektorit bankar vazhduan edhe në vitin 2008, ku u miratua:

- blerja e aksioneve të kapitalit aksionar të Bankës Union sh.a. në masën 12.5 për qind nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH);
- transferimi i pronësisë të 76.83 për qind të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit aksionar të Bankës Italiane të Zhvillimit sh.a. nga aksionarët ekzistues tek Veneto Banca Holding S.c.p.A., Itali;
- revokimi i licencës së Bankës Italo-Shqiptare, aktiviteti i të cilës u transferua tek Banka Amerikane e Shqipërisë, dhe Degës të Bankës së Parë të Investimeve për shkak të licencimit të Banka e Parë e Investimeve;
- ndryshimi i emrit të Bankës Amerikane të Shqipërisë në Banka Intesa Sanpaolo, Shqipëri (Intesa Sanpaolo Bank, Albania);
- ndryshimi në strukturën e aksionarëve të Bankës Credins, ku aksionari BFSE Holding BV, Holandë, nëpërmjet blerjes së aksioneve ekzistuese si edhe nëpërmjet nënshkrimit të aksioneve të reja, zotëron 22.17 për qind të kapitalit aksionar të bankës.

Zhvillimet e fundit i takojnë vitit 2009, ku u miratuan:

- rritja e pjesëmarrjes influencuese të Çalik Holding A.S. Turqi (aksionar i tërthortë) nga 25.2% në 45.6% në kapitalin aksionar të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., dhe
- rritja e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit Banka Islamike për Zhvillim, nga 15% në 55% të aksioneve, nëpërmjet blerjes së 40 për qind të aksioneve të Ministrisë së Financave në kapitalin aksionar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.

Ndryshimet e herëpashershme në legjislacion, për forcimin e kuadrit ligjor

dhe rregullues të sistemit bankar, janë shoqëruar me rritje të kërkesave për licencim bankash. Rritja e kërkesës për licencim është tregues i rritjes së shkallës së besueshmërisë në ekonominë shqiptare, i rregullimit të ambientit investues, i autoritetit të bankës qendrore për rregullimin e këtij tregu dhe një mësim i drejtë i nxjerrë dhe i realizuar nga zhvillimet e padëshiruara të skemave piramidale gjatë periudhës 1994 – 1997.

Tabela 6 përmbledh të gjitha zhvillimet e ndodhura në sektorin bankar që nga viti 1992 deri në 30 qershor 2012.

Tabela 6 : Sektori bankar pas vitit 1991

Nr	Emri i bankës	Data e licencimit	Fillimi i aktivitetit	Zhvillime të mëpasshme
1	Banka e Kursimeve	Krijuar me ligjin nr. 7505, datë 31.07.1991 "Për Bankën e Kursimeve"	Janar 1991	<ul style="list-style-type: none"> Rilicencuar¹ më 11 dhjetor 1998 Privatizuar nga Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft, prill 2004
2	Banka Kombëtare Tregtare	Vendim i Bordit Mbikëqyrës të BSH 28 Dhjetor 1992. Licencuar më 23 Nëntor 1995	Janar 1993	<ul style="list-style-type: none"> Rilicencuar më 11 dhjetor 1998 Privatizuar më tetor 2000
3	Banka Arabo-Shqiptare Islamike	5 Dhjetor 1992	Maj 1993	<ul style="list-style-type: none"> Rilicencuar më 11 dhjetor 1998 Ndryshon emrin në "Banka e Bashkuar e Shqipërisë", tetor 2003
4	Banka Italo-Shqiptare	Ligji nr. 7649, datë 16.12.1992 "Për krijimin e Bankës së Përbashkët Italo-Shqiptare"	Qershor 1993	<ul style="list-style-type: none"> Pajisur me licencë më 18 qershor 1998 Blerë nga "San Paolo IMI", dhjetor 2005 Bashkuar në "Banka Intesa Sanpaolo", 2008 Rilicencuar më 11 dhjetor 1998
5	Banka Dardania	Dhjetor 1993	1994	<ul style="list-style-type: none"> Blerë nga "Banka Italiane për Zhvillim", 2005 Ndryshuar emrin në "Banka Veneto", 2009
6	Banka Ndërkombëtare Tregtare	20 Shkurt 1997	Janar 1996	
7	Banka Kombëtare e Greqisë Dega Shqipëri	14 Mars 1996	Nëntor 1996	<ul style="list-style-type: none"> Shndërruar në filial me emrin "Banka NBC Albania" në shkurt 2012
8	Banka Tirana	30 Prill 1996	Qershor 1996	
9	Banka Alpha Credit - Dega Shqipëri	27 Dhjetor 1996	1998	<ul style="list-style-type: none"> Shndërruar në filial me emrin "Banka Alpha Albania" në shkurt 2012
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	10 Gusht 1998	Shtator 1998	<ul style="list-style-type: none"> Blerë nga "Banka Intesa Sanpaolo", 2008
11	Banka FEFAD	3 Mars 1999	Qershor 1999	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshon emrin në "Banka ProCredit", 2003
12	Banka Ndërtregtare	19 Tetor 1999	1999	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshuar emrin në "Banka Tregtare e Greqisë - Shqipëri", qershor 2001 Ndryshuar emrin në "Banka Emporiki – Shqipëri", 2004
13	Banka e Parë e Investimeve Dega Shqipëri	13 Prill 1999	1999	<ul style="list-style-type: none"> Shndërruar në filial me emrin "Banka e Parë e Investimeve, Shqipëri", korrik 2007
14	Banka Credins	31 Mars 2003	Mars 2003	
15	Banka e Kreditit	28 Korrik 2002	Mars 2003	
16	Banka Popullore	16 Shkurt 2004	Mars 2004	<ul style="list-style-type: none"> Blerë nga "Société Générale Group", korrik 2007
17	Banka Union	9 Janar 2006	Janar 2006	

¹ Rilicencimi u bë në bazë të kërkesave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"

VI. PËRBALLIMI I KËRCËNIMEVE FINANCIARE

Ndryshimet, rritja dhe zhvillimi i sektorit bankar nuk mund të bëheshin pa u ndeshur me vështirësi të rritjes ekonomike dhe të tranzicionit. Mungesa e sistemit të plotë ligjor, mungesa e kulturës së ekonomisë së tregut, niveli i ulët i zhvillimit të ekonomisë dhe reformat e shumta të ndërmarra krijuan gjatë viteve të caktuara përballjen e tendencës për ndryshim dhe ecjen përpara si një dëshirë objektive me fenomene negative që rridhnin nga mungesa e ligjit, moszbatimi i ligjit dhe nga dobësia e institucioneve.

Sektorit bankar iu desh të përballej me tre kërcënime financiare në rrugën e vet të konsolidimit.

Kërcënimi i parë ka të bëjë me zhvillimin e tregut joformal në periudhën 1994 – 1996, zhvillim i cili çoi në krijimin e firmave piramidale. Ekzistenca e një sektori bankar të dobët shtetëror, mungesa e tregut të huas bankare, mungesa e legjislacionit dhe e paqartësisë së marrëdhënieve të pronësisë, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, nevoja për fonde për zhvillim të sipërmarrjes private, krijuan hapësirën e përdorimit të huamarrjes individuale, fillimisht nga familjarët dhe të njohurit dhe pastaj nga publiku i gjerë. Kjo skemë e financimit për nevoja të zgjerimit dhe të rritjes së një subjekti të vogël e të mesëm, në kushtet e mungesës së ri-investimit të fitimit të mjaftueshëm, duket e pranueshme në rastet e përdorimit të kufizuar dhe deri në një raport që nuk rrezikon kapitalin e vet. Kjo nuk u mbajt në konsideratë nga tregu, në të cilin kërkesa për fonde dhe pagimi i interesave për fondet e marra hua nuk ishin as spekulative, por skema piramidale të pastra.

Të marra së bashku, shoqëritë dhe fondacionet e klasifikuara piramidale iu kundërvunë sektorit bankar, duke konkurruar politikën e mbledhjes së depozitave. Në nëntor 1996, normat e interesit arritën pikën më të lartë. “Xhaferri” ofronte 47 për qind në muaj, “Populli” ofronte 39 për qind në muaj, “Sude” ofronte 41 për qind në muaj, VEFA ofronte 8 për qind në muaj dhe të tjerët nga 10 për qind në muaj. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë, si kufi të poshtëm për depozitat me afat 12 mujor, kishte vendosur interesin prej 16 për qind. Nga njëra anë, për mungesën e huadhënies, bankat morën shpëtim duke humbur depozita nga individët, dhe, nga ana tjetër, për shkak të mungesave alternative për investime, këto fonde, në një pjesë të konsiderueshme, u rikthyen në banka nga vetë fondacionet dhe shoqëritë tregtare. Fakti që ky treg i huamarrjes ofronte norma interesi shumë të larta dhe aspak konkurruese nga bankat, e nxori sistemin bankar jashtë loje. Banka e Shqipërisë vazhdonte politikën monetare nëpërmjet instrumenteve direkt të vendosjes së përqindjes minimale të normave të interesit të depozitave, duke pasur si parim kryesor ruajtjen e interesit në terma realë pozitivë. Por publiku u josh nga normat e ofruara nga tregu jo-bankar, që në thelb ishte piramidale.

Përballja me tregun piramidale e bëri të domosdoshëm reformimin e sektorit

bankar, privatizimin e bankave shtetërore, të cilat, në vitin 1996 mbanin 97 për qind të depozitave, rritjen e bankave me kapital privat, përmirësimin e legjislacionit dhe ndërmarrjen e reformave të domosdoshme për krijimin e ambientit të huadhënies. Përveç dobësive të shfaqura nga sistemi bankar në financimin e nevojave të tregut, rritja dhe rënia e shoqërive dhe e fondacioneve piramidale forcoi rëndësinë e ruajtjes së depozitave pranë sektorit bankar. Në thelb, vlerësimi i publikut për bankat u rrit shumë në vitet që pasuan duke u shoqëruar me rritje të ndjeshme të depozitave. Këtë kërcënim sistemi bankar e fitoi duke mos rënë pre e konkurrencës së tregut piramidale në grumbullimin e depozitave dhe nga fakti që ndërmjetësimi i bankave në ekonomi ishte i dobët.

Kërcënimi i dytë ka të bëjë me krizën e besimit të muajve mars – prill 2002. Pranvera e vitit 2002 filloi shumë keq për sektorin bankar. Brenda muajit mars, nga dy bankat më të mëdha, Banka e Kursimeve dhe Banka Kombëtare Tregtare, u tërhoqën 12.1 miliardë lekë dhe në muajin prill u tërhoqën 9.4 miliardë lekë. Kjo tërheqje masive nuk justifikohet nga zhvillimi i sektorit bankar, i cili, që pas vitit 1997, erdhi duke u forcuar si nga pikëpamja ligjore dhe e mbikëqyrjes, ashtu edhe nga pikëpamja e treguesve të ecurisë¹. Duke studiuar situatën kur filloi tërheqja, janë tre ngjarje që dominojnë jetën e vendit: ligji i ri “Mbi sigurimin e depozitave”, shtesa e ligjit “Mbi kompensimin e pronarëve” dhe procesi i privatizimit të Bankës së Kursimeve. Duket sikur këto nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, por, në fakt, të tria konvergjojnë te buxheti i shtetit. Edhe kompensimi i pronarëve, edhe privatizimi i Bankës së Kursimeve kërkonin fonde nga buxheti. Këto fonde mund t’i shkaktonin presion inflacionit, në kushtet kur depozitat e pasiguruara të qytetarëve përdorëshin në masën më të madhe për të financuar deficitin buxhetor. Krijohej kështu një cikël, i cili, duke nisur nga mungesa e sigurimit të depozitave në sektorin bankar, bëhej më i fortë dhe i besueshëm mbi pasigurinë e nesërme. Në këtë klimë u shfaq paniku bankar, i cili filloi në rajonin Fier - Vlorë dhe me disa përjashtime mbeti i izoluar atje.

Fitorja e sistemit bankar ndaj kërcënimit të dytë ishte, së pari, përgjigja e shpejtë pa asnjë vonesë e plotësimit të çdo kërkesë për tërheqje. Duke qenë se bankat ishin shumë likuide (sipas bilancit të datës 31 dhjetor 2001, 52 për qind e aktiveve ishin në bono thesari dhe vetëm 8 për qind në kredi), ato nuk patën vështirësi reale në përballimin e radhës së depozituesve për tërheqje. Së dyti, fenomeni mbeti i shkëputur në dy banka shtetërore: Banka e Kursimeve dhe Banka Kombëtare Tregtare. Edhe pse Banka Kombëtare Tregtare ishte privatizuar, akoma nga shumë depozitues konsiderohej si bankë shtetërore. Së treti, paniku bankar ushtroi presionin e vet te ligjvënësit për miratimin e ligjit mbi sigurimin e depozitave. Ky ligj u miratua më 29 mars 2002 dhe i siguronte depozituesit 100 për qind të fashës së parë prej 350,000 lekë dhe vetëm 85 për qind të fashës së dytë prej 350,000 lekë. Kështu, depozituesve të bankave ju siguroi një mbështetje e fortë ndaj sigurisë dhe ndaj qëndrueshmërisë së sektorit bankar.

¹ Për më shumë, shih: Shkëlqim Cani dhe Ilir Vika: “Kriza e konfidencës – Shkaqet prapa hemorragjisë së depozitave bankare”, Banka e Shqipërisë, Korrik 2002

Kërcënimi i tretë ka të bëjë me efektin e krizës financiare globale të muajit tetor 2008, pas falimentimit të Lehman Brothers në shtator 2008. Edhe pse sistemi bankar shqiptar nuk ishte drejtpërsëdrejti i lidhur me tregjet financiare ndërkombëtare, ishin marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike me vendet e tjera që krijojnë pasiguri dhe efekte të ndërsjella mbi ekonominë. Shqipëria kishte një fluks shumë të lartë të transfertave nga emigrantët, të cilat llogariteshin rreth 800 milionë euro për vitin 2008, me një rënie rreth 16 për qind nga një vit më parë⁸ dhe vinin kryesisht nga vendet fqinje Greqi dhe Itali dhe nga vendet e zhvilluara si SHBA, Gjermani, Kanada.

Tabela 7 paraqet ecurinë e depozitave në sistemin bankar, duke marrë si pika krahasimi datat 31 dhjetor 2007, 30 shtator 2008, 31 dhjetor 2008 dhe 31 mars 2009. Nëntë-mujori i vitit 2008 shënon rritje të qëndrueshme të depozitave në sistemin bankar, kurse për gjashtë muaj në vijim, periudhë që korrespondon me fillimin e krizës financiare globale, shënon rënie të depozitave. Kështu, depozitat në banka në dhjetor 2008, në krahasim me shtatorin 2008, u ulën me 7.2 për qind kurse depozitat në valutë u pakësuan me 12.4 për qind. Në mars 2009, depozitat arritën pikën më të ulët në krahasim me shtatorin 2008; ato u pakësuan me 9.5 për qind dhe sërish janë depozitat në valutë ato që u ulën më shumë (12.6 për qind). Këto ndryshime në treguesin e depozitave ishin pasojë e drejtpërdrejtë e perceptimit të krizës nga depozituesit e gjerë, e pasigurisë që kjo krizë mund të ndikonte në ekonominë shqiptare. Sërish, depozitat bëhen tregues i ndjeshmërisë së mungesës së konfidencës jo thjesht ndaj sistemit bankar, por ndaj zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

Tabela 7: Ecuria e depozitave para dhe pas krizës financiare (milionë lekë)

Treguesi	Dhjetor '07	Shtator '08	Tetor '08	Nëntor '08	Dhjetor '08	Janar '09	Shkurt '09	Mars '09
Depozitat gjithsej	602,653	667,656	641,349	627,126	619,887	619,988	610,672	604,384
Nga këto në:								
Lekë	351,181	370,018	359,065	354,491	359,187	353,216	346,895	344,306
Valutë	251,472	297,638	282,284	272,635	260,700	266,773	263,777	260,078

Edhe këtë kërcënim, sistemi bankar e përballoi me sukses. Përvoja e grumbulluar gjatë krizës së konfidencës shërbeu edhe në këtë situatë përsëritëse, jo për shkak të mosbesimit ndaj sistemit, por të perceptimit të efekteve të krizës ndaj ekonomisë së vendit. Bankat plotësuan çdo kërkesë për tërheqje duke qenë të bindura se sërish këto para do të rikthehen pas disa muajsh në sistem. Dhe kështu ndodhi vërtet. Nga muaji prill 2009, depozitat filluan të rriten sërish.

Ajo që kërcënimi i tretë konfirmon si mësim, është fakti se perceptimi lidhur me pasigurinë në sistemin tonë financiar shfaqet menjëherë me qëndrimin ndaj depozitave. Në mungesë të tregut të kapitalit, ku tregues të tjerë duhet të matnin këto ndikime të pasigurisë, frikës apo edhe besimit, treguesi i tërheqjes ose i shtimit të depozitave është një barometër i pasigurisë ose i besimit ndaj ngjarjeve të pritshme.

VII. STANDARDE TË REJA DHE PLOTËSIME STRUKTURE NË MBËSHETJE TË FORCIMIT TË VEPRIMTARISË BANKARE

Pas vitit 1992, edhe pse u krijua sistemi dynivelor, edhe pse nisi strukturimi dhe privatizimi i bankave shtetërore, edhe pse u shtua numri i bankave të huaja me kapital shtetëror dhe privat, bankat ishin të vështira të lexoheshin kontabilisht dhe të analizoheshin financiarisht sipas praktikave mirëfunktionuese në vendet me ekonomi të tregut të lirë. Rregullat kontabël ishin të vjetra dhe të pa unifikuar. Nevoja e pasjes së një **plani të ri kontabël** ishte domosdoshmëri e përmirësimit të pasqyrit të veprimtarisë bankare, e matjes së ecurisë së tyre dhe e krahasimit me banka të tjera.

Projekti i hartimit të planit kontabël nisi në nëntor 1996, në kuadrin e programit *Phare* lidhur me reformën bankare, dhe përfundoi në nëntor 1998. Ky plan synonte ndërtimin në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe me rekomandimet e Komunitetit Evropian për kontabilitetin. Projekti u realizua me ndihmën e ekspertëve francezë të shoqërisë “Ernst & Young”.

Ky projekt u realizua me sukses dhe më 1 Janar 1999 u zbatua manuali standard i kontabilitetit për të gjitha bankat.

Një strukturë e re që u krijua për të lehtësuar privatizimin e bankave shtetërore, siç u përmend më lart, ishte **Agjencia e Trajtimit të Kredive**. Kjo agjenci u krijua me ligjin nr. 8339, datë 30 Prill 1998, “Për krijimin e Agjencisë së Trajtimit të Kredive”, për trajtimin e huave të këqija të bankave shtetërore, në kuadrin e pastrimit të librave të këtyre bankave dhe të përgatitjes së tyre për privatizim. Agjencia mori përsipër jo vetëm transferimin kontabël të kredive, por edhe përgjegjësinë për ndjekje dhe mbledhje të tyre. Agjencia vazhdon aktivitetin edhe sot, por vetëm për mbledhjen e kredive të transferuara nga bankat shtetërore në periudhën 1998 – 2000.

Shtimi i shpejtë i numrit të bankave deri në vitin 2000 dhe domosdoshmëria e ndërtimit të një tregu bankar të sigurt, të besueshëm dhe të qëndrueshëm kërkonte garantimin e depozitave nëpërmjet realizimit të skemës së sigurimit të depozitave. Për këtë qëllim, ligji nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave” krijoi bazën ligjore për sigurimin dhe kompensimin e depozitave si dhe krijimin e një institucioni përgjegjës. Ky institucion quhet **Agjencia e Sigurimit të Depozitave**, i krijuar në Tetor 2002. Objektivi kryesor i veprimtarisë së agjencisë është sigurimi dhe kompensimi i depozitave të individëve në sektorin bankar, si edhe kontributi në stabilitetin e sistemit financiar të vendit.

Ligji nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave” u ndryshua nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 10 106, datë 30.03.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave””. Ndryshimet kanë për qëllim kryesor përafrimin me legjislacionin evropian në lidhje me skemën e

sigurimit të depozitave në Shqipëri, si dhe forcimin e rolit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në funksion të rritjes së efektivitetit të skemës së sigurimit të depozitave, të integritetit të vendit tonë në Bashkimin Evropian, si dhe përmirësimin e kushteve ligjore për funksionimin e shëndoshë të sektorit bankar. Një nga ndryshimet e rëndësishme ishte rritja e kufirit të shumës së siguruar deri në 2.5 milionë lekë për çdo depozitues në çdo bankë të siguruar. Çdo subjekt që kërkon të kryejë veprimtari bankare në Shqipëri, e ka të detyruar pjesëmarrjen në skemën e sigurimit të depozitave. Në skemën e sigurimit të depozitave përfshihen të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja që veprojnë në Shqipëri duke derdhur kontributin dhe duke paguar primin e sigurimit.

Përmirësim tjetër i domosdoshëm për veprimtarinë bankare dhe për drejtimin e riskut të kredisë, është krijimi i Regjistrimit të Kredive. Krijimi i **Regjistrimit të Kredive** si dhe kompetencat e Bankës së Shqipërisë lidhur me të, sanksionohen me nenin 127 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Regjistri i Kredive përbën bazën elektronike të të dhënave identifikuese dhe financiare (ekspozimet kreditore në sektorin bankar dhe/ose financiar) të personave (individë, persona fizikë tregtarë dhe persona juridikë), që aplikojnë për kredi pranë një banke, dege të një banke të huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë apo pranë institucioneve të tjera kredidhënëse.

Regjistri i Kredive ka dy qëllime kryesore:

- vlerësimin dhe minimizimin e rrezikut të kredisë me të cilin përballet huadhënësi, duke ndihmuar në kredidhënie të shëndosha; dhe
- forcimin dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së bazuar në risk.

Regjistri i Kredive filloi të funksionojë më 3 Janar 2008 në Bankën e Shqipërisë.

Në fillim, raportueset e të dhënave në Regjistrin e Kredive ishin vetëm bankat dhe degët e bankave të huaja. Duke filluar që nga 19 Nëntori i vitit 2010, baza e të dhënave është pasuruar edhe me informacionin e raportuar nga 5 subjekte të reja jo banka. Kështu, aktualisht, pjesëmarrës në Regjistrin janë 16 banka dhe degë bankash të huaja, 3 subjekte financiare jo banka që ushtrojnë aktivitetin e kredidhënies si dhe 2 unione të shoqërive të kursim kreditit në rolin e përfaqësuesve të shoqërive të kursim kreditit anëtare të tyre.

Raporti i kredimarrësit që marrin raportuesit e të dhënave si produkt i Regjistrimit përmban informacion mbi shumën e kredisë, shlyerjet e saj, shumat e vonuara, garancitë e vëna për të, të dhëna për linjat e kredisë ku kredimarrësi është person i lidhur, historiku i statusit të kredisë për dy vitet e fundit, etj. Përdorimi i historikut të shlyerjes së kredive nga kredimarrësit iu shërben raportuesve të të dhënave në procesin e vendimmarrjes si një informacion mbështetës për dhënien ose jo të kredive të reja, duke reduktuar rrezikun e dhënies së kredive të këqija.

Raportuesit e të dhënave ngarkojnë çdo ditë kreditë e reja si dhe përditësojnë çdo fund muaji statusin e shlyerjes së kredive. Regjistri përmban informacione pozitive dhe negative për kredimarrësin dhe këto të dhëna do të ruhen në Regjistrin për 5 vjet pas mbylljes së kredisë.

Ndryshime të rëndësishme në mbështetje të veprimtarisë bankare për të zhvilluar huadhënien ishin reformimi dhe krijimi i **regjistrit të pasurisë** (së luajtshme dhe të paluajtshme).

Regjistri i pasurisë së paluajtshme ka zanafillën e rregullimit të vet që në vitin 1994 me miratimin e ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar tri herë (mars 1996, maj 2005, prill 2007), derisa u shfuqizua nga ligji i ri nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Sipas kuadrit ligjor, objekt i veprimtarisë së Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është regjistrimi i titujve të pronësisë dhe i të drejtave të tjera reale për pasuritë e paluajtshme, në bazë të dokumenteve ligjore, që vërtetojnë pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe përgatitja, mbajtja dhe administrimi i regjistrave të pasurive të paluajtshme, hartave treguese të regjistrimit dhe dokumentacionit, që vërtetojnë të drejtën e pronësisë dhe të drejtat e tjera reale mbi pasurinë e paluajtshme.

Risi në regjistrimin e pasurisë është *Regjistri i Barrëve Siguruese*. Regjistri i Barrëve Siguruese është krijuar në vitin 2001 sipas ligjit nr. 8573, datë 18.10.1999 “Për barrët siguruese”, i ndryshuar me ligjin nr. 9524, datë 25.04.2006 dhe ligjin nr. 10185, datë 26.11.2009. Ky regjistër rregullohet me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) nr. 493, datë 6.07.2006 “Rregullorja e Barrëve Siguruese”. Që nga prilli i vitit 2009, operimi dhe drejtimi i funksioneve të regjistrit të barrëve siguruese iu kalua me koncesion shoqërisë ROEN Company (Regjistri i Barrëve Siguruese, me të gjithë komponentët e tij, mbetet pronë e METE-s). Ky regjistër është “hipoteka” e pasurive të luajtshme.

Regjistri ka dy funksione:

1. t’u sigurojë barrëmarrësve (kreditorëve) regjistrimin e barrëve siguruese mbi pasurinë e luajtshme të prekshme dhe të paprekshme të barrëdhënësve (debitorëve); dhe
2. t’u sigurojë një sistem informacioni palëve të interesuara për të blerë apo për të dhënë hua duke u bazuar mbi pasuritë e prekshme apo të paprekshme si garanci shtesë.

Regjistri i Barrëve Siguruese është i përbërë nga dy komponentë, baza e të dhënave të klientëve dhe baza e të dhënave të transaksioneve të sigurimit të kredive. Baza e të dhënave të klientëve jep informacion mbi gjendjen e llogarive të klientëve, të të ardhurave të regjistrit, etj. Baza e të dhënave mbi transaksionet e barrëve siguruese është një regjistër elektronik, me anë të të cilit klientët regjistrojnë barrë siguruese, zgjatje vitesh për barrët e sigurisë, ndryshime dhe përfundime të barrëve siguruese ekzistuese.

Klientët kryesorë të regjistrit janë bankat tregtare dhe degët e bankave të huaja, organizata dhe institucione kredidhënëse, shoqëri të leasing-ut, studiot ligjore, studiot noteriale, drejtoritë lokale dhe qendrore të tatim-taksave, si dhe individë të interesuar për kërkimin e barrës siguruese.

VIII. TRANSFERIMI I FONDEVE DHE KRYERJA E PAGESAVE

Një ndër shërbimet bankare më të rëndësishmet të ofruara nga sektori bankar, është transferimi i fondeve dhe realizimi i pagesave për qëllime të ndryshme. Sistemet e pagesave janë kanalet, nëpërmjet të cilave bëhet transferimi i fondeve ndërmjet bankave.

Sistemi i pagesave është një sistem i përdorur për transferimin e parasë. Ajo që e bën atë një “sistem”, është përdorimi i zëvendësuesve të parasë së gatshme. Sistemet e pagesave tradicionale janë instrumentet e negociueshme, të tilla si çeqet dhe kredia dokumentare (si letër kredia). Me avancimin e kompjuterëve dhe komunikimeve elektronike, janë zhvilluar një numër shumë i madh i sistemeve alternative të pagesave elektronike. Këto përfshijnë kartat e debitit, kartat e kreditit, transferimin elektronik të fondeve, kreditimin direkt, debitimin direkt, *internet banking* dhe sistemin e pagesave tregtare elektronike.

Sistemet e pagesave mund të jenë fizike ose elektronike dhe secila prej tyre ka protokollin dhe procedurat e veta. Standardizimi ka lejuar disa prej këtyre sistemeve dhe rrjeteve të rriten në mënyrë globale, por akoma ekzistojnë sisteme specifike në varësi të vendit dhe të produktit. Për shembull, karta e kreditit dhe makina e automatizuar teller (ATM) janë shembuj standardizimi në mënyrë globale. Kurse forma specifike të sistemeve të pagesave lidhen me transaksionet financiare në tregjet e aksionit, borxhit, monedhës, etj.

Termi pagesë elektronike, në kuptimin e ngushtë, i referohet pagesës tregtare elektronike (një pagesë për blerje mallrash dhe shërbimesh të ofruara përmes internetit), kurse në kuptimin e gjerë i referohet çdo tipi të transferimit elektronik të fondeve.

Për rëndësinë që ka në transferimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të fondeve për realizimin e transaksioneve, sistemi i pagesave ka ndikim në stabilitetin financiar të vendit. Thënë ndryshe, siguria dhe efikasiteti i sistemeve të pagesave janë kritike për funksionimin efektiv të sistemit financiar.

Nxitja e një funksionimi normal të sistemit të pagesave është një nga objektivat kryesorë të Bankës së Shqipërisë. Për përmbushjen e këtij objekti, Banka e Shqipërisë ofron infrastrukturën për shlyerjen e pagesave; administron dhe operon një sistem për shlyerjen në kohë reale të pagesave me vlera të mëdha në monedhën kombëtare, dhe një sistem për klerimin dhe shlyerjen automatike të pagesave me vlera të vogla në monedhën kombëtare.

Në Shqipëri funksionojnë dy sisteme ndërbankare pagesash, në pronësi dhe të operuar nga Banka e Shqipërisë, sistemi i pagesave për shlyerje në kohë reale (AIPS) dhe sistemi për klerimin e pagesave me vlera të vogla (AECH).

Sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe

Sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe (AIPS - Albanian Interbank Payment System) është një sistem i shlyerjes bruto në kohë reale. Në të përpunohen të gjitha pagesat ndërbankare në lekë. Ky sistem mbështetet në shërbimin SWIFT FIN Y-copy dhe pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në të janë aktualisht 16 banka, të cilat janë anëtarë të CUG¹ (SWIFT).

Sistemi filloi funksionimin e tij *live* më 31 Janar 2004. Sistemi AIPS hapet çdo ditë pune në orën 8:00. Ai shlyen pagesa ndërbankare dhe për klientët deri në orën 15:30. Në orarin 15:30 deri 16:00 sistemi pranon për shlyerje pagesa për transaksione të tregut ndërbankar si dhe transaksione të iniciuara nga Banka e Shqipërisë. Sistemi fillon mbylletjen e tij në orën 16:30.

Funksionimi i AIPS është rregulluar nga vendimi nr. 53, datë 26.09.2007 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS”

Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël

Banka e Shqipërisë ofron shërbimin e kleringut prej vitit 1997. Nëpërmjet këtij shërbimi ofrohet klerimi i çeqeve dhe i urdhërpagesave ndërbankare të iniciuara nga klientët.

Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH - Albanian Electronic Clearing House) është një sistem elektronik kleringu që mundëson shkëmbimin e *file-ve* të instruksioneve të pagesave midis pjesëmarrësve, llogaritjen e pozicioneve shumëpalëshe neto dhe dërgimin e një instruksioni shlyerjeje neto në sistemin AIPS. Ky sistem kryen transaksione me vlerë deri në 1.5 milion lekë² dhe filloi *live* me datën 8 Korrik 2005.

Ai mbështetet në shërbimin e ofruar nga SWIFT-i dhe pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në të janë 16 banka. Në këtë sistem merr pjesë, si pjesëmarrës i tërthortë, edhe Ministria e Financave dhe pagesat e saj shlyhen nëpërmjet llogarisë teknike të Bankës së Shqipërisë.


Gjatë një dite pune, në sistemin AECH qendror, zhvillohen tre seanca kleringu, sipas orareve të përcaktuara. Seanca e parë fillon në orën 8.30 dhe përfundon në orën 10.15, seanca e dytë fillon në orën 10:30 dhe përfundon në orën 12:45 ndërsa seanca e tretë fillon në orën 13:00 dhe përfundon në orën 15:00. Mbyllja e sistemit AECH realizohet në orën 16:15.

Për sa i takon çeqeve ndërbankare dhe personale, klerimi i tyre vazhdon të realizohet nëpërmjet shkëmbimit fizik në seancat e kleringut që zhvillohen çdo ditë në orën 13:00 në Bankën e Shqipërisë.

Funksionimi i AECH është rregulluar me vendimin nr. 55, datë 26.09.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël - AECH”.

¹ CUG (Closed User Group) - janë përdoruesit e SWIFT-it të grupuar me qëllim përdorimin e shërbimit SWIFT-Net FileAct.

² Ky kufi u rrit në mars 2011; ishte 1 milion lekë dhe u bë 1.5 milionë lekë



Pas vitit 2000, sektori bankar gjithnjë e më shumë i ofroi publikut shumë nga llojet e pagesave elektronike. Këto instrumente pagesash prezantoheshin për herë të parë në vend. Hapi i parë u hodh me ofrimin e kartave të debitit dhe më ngadalë kartave të kreditit, instalimit të ATM-ve dhe POS-eve. Tabela 8 dhe Tabela 9 pasqyrojnë gjendjen e kartave të emetuara dhe ATM-ve dhe POS-ve të instaluara. Nga viti 2004, që është marrë si vit krahasimi, nga pikëpamja sasiore, konstatohet një zhvillim i vrullshëm i infrastrukturës dhe i përpjekjeve të bankave për të përfituar më shumë nga këto instrumente të reja. Në fund të vitit 2011 rezultonin 11 banka emetuese të kartave dhe vetëm 7 nga këto janë licencuar edhe për pranimin e kartave (pagesat nëpërmjet POS-eve).

Tabela 8: Numri i kartave sipas funksioneve

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Kartë debiti	33,288	217,799	229,021	427,430	482,072	543,141	667,548	687,597
Kartë krediti	806	2,686	9,754	10,439	15,246	22,793	27,300	31,391

Tabela 9: Numri i POS-eve dhe ATM-ve në vite

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
POS	155	779	1,234	1,832	2,953	4,370	4,903	5,126
ATM	93	205	309	433	642	741	771	805

Pavarësisht rritjes së shpejtë sasiore, pagesat në formë elektronike mbeten në nivele të ulëta. Për vitin 2011 ato zënë vetëm 2.46 për qind të pagesave të klientëve. Pozitive është që numri i llogarive që kanë qasje nga interneti, po rritet. Ky tregues është rritur nga 15 mijë në vitin 2009 në 37 mijë në vitin 2011. Po kështu, numri i kartave të kreditit dhe debitit po vazhdon të rritet.

IX. KËRKESA PËR KAPITAL MINIMAL

Kërkesat për aplikim dhe licencim për bankë kanë njohur dinamikë zhvillimi që shkon përkrah ndryshimeve në ekonomi, siç janë rritja ekonomike, forcimi i qëndrueshmërisë së bankës, përafrimi me standardet ndërkombëtare, ndryshimi i kursit të këmbimit, mbyllja e shtegut të hyrjes së investimeve spekulative.

Periodha deri në vitin 1995 është e paqartë lidhur me madhësinë e kapitalit për bankë. Në këtë periudhë, bankat e krijuara janë trajtuar si raste individuale me ligj të veçantë të parlamentit ose me vendime të Bankës së Shqipërisë. Për shembull, më 29 prill 1993, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë miratoi dokumentin e përgatitur nga Drejtoria e Mbikëqyrjes “Mbi përcaktimin e kapitalit, rezervës dhe ndarjen e fitimit të bankave tregtare”, sipas të cilit u miratua shuma minimale e kapitalit të papreکشëm (milione lekë) për bankat shtetërore si vijon:

Banka Kombëtare Tregtare	2,700
Banka e Kursimeve	700
Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit	800

Ose, kur në korrik 1993 filloi aktivitetin Banka Italo-Shqiptare, kapitali i saj ishte 10 milionë USD. Ai ishte nënshkruar nga Banca di Roma dhe Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë në zbatim të marrëveshjes së datës 26 nëntor 1992, midis Bankës së Shqipërisë, Bankës Kombëtare Tregtare dhe Banca di Roma. Kuvendi i Shqipërisë, me anën e ligjit nr. 7649, datë 16.12.1992 “Për krijimin e Bankës së Përbashkët Italo-Shqiptare”, miratoi krijimin e kësaj banke si dhe statutin e saj.

Rregullorja e parë për dhënien e licencave për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë mban datën 12 maj 1994. Ky dokument krijoi bazën rregullore dhe përcaktoi kërkesat për marrjen e licencës për të kryer veprimtari bankare. Kjo rregullore u pasua nga një rregullore tjetër më 14 qershor 1995, vendimi nr. 12 i Këshillit Mbikëqyrës, për dhënien e licencave për të vepruar si bankë private në Republikën e Shqipërisë. Kjo rregullore përcaktoi si kërkesë për kapital minimal për hapjen e një banke, 100 milionë lekë për bankë private me kapital tërësisht shqiptar dhe 200 milionë lekë për bankë private me kapital tërësisht të huaj ose me kapital shqiptar dhe të huaj.

Shuma e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për hapjen e një banke rritet në 200 milionë lekë me vendimin nr. 15, datë 28 Qershor 1996, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8075, datë 22.02.1996 “Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë”.

Por viti 1997, si pasojë e krizës politike dhe financiare që përshkoi vendin për shkak të rënies së skemave piramidale, regjistroi një nënçmim të theksuar të kursit të lekut ndaj dollarit (nga 100 lekë/usd në 170 lekë/usd). Ky nënçmim i lekut bëri që Këshilli Mbikëqyrës të vendosë rritjen e kapitalit minimal të kërkuar për hapjen e një banke nga 200 milionë në 350 milionë lekë (vendim i Këshillit Mbikëqyrës, numër 16/4/97). Kjo shumë mund të paguhej në lekë ose në kundravleftën e saj në dollarë amerikanë.

Vendimi më i rëndësishëm i kësaj periudhe për madhësinë minimale të kapitalit për bankë ka qenë vendimi numër 43 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mars 1998. Ky vendim ndryshoi kërkesën për kapital minimal në 700 milionë lekë. Qëllimi i kësaj rritje ishte përafrimi me standardet ndërkombëtare për një mbikëqyrje efektive dhe mbështetja e hyrjes në tregun bankar të partnerëve seriozë. Vendimi ishte i rëndësishëm, sepse nuk ndikonte vetëm aplikimet e reja, por edhe bankat ekzistuese, të cilat duhet të plotësonin kapitalin e tyre në shumën e re minimale të vendosur. Për këtë qëllim, bankave ekzistuese i lihej kohë tre vjet në dy faza: faza I brenda 18 muajsh në 500 milionë lekë dhe faza II - brenda 18 muajsh të plotësohej niveli prej 700 milionë lekësh. Me një vendim tjetër në nëntor 1999, afati për plotësimin e kapitalit u caktua 31 mars 2001.

Ndryshimi i fundit për kërkesën minimale të kapitalit është realizuar me vendimin numër 14, datë 11.03.2009 për miratimin e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij vendimi, personi/at që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet themelimit dhe licencimit të një banke ose banka e huaj që kërkon të ushtrojë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet një dege të saj, depoziton/depozitojnë për këtë qëllim në Bankën e Shqipërisë një kapital fillestar minimal prej jo më pak se një miliard lekë.

X. ECURIA E SEKTORIT BANKAR

Ecuria e veprimtarisë së sektorit bankar rezulton e varfër në dekadën e parë të periudhës postkomuniste. Për të argumentuar këtë përfundim, në vijim, do t'i referohemi tri momenteve kohore të kësaj periudhe, të cilat rezultojnë të kenë arritjet më pozitive si pasojë e ndryshimeve të ndodhura në vitet paraardhëse.

Momenti i parë është viti 1994. Ky vit pasqyron efektet e ndryshimeve të kryera, siç ishin krijimi i sistemit dynivelor dhe hyrja në treg e disa bankave të huaja. Gjatë këtij viti sektori bankar dha hua 7,375.3 milionë lekë dhe arkëtoi nga shlyerjet 4,992.3 milionë lekë. 74 për qind e kësaj huaje iu dha sektorit privat, i cili 69 për qind të huas e përdori si hua afatshkurtër për aktivitet tregtar, kurse pjesën tjetër si hua afatgjatë për blerje mjetesh mekanike për bujqësi, ndërtim, etj. Në sektorin shtetëror huaja afatgjatë ishte përqendruar për ndërtimin e banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, ndërsa huaja afatshkurtër më tepër u dha për industrinë e rëndë e minierat, ndërmarrjet bujqësore, etj. Huat e pakthyera në afat përfaqësonin 27 për qind të tepicës së huave të dhëna, nga të cilat vetëm 32.6 për qind i takonin sektorit privat dhe 39 për qind huas afatshkurtër. Kjo pamje duket e rënduar nga dominimi i bankave shtetërore.

Momenti i dytë është përzgjedhur viti 1998, sepse është viti pas vendosjes së rregullit nga ngjarjet e vitit 1997. Tabela 10 paraqet disa tregues për sektorin bankar. Edhe pse është rritur pjesëmarrja e kapitalit të huaj dhe numri i bankave është rritur ndjeshëm – çka flet për rikthim të besimit në zhvillimin e vendit, roli i tyre ndërmjetësues në ekonomi drejt huadhënies për individë dhe subjekte juridike është i pandjeshëm. Në krahun e pasivit mbizotëron mbledhja e depozitave, kurse në krahun e aktivitetit mbisundon investimi në bonot e thesarit. Bankat shtetërore janë dominuese.

Tabela 10: Sektori bankar në fund të vitit 1998

Bankat	Numri i degëve	Totali i depozitave ndaj pasivit %	Totali i kredive ndaj aktivitetit %	% e kredive të këqija ndaj totalit të kredive	Bono thesari në % ndaj sektorit bankar
Banka shtetërore					
Banka Kombëtare Tregtare	10	74.3	5.2	84.1	0.7
Banka e Kursimeve	33	88.4	6.3	50.7	97.6
Bankat private dhe me kapital të përbashkët					
Banka Italo Shqiptare	1	63.4	41.4	8.4	0.5
Banka Arabo-Shqiptare Islamike	1	10.9	0.0	0.0	0.0
Banka Dardania	1	12.6	2.4	16.5	0.0
Banka Tirana	2	63.3	18.0	20.3	0.5
Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë	1	81.1	0.0	0.0	0.3
Banka Ndërkombëtare Tregtare	1	48.8	31.0	0.0	0.1
Dega e Bankës Alpha Kredit	1	44.5	12.5	0.0	0.2
Banka Amerikane e Shqipërisë	1	44.5	0.0	0.0	0.0

Cilësia e portofolit të kredive ishte shumë e keqe. Bankat shtetërore ishin krejt të dështuara me huadhënien, sepse gati i gjithë portofoli i huave ishte me probleme. Pas ngjarjeve të vitit 1997, në vitin 1998 bankat shtetërore nuk u lejuan të jepnin hua. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 6, shkurt 1998, me argumentin se dy bankat shtetërore kishin filluar procesin e privatizimit, vendosi ndërprerjen e aktivitetit kredidhënës në shenjë kujdesi për t'i ruajtur ato nga përkeqësimi i mëtejshëm i portofolit të kredive dhe i situatës financiare, që çonin në uljen e vlerës së shitjes. Pak ditë më pas, po në shkurt të vitit 1998, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 10, vendosi ndërprerjen e menjëhershme të aktivitetit kreditues të Bankës Dardania për shkak të përkeqësimit të gjendjes së portofolit të huave.

Momenti i tretë është përzgjedhur viti 2000, si vit i realizimit të privatizimit të së parës bankë shtetërore. Ky privatizim e lehtëson tregun nga influenza e shtetit si aksionar dhe krijon mundësi për një rol më të rëndësishëm dhe të mirëpritur të bankave me kapital të huaj. Nga ana tjetër, sukcesi i privatizimit të BKT-së, hapi mundësi reale që shumë shpejt të privatizohej edhe Banka e Kursimeve.

Për vitin 2000 me interes është përshkrimi i bërë nga Banka e Shqipërisë për sektorin bankar në Raportin Vjetor të atij viti, si vijon:

Banka e Kursimeve sh.a. ka shtrirjen më të gjerë të rrjetit në vend me 223 zyra dhe është e pranishme në 37 rrethe si më poshtë:


<i>Degë</i>	26
<i>Agjenci</i>	87
<i>Zyra bankare</i>	110

Totali i aktiveve të Bankës së Kursimeve sh.a. zë 62.6 për qind të sistemit bankar, ndërsa në totalin e depozitave të pranuar dhe depozitat e individëve zë përkatësisht 69.3 dhe 62.8 për qind të totalit të sistemit bankar. Banka e Kursimeve zotëron rreth 84.2 për qind të depozitave në lekë dhe rreth 43.4 për qind të stokut të kredisë gjithsej. Pozicioni dominues i kësaj banke vihet re edhe te bonot e thesarit me 84.2 për qind të totalit për sistemin bankar. Totali i aktivitetit të Bankës së Kursimeve për njëqind mijë banorë, për muajin dhjetor 2000, ishte 5.18 miliardë lekë. Për sa i përket vëllimit të pagesave, pozicioni i Bankës së Kursimeve paraqitet, gjithashtu, dominues me 39 për qind të aktivitetit të kleringut, 38 për qind në urdhërpagesat dhe 39 për qind të totalit të sistemit për çeqet bankare.¹

¹ Banka e Shqipërisë: Raporti Vjetor 2000, Kapitulli 3: Mbikëqyrja bankare, faqe II

Kjo situatë vazhdoi pak a shumë të mbetej njësoj deri në vitin 2004. Me privatizimin e bankës më të madhe në vend, tregu bankar ndryshoi. Mbështetur nga qëndrueshmëria ekonomike, nga reformat strukturore në ekonomi, nga mësimet e nxjerra nga ngjarjet e vitit 1997, nga mbajtja e inflacionit në kontroll dhe nga qëndrueshmëria e kursit të këmbimit, Shqipëria ishte në prag të viteve më të mira të zhvillimit që pas vitit 1990. Bankat, jo vetëm ju bashkëngjitën kësaj atmosfere optimiste dhe tërheqëse për biznes, por u bënë edhe promotorë të produkteve dhe shërbimeve të reja. Pas vitit 2004 fillon huaja për individët, për blerje shtëpie dhe për konsum, fillojnë shërbimet elektronike – kartat elektronike dhe bankingu elektronik, përmirësim i shërbimeve bankare me ulje kosto dhe me shpejtësi më të lartë, pjesëmarrje e bankave në zhvillimin e tregut financiar.

Grafiku I: Ecuria e portofolit të huasë në sektorin bankar



Kështu, huadhënia e bankave në vitin 2005 u rrit me 82 për qind në krahasim me vitin 2004 (ose me 57.6 miliardë lekë). Në vitin 2006, kundrejt vitit 2005, teprica e kredisë u rrit me 55 për qind. Në vitin 2007, kundrejt vitit 2006, u rrit me 50 për qind. Pas vitit 2007 fillon rënia e rritjes. Fillimisht me 37 për qind në vitin 2008 dhe me gati 10 për qind në vitet pasuese. Grafiku 1 pasqyron ecurinë e portofolit të kredisë së sektorit bankar.

Kontributin e rëndësishëm që kanë dhënë bankat në ekonomi e tregun edhe treguesi i raportit të huas me prodhimin e brendshëm bruto (PBB). Kështu, nëse ky tregues për vitin 2004 ishte 9.3%, në vitin 2007 arriti në 29.7% dhe në fund të vitit 2011 në 41.5%.

Duhet nënvizuar fakti se gjatë gjithë kohës bankat në Shqipëri nuk kanë vuajtur nga mungesa e likuiditetit. Burimet e brendshme kanë qenë të mjaftueshme për

të mbështetur financimin e ekonomisë, me përjashtim të projekteve të mëdha qeveritare në monedhë të huaj për të cilat është marrë hua në tregjet e huaja. Në fund të vitit 2005, fondet e huaja përbënin vetëm 2 për qind të totalit të detyrimeve gjithsej, ndërsa në fund të dhjetorit 2008 kjo peshë u rrit në 8.6 për qind. Depozitat janë rritur nga 45% ndaj PBB në vitin 2003 në 67% në vitin 2011. Edhe pse sektori bankar është ndeshur me kërcënimin e krizës financiare globale, rënia e përkohshme e depozitave është shoqëruar pas disa muajve me ri-prurje më të mëdha.

Përpjekjeve për të rritur huadhënien me ritme të larta, iu shtua edhe zgjerimi i rrjetit të degëve dhe agjencive bankare. Ndërsa viti 2004 ishte viti kur bankat filluan zgjerimin e shpejtë të rrjetit të tyre me 30 degë dhe agjenci, viti 2005 shënon një përsheptim të ritmit të rritjes së këtij rrjeti. Kështu, gjatë vitit 2005, janë hapur 48 degë dhe agjenci të reja. Pjesa më e madhe e tyre (23) janë hapur në Tiranë, por një pjesë e konsiderueshme është hapur në qytetet e vogla të vendit, të cilat nuk ishin të mbuluara mirë me shërbime bankare. Në vitin 2008 u miratuan dhe filluan veprimtarinë 113 degë dhe agjenci duke e çuar numrin e përgjithshëm të degëve dhe agjencive në 517 nga 404 që ishin në vitin 2007. Rritja e degëve vazhdon edhe në vitin 2009 (17 degë dhe agjenci të reja), por për herë të parë fillon edhe mbyllja e degëve dhe njësive që nuk e justifikojnë veten (në vitin 2009 mbyllin aktivitetin 4 degë). Megjithatë, numri i degëve dhe agjencive mbetet sërish i lartë: në fund të vitit 2009 ky numër ishte 530.

Viti 2009 karakterizohet edhe nga një arritje tjetër. Në këtë vit u miratuan tetë raste të reja të ofrimit të produkteve *e-banking*, të cilat konsistojnë në ofrimin e *internet banking*, kartave elektronike, ATM-ve dhe POS-ve. Mund të thuhet se sektori bankar e fitoi edhe këtë garë me kohën për të kompletuar gamën e shërbimeve dhe produkteve bankare.

Por pavarësisht arritjeve ekstensive, zgjerimit të degëve, rritjes së depozitave dhe ofrimit të produkteve elektronike, sektori bankar filloi të ndjejë pasojat e rritjes së shpejtë të portofolit të huas dhe efektet shtrënguese të krizës financiare globale. Ecuria e sektorit bankar për vitin 2009, në këndvështrimin e rezultatit neto, ka qenë dukshëm më e dobët sesa gjatë vitit 2008. Edhe vetë viti 2008 ka qenë vit që ndryshoi drejtimin e rezultatit. Për herë të parë, në vitin 2008 kapitali aksionar rezultoi 2.6 miliardë lekë më pak se viti paraardhës. Rezultati neto i realizuar gjatë vitit 2009 ka qenë rreth 52% më i vogël se viti paraardhës, ku shpenzimet për provigjione nga kreditë kanë qenë përcaktuese. U evidentua një rritje e shpejtë e treguesit të cilësisë së portofolit të kredive “kredi me probleme ndaj tepricës gjithsej të kredive” nga niveli 6.64% në fundvitin 2008, në 10.48% në dhjetor 2009. Ky tregues ka ardhur në rritje deri në 18.8 për qind në fundvitin 2011, çka e ka bërë sektorin bankar më rigoroz ndaj huadhënies dhe më të kujdesshëm në trajtimin e portofolit ekzistues.

Dukuri pozitive e viteve pas krizës financiar globale është se aksionarët nuk kanë tërhequr fitimin e vitit ushtrimor, por të kujdesshëm dhe parashikues në mundësinë e rritjes së huave të pakthyera, ata e kanë riinvestuar atë, madje në disa banka është

injektuar kapital i ri nga aksionarët, në mënyrë që të mos cenohet qëndrueshmëria dhe treguesit e rëndësishëm të mjaftueshmërisë së kapitalit për vazhdimin normal të aktivitetit. Kështu, kapitali aksionar në banka nga 26 miliardë lekë në vitin 2004 është rritur në mbi 97 miliardë lekë në vitin 2011. Kjo ka bërë të mundur që treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të mbetet (15.6 për qind në vitin 2011) mbi minimumin prej 12 për qind të kërkuar nga autoriteti mbikëqyrës.

Një paraqitje e sektorit bankar në fund të vitit 2011 është dhënë në Tabelën 11.

Tabela II: Sektori bankar, dhjetor 2011

Banka	Origjina	Aktivi ndaj Aktiveve Gjithsej, %	Huat ndaj Aktivit, %	Depozitat ndaj Pasivit, %	Kapitali i vet	Fitimi neto	Numri i degëve	Numri i punonjësve
Banka Alpha -Dega Shqipëri	Greqi	6.5%	52.2%	82.9%	68,708	(4,226)	45	386
Banka Kombëtare Tregtare	Turqi	17.6%	41.7%	84.8%	106,947	20,641	80	1,059
Banka Credins	Shqipëri	7.4%	69.6%	84.7%	54,919	11,921	44	589
Banka e Kreditit	Kuvajt	0.2%	15.5%	20.7%	8,911	(170)	2	31
Banka Emporiki	Greqi	2.9%	73.3%	39.6%	29,338	(5,935)	22	254
Banka e Parë e Investimeve	Bullgari	0.8%	44.4%	82.5%	8,392	(530)	9	112
Banka Ndërkombëtare	Malajzia	0.8%	27.2%	70.6%	10,319	215	8	85
Banka Intesa Sanpaolo	Itali	11.9%	38.1%	79.2%	104,794	17,759	31	543
Banka NBG – Dega Shqipëri	Greqi	3.4%	73.8%	79.5%	51,752	1,305	27	265
Banka ProCredit	Gjermani	3.5%	59.8%	80.2%	31,409	2,004	40	640
Banka Raiffeisen	Austri	28.2%	41.8%	86.7%	210,140	50,538	103	1,471
Banka Societe Generale	Francë	5.0%	53.1%	83.0%	43,871	2,421	42	371
Banka Tirana	Greqi	8.2%	62.5%	74.4%	120,679	5,505	56	469
Banka Union	Shqipëri	2.1%	49.7%	83.5%	15,624	883	29	276
Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Arabia Saudite	0.5%	29.0%	75.3%	10,840	261	6	75
Banka Veneto	Itali	1.2%	71.7%	60.6%	21,851	333	9	88
Gjithsej		100.0%			898,494	102,925	553	6,714

Shënim: Të dhënat për Kapitalin dhe Fitimin janë në mijë Euro.

Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave, Raporti Vjetor 2011.

Përgatiti: Dr. Spiro Brumbulli

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), e krijuar fillimisht si Klubi i Bankierëve Shqiptarë (mars 1999), është sot zëri i bashkuar i industrisë bankare me 16 banka tregtare, me asete me vlerë rreth 8.5 miliardë Euro, dhe rreth 6800 punonjës.

Nëpërmjet kombinimit të përvojave, ekspertizës dhe burimeve të çmuara njerëzore të anëtarëve të saj, dhe bashkëpunimit me organizata dhe institucione kombëtare e ndërkombëtare, AAB punon për vlerësimin dhe përmirësimin e shërbimeve bankare dhe financiare të bankave anëtare, rritjen e potencialit të burimeve njerëzore të sistemit, dhe për një sistem bankar më të suksesshëm në Shqipëri.

HISTORIK

Në 31 Mars 1999, në një mbledhje miqësore, Drejtorët Ekzekutivë të nëntë bankave vendosën të krijonin në Tiranë Klubin e Bankierëve Shqiptarë. Themeluesit miratuan organigramën e Klubit, zgjodhën strukturat administrative dhe kryetarin e saj, dhe që prej atij momenti sistemi bankar shqiptar u përfaqësua nga ky bashkim.

Dy vjet më pas, në mars 2001, me anëtarësimin e mëvonshëm në Klub të katër bankave të tjera, struktura administruese e Klubit të Bankierëve Shqiptarë vendosi të nryshojë emërtimin në Shoqata Shqiptare e Bankave – Albanian Association of Banks (AAB), duke hartuar edhe statutin e ri i cili përcaktonte që AAB do të përfaqësohej nga Kryetari i saj dhe Komiteti Ekzekutiv.

Thelbi i veprimtarisë dhe aktivitetit të AAB-së ka qenë arritja e misionit të saj në mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të Anëtareve, rritjen e rolit të bankave tregtare në ekonominë shqiptare, promovimin e sektorit bankar shqiptar në mjedisin ndërkombëtar bankar, dhe promovimin e konkurrencës së plotë dhe të bashkëpunimit midis anëtareve të saj.

Nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të anëtarëve të saj, Shoqata Shqiptare e Bankave ka punuar për vlerësimin dhe prosperitetin e shërbimeve financiare si dhe rritjen e potencialit të burimeve njerëzore në tregun bankar. Për komunikimin e pikëpamjeve dhe ideve të anëtarëve të saj, Shoqata ka ndërvepruar vazhdimisht me Bankën e Shqipërisë, autoritetet e shërbimeve financiare, Qeverinë dhe institucionet Evropiane e Ndërkombëtare.

Me kalimin e viteve, baza ligjore dhe organizative, ku mbështetet veprimtaria e Shoqatës, janë përmirësuar ndjeshëm. Statuti është rishikuar dhe përmirësuar disa herë, me versionin më të fundit të aprovuar në vitin 2011, me ndryshime dhe shtesa të konsiderueshme në vite: për funksionim më të mirë të Asamblesë, krijimin e Sekretariatit dhe përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrave të tij, shtimin në gjashtë persona të numrit të anëtareve të Bordit Drejtues, dhe rritjen e kontributit të bankave anëtare për burimet financiare që mbështesin aktivitetet gjithnjë e në rritje të Shoqatës.

Gjatë viteve, Shoqata ka ndërtuar një nivel të kënaqshëm transparence duke u shndërruar në një institucion të hapur për çdo palë të interesuar e duke përdorur metoda të ndryshme për të arritur transparencën, nga ato më klasiket, si publikimet, tek ato më modernet, si informacioni i përditësuar në internet, e së fundmi me një botim periodik, serioz e profesional, Revistën BANKIERI.

DATA TË RËNDËSISHME

- 31 mars 1999** – 9 Bankat: Banka Amerikane e Shqipërisë; Banka Arabo – Islamike; Dardania Bank; Fefad Bank; Banka Ndërkombëtare Tregtare; Banka Italo Shqiptare; Banka Kombëtare Tregtare; Banka e Kursimeve; dhe Banka e Tiranës, mblidhen dhe vendosin krijimin e Klubit Shqiptar të Bankierëve. Bordi i parë Drejtues do të ketë Kryetar Z. Giancarlo Rizzola Drejtor i Përgjithshëm i bankës Italo Shqiptare dhe Zëvendës Kryetar Z. Lorenzo Roncari, President dhe Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Amerikane të Shqipërisë.
- 27 mars 2001** – Katër banka të tjera: Alpha Bank; Banka Kombëtare e Greqisë; Banka Ndërtregtare; dhe Banka e Parë e Investimeve - Dega Shqipëri, u shtohen bankave krijuese të Klubit Shqiptar të Bankierëve, dhe te gjitha së bashku vendosin për transformimin e këtij të fundit në Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB). Ndryshohet statuti, zgjidhen anëtarë të rinj të Bordit Drejtues i cili në vijim do të ketë Kryetar Z. Ardian Fullani, Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Italo-Shqiptare dhe Zv. Kryetar Z. Dimitris Karavias, Drejtor i Përgjithshëm i Tirana Bank.
- 12 dhjetor 2002** – Krijohen Komitetet e para teknike me anëtarë përfaqësues të bankave anëtare të AAB-së në strukturën e saj: Komiteti Operacional, Komiteti Financiar dhe Ligjor.
- 26 mars 2003** - Anëtarët e Shoqatës ndërmarrin disa ndryshime të rëndësishme në statutin e Shoqatës, ndër të cilat mundësia e rizgjedhjes së anëtarëve të Bordit Drejtues me një mandat dy vjeçar, si dhe përcaktimi i Sekretariatit të AAB-së si një strukturë më vete.
- 23 prill 2003** - Në bazë të kërkesës së saj dhe plotësimit të kushteve, Shoqata Shqiptare e Bankave pranohet si “Anëtare e Asociuar” e Federatës Bankare Evropiane në Bruksel, Belgjikë. Ky anëtarësim u arrit edhe në sajë të bashkëpunimit me Shoqatat e bankave të vendeve fqinje të Italisë, Greqisë, Bullgarisë dhe Kroacisë, dhe shënon përpjekjen më të rëndësishme në bashkëpunimin me organizatat bankare ndërkombëtare dhe integrimin në strukturat e industrisë bankare evropiane.
- Janar 2004** - AAB së bashku me 6 Shoqata Bankare të rajonit firmosin një Memorandum Mirëkuptimi dhe themelojnë një forum me qëllim të ndihmojnë biznesin bankar në rajonin e Ballkanit, që do të quhet Forumi Ndërbalkanik i Shoqatave Bankare.
- Mars 2005** – Ndryshohet Statuti dhe struktura e Shoqatës me emërimin për herë të parë të Sekretarit të Përgjithshëm (Z. Elvin Meka), duke shënuar një hap të mëtejshëm cilësor në funksionimin e Sekretariatit të AAB, sipas modelit

ndërkombëtar të shoqatave të bankave. Që prej Janarit 2005 Bordi drejtues kryesohet nga Kryetar Z. Seyhan Pencabligil dhe Zv. Kryetar Z. Steven Grunerund.

Maj 2007 – Sekretariati i Shoqatës vendoset në zyrat e reja, ku është aktualisht, në Bulevardin Dëshmorët e Kombit, me kapacitete për takime e trajnime, dhe me një strukturë të plotësuar tashmë me tre anëtarë. Kryesia e re e Bordit Drejtues të AAB përbëhet nga Z. Edvin Libohova Kryetar, dhe Z. Steven Grunerund Zv/ Kryetar.

15 maj 2008 - Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Programin “Convergence” të Bankës Botërore, AAB mbështet krijimin e “SPI Albania (Iniciativa për Projekte Speciale), si një nismë e bashkëpunimit publik-privat, me objektiv modernizimin e sistemit financiar shqiptar, nëpërmjet zhvillimit të një kulture dialogu dhe ndërtimit të konsensusit.

26 janar 2009 – Asambleja e Anëtarëve zgjedh anëtarë dhe Kryesi të re të Bordit Drejtues me Kryetar Z. Libero Catalano dhe Zv. Kryetar Z. Oliver Whittle. Z. Catalano do të zëvendësohet në këtë post nga Z. Gazmend Kadriu, i cili do të jetë Kryetar i AAB-së nga 10 Maj 2010 – 26 Janar 2011.


Maj 2011 – Asambleja e Anëtarëve miraton edhe një herë ndryshime thelbësore në Statutin e AAB-së, që shtojnë njëkohësisht burimet financiare në dispozicion të aktiviteteve të saj dhe rrisin përfaqësimin e bankave në Bordin Drejtues. Anëtarët e bordit drejtues bëhen 6, dhe kuotat e anëtarësisë do të paguhen në proporcion me peshën e asetëve të secilës bankë në asetet totale të sistemit. Që prej janarit 2011 Kryetar i Bordit Drejtues është Z. Seyhan Pencabligil, dhe Zv. Kryetar Z. Ioannis Kougionas.

Gusht 2011 - AAB, me miratim të Bordit të saj Drejtues, u bë anëtare në BACEE - Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore e Lindore.

Tetor 2011 – Shoqata Shqiptare e Bankave boton numrin e parë të revistës “Bankieri”, publikim profesional i Shoqatës. Revista është një publikim periodik dygjuhësh, me frekuencë tremujore.

15 mars 2012 - Bordi Drejtues i AAB-së miratoi propozimin e Sekretariatit të AAB-së për krijimin e një Komiteti të ri të përhershëm teknik, atë të Auditorëve të Brendshëm të Bankave i cili bëhet kështu komiteti i tetë teknik i krijuar nën ombrellën e Sekretariatit.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AAB-SË, 31 TETOR 2012



BORDI DREJTUES I AAB-SË

Z. Seyhan PENCABLIGIL - KRYETAR

Drejtor i Përgjithshëm, BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Z. Ioannis KOUGIONAS - ZËVENDËS KRYETAR

Drejtor i Përgjithshëm, NATIONAL BANK OF GREECE ALBANIA

Z. Christian CANACARIS - ANËTAR

Drejtor i Përgjithshëm, RAIFFEISEN BANK

Z. Periklis DROUGKAS - ANËTAR

Drejtor i Përgjithshëm, ALPHA BANK ALBANIA

Z. Bozhidar TODOROV - ANËTAR

Drejtor i Përgjithshëm, FIRST INVESTMENT BANK

Zj. Flutura VEIPI - ANËTARE

Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive, PROCREDIT BANK

SEKRETARIATI I AAB-SË

Zj. Endrita XHAFERAJ – SEKRETARE E PËRGJITHSHME

Zj. Brunilda KOSTARE – KËSHILLTARE LIGJORE

Zj. Junida KATROSHI – SPECIALISTE E OPERACIONEVE

Zj. EFTALI PEÇI -SPECIALISTE KOMUNIKIMI

Zj. Marsela BULKU – ASISTENTE ADMINISTRATIVE

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE NË VITE



1. Broshura të AAB, 2004.

2. Festa e përcjelljes të z. Lorenzo Roncari, Drejtor i Përgjithshëm i ABA, janar 2009.

3. Kryetarët e AAB-së në vite gjatë festës së 10 vjetorit të AAB, dhjetor 2010.

4. Trajnim PCI & DSS, nëntor 2011.

5. Pjesëmarrësit në trajnimin "Praktikat më të mira në drejtim", shtator 2012.

6. Festa e përcjelljes të z. George Caracostas, Drejtor i Përgjithshëm Emporiki Bank, maj 2010.

7. Staf i Sekretariatit të AAB-së.

8. Forumi i dytë Kombëtar i Luftës Kundër Mashtrimit me Karta, maj 2012.

9. Pamje e buletinit të parë, mars 2008.

10. Kopertina e numrit të parë të Revistës Bankieri.

11. Faqja zyrtare e internetit para (2005) dhe pas rimodelimit (2012).

12. Mbledhje e Asamblesë së Anëtarëve, shtator 2012



BANKAT ANËTARE (sipas rendit alfabetik)

I.	Alpha Bank Albania.....	114
II.	Banka e Bashkuar e Shqipërisë.....	116
III.	Banka NBG Albania.....	118
IV.	Banka Kombëtare Tregtare.....	120
V.	Banka e Kreditit të Shqipërisë	122
VI.	Banka Ndërkombëtare Tregtare.....	123
VII.	Banka e Parë e Investimeve	124
VIII.	Credins Bank.....	125
IX.	Crédit Agricole.....	127
X.	Intesa Sanpaolo Bank Albania	128
XI.	Procredit Bank	132
XII.	Raiffeisen Bank	134
XIII.	Société Générale	136
XIV.	Tirana Bank	138
XV.	Union bank.....	140
XVI.	Veneto Banka	142

ALPHA BANK ALBANIA

Alpha Bank Albania filloi të operojë në Shqipëri si degë e Alpha Bank A.E., një prej bankave më të mëdha në Greqi, e themeluar në vitin 1879 dhe me një prezencë të rëndësishme në Evropën Juglindore, në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Qipro.

Alpha Bank ka financuar projektet më të mëdha infrastrukturore në Shqipëri si: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, Industria e Telekomunikacionit etj., si dhe ka qenë banka e parë në Shqipëri që ka realizuar dhënien e kredisë më të madhe ndaj Shtetit Shqiptar. Ajo hodhi e para në tregun shqiptar një kartë krediti nën dy emra tregtarë së bashku, atë të Alpha Bank dhe Vodafone (Karta Vodafone American Express nga Alpha Bank).



Data Historike:

- 1998** - Alpha Bank filloi të operojë në Shqipëri si degë e një banke të huaj nën emrin “ALPHA CREDIT BANK – DEGA TIRANË” me kapital të paguar USD 2.5 milion me emrin tregtar “ALPHA BANK”. Në këtë vit u disbursua kredia e parë për biznes.
- 1999** - Filloi të operojë Dealing Room-i, u disbursua kredia e parë për shtëpi dhe kredia e parë për makinë.
- 2000** - Emri i Degës së Tiranës u ndryshua në “Alpha Bank A.E. – Dega Tiranë” duke ndjekur ndryshimin e emrit të Bankës në Greqi. Alpha Bank A.E.-Dega Tiranë filloi zgjerimin e saj me dy degë të tjera jashtë qytetit të Tiranës, dhe kapitali i paguar u rrit në mënyrë të konsiderueshme për të mbështetur rritjen e aktiveve.



Transaksioni i parë i kryer nga Z. Yannis S. Costopoulos, Presidenti i Grupit në ditën e inaugurimit të Alpha Bank



Eventi i organizuar për marrjen e licencës si lëshues ekskluziv i kartave American Express® në Shqipëri.

- 2001** - Komisioni i Letrave me Vlerë i dha bankës licencën për të operuar si tregtar i bonove të thesarit në Bursën e Tiranës.
- 2003** - U instalua ATM-ja e parë dhe u hodh në treg karta e parë e debitit në monedhën vendase. Në këtë vit u nënshkrua edhe marrëveshja me Bursën e Tiranës mbi pastrimin e transaksioneve që kryhen në Bursën e Tiranës.
- 2007** - Emri i Degës së Tiranës u ndryshua në “ALPHA BANK – ALBANIA”. Këtë vit u hapën 6 degë të reja, si edhe dega e parë në Veri të vendit, u lëshua karta e kreditimit VISA CREDIT, si dhe u hodh në treg kredia e parë për individë.
- 2008** - Banka festoi 10 vjetorin e prezencës së saj në Shqipëri, rrjeti i degëve u zgjerua me 22 degë të reja, u akordua financimi më i madh për punime publike për projektin rruga Durrës – Kukës – Morinë. Po këtë vit Alpha Bank mori licencën si lëshuesi ekskluziv i kartave American Express, dhe Web banking filloi të operojë si një kanal alternativ.
- 2009** - Kapitali i paguar u rrit ndjeshëm për shkak të kapitalizimit të fitimeve gjatë viteve 2005 – 2009 dhe Banka tashmë është prezent në të gjithë vendin duke shtuar në rrjetin e saj edhe 6 degë të reja.
- 2012** - Alpha Bank u transformua nga degë e një banke të huaj në filialin e një banke të huaj, me emrin ALPHA BANK ALBANIA duke ruajtur emrin tregtar ALPHA BANK.

Drejtues të Bankës në vite:

Andreas BARTZIS	1998 - 2002
Andreas GALATOULAS	2002 – shkurt 2012
Periklis DROUGKAS	shkurt 2012 e në vazhdim

BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH) operon në tregun shqiptar që në vitin 1993. Ndër vite ajo është zhvilluar drejt një banke që synon të ofrojë shërbime superiore dhe inovative që plotësojnë pritshmërinë e klientëve; të ofrojë shërbime bankare islamike pa interes; dhe të ruajë përfitueshmëri të qëndrueshme e afatgjatë, rritje të aktiveve dhe depozitave, dhe stabilitet financiar.



Data Historike:

maj 1993 - Banka Arabe Shqiptaro Islamike merr aprovimin nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e aktivitetit si një joint-venture ndërmjet Shtetit Shqiptar, i përfaqësuar nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT), me 40% të kapitalit të Bankës dhe një grup investitorësh të huaj me 60% të kapitalit.

korrik 1994 – Inaugurohet fillimi i aktivitetit operacional të Bankës.

2000 – Pas privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, aksionet e zotëruara nga Shteti Shqiptar transferohen nga BKT tek Ministria e Financave (Drejtoria e Thesarit) e cila merr në zotërim 40% të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

2003 - Banka ndryshon emrin nga Banka Arabe Shqiptare Islamike në Banka e Bashkuar e Shqipërisë. Po në të njëjtin vit fillon aktivitetin dega e re e Bankës në qytetin e Fierit.

2006 – Fillon aktivitetin një degë e re në qytetin e Tiranës.

2007 - Hapet dega e re e Bankës në qytetin e Durrësit

2008 - Përfundojnë punimet dhe inaugurohen ambientet e reja të bankës (tashmë në pronësi të saj) që do të shërbejnë si zyrat e Drejtorisë Qendrore si dhe ku do të zhvillojë aktivitetin e saj një degë tjetër, Dega Qendrore – Tiranë.

30 mars 2009 – Nënshkruhet Kontrata për Shitblerjen e Aksioneve ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës Islamike për Zhvillim. Banka Islamike për Zhvillim zotëron tashmë 55% të aksioneve të Bankës. Në fund të këtij viti përfundon procesi i shitjes së aksioneve dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë tashmë bëhet një Shoqëri Tregtare me kapital tërësisht të huaj.

2012 - Realizohet rritja e kapitalit të Bankës me mjete likuide duke rritur garancinë për një aktivitet të qëndrueshëm dhe mundësinë për shtimin e produkteve bankare. Pas këtij ndryshimi në strukturën e kapitalit të bankës, aksioneri kryesor i Bankës, Banka Islamike për Zhvillim bëhet mbajtësi i 86% të aksioneve të Bankës.

Drejtues të Bankës në vite:

El Garib NASSER

korrik1994 – prill 1995

Ali SALEM

maj1995 – maj1997

Ahmed O. El ANTABLY

qershor 1997 – gusht 1999

Abdul Waheed ALAVI

shtator 1999 – maj 2009

Hikmet GÜLER

qershor 2009 e në vazhdim

BANKA NBG ALBANIA

Banka NBG Albania Sh.A. është pjesë e Grupit NBG, grupi më i madh financiar në Evropën Jug-Lindore. NBG filloi aktivitetin e saj në Greqi si një bankë tregtare në vitin 1841 dhe përgjatë këtyre viteve është shndërruar në një grup financiar modern e të diversifikuar.

NBG Bank në Shqipëri filloi veprimtarinë e saj në vitin 1996. Gjatë këtyre 16 vjetëve ju shërben klientëve të saj në të gjithë vendin me një rrjet të zgjeruar në 27 degë të shtrira në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë. NBG Bank ka ofruar vazhdimisht mbështetje për projekte të ndryshme me ndjeshmëri të lartë sociale. Janë të shumta projektet sociale të sponsorizuara nga NBG Bank në arsim, mjedis, shëndetësi dhe sport, duke treguar përgjegjësi të lartë sociale dhe vlerësim për komunitetin ku ushtron aktivitetin e saj.



Data Historike:

25 nëntor 1996 – Themelohet Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë në Shqipëri (NBG Bank) me seli në Tiranë.

1998 – 2002 – Banka NBG në Shqipëri zgjeron rrjetin e saj në Tiranë dhe hap degë të reja në Durrës dhe Korçë. Gjatë kësaj periudhe, por edhe më vonë, NBG Bank në Shqipëri ka dhënë ndihmesë të konsiderueshme për kanalizimin e remitancave të emigrantëve nga Greqia në Shqipëri dhe ka prezantuar produktet e para të kredisë për individë.

2003 – NBG Bank filloi financimin në masë të blerjeve të apartamenteve të reja. Hedhja në treg e produkteve novatore dhe politikat agresive të bankës gjatë kësaj periudhë ndihmuan rritjen dhe përmirësimin e tregut vendas të kredive individuale.

2004 – Banka hedh në treg produkte të reja për individë si kredia konsumatore dhe kredia për makinë. NBG Bank në Shqipëri është e para bankë që ofroi produktin e kredisë konsumatore

pa kolateral. Kredia për individë u rrit me 175%. U hap dega në Vlorë dhe rrjeti në Tiranë u zgjerua me degë e re në zonën e ish-blokut.

2006 – NBG Bank shton praninë e saj në Tiranë me 4 degë të tjera dhe zgjeron rrjetin edhe në Elbasan dhe në autostradën Tiranë-Durrës.

2007 – Numri i punonjësve në rrjet u dyfishua. NBG Bank në Shqipëri është e pranishme edhe në Shkodër, Lezhë, Sarandë, Pogradec, Lushnjë, Berat, Gjirokastrë, Fushë Krujë dhe dy degë të reja në Tiranë. Kreditë për individë dhe biznese u dyfishuan përgjatë vitit.

2008 – Degë të reja u hapën në Fier, Kukës, Kavajë, Bilisht dhe në Tiranë.

2009 – 2011 - Depozitat rriten ndjeshëm dhe fokusi vendoset në cilësinë e portofolit të kredive. Rritja e depozitave përmirëson raportin kredi/depozita dhe likuiditetin e bankës.

28 maj 2012 - Dega e NBG Bank në Shqipëri fiton statusin e filialit të NBG Group dhe ndryshon emrin në Banka NBG Albania Sh.A..

Drejtues të bankës në vite:

Alexandros KATSIOURIS	1996 - 1998
Fotis KYTINOS	1998 - 1999
Athanasios ALVAS	1999 - 2001
Constantinos PAPACHRISTOFOROU	2001 - 2002
Vasilios FILIS	2002 - 2003
Spiro BRUMBULLI	2003 - 2008
Ioannis LIVADITIS	2008 - 2009
Ioannis KOUGIONAS	2009 – në vazhdim

BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Dega e parë e Bankës Kombëtare Tregtare u themelua në Durrës më datë 29 nëntor 1925, në mesin historike ku sot ndodhet Dega e BKT në Durrës. Godina në të cilën ndodhet kjo degë e BKT-së përfaqëson aktualisht institucionin financiar shqiptar më të vjetër në vend. Më 1 nëntor 1926 dhe 15 nëntor 1926 u hapën respektivisht degët e Shkodrës dhe të Vlorës.

Banka Kombëtare Tregtare me emërtimin e që ka sot u themelua në janar 1993, nga bashkimi i Bankës Tregtare Shqiptare (BTSH) dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH).



Data Historike:

korrik 1997 - Banka Kombëtare Tregtare krijohet si Shoqëri Aksionere me një kapital prej 2.7 miliardë Lekësh.

6 korrik 2000 - Parlamenti shqiptar aprovon kontratën e shitjes ndërmjet Ministrisë së Financave nga njëra anë dhe Konsorciumit të Investitorëve Ndërkombëtare (60% e aksioneve), Korporata Ndërkombëtare Financiare (20%) dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (20%) nga ana tjetër. Kalimi i pronësisë u bë efektiv me 17 tetor 2000. Aksionerët e rinj derdhën 10 milionë dollarë, duke rezultuar në një kapitalizim të fuqishëm të bankës.

shkurt 2003 - Me një vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionerëve, kapitali i paguar i bankës arriti në shumën 14.64 milionë dollarë, duke e kthyer BKT-në në bankën më të kapitalizuar të sistemit bankar shqiptar.



Inagurimi i Degës së BKT Kosovë, Nëntor 2007.

9 qershor 2006 – Pas marrjes së aprovimit nga Banka e Shqipërisë dhe vendimit të posaçëm gjyqësor, miratohet transferimi i aksioneve që konsiston në kalimin e 60% + 2 të aksioneve të BKT në favor të Çalik-Seker Konsorsium Yatirim A.S.

nëntor 2007 - BKT hap degën e saj të parë në Prishtinë, duke hedhur kështu hapat e parë të zgjerimit në rajon.

30 qershor 2009 – Çalik Financial Services blen pjesën e aksioneve të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim duke u bërë në këtë mënyrë aksioneri i vetëm i BKT-së me 100% të aksioneve. Po në këtë vit BKT vlerësohet si banka më e mirë e vitit në Shqipëri dhe njëkohësisht si “Banka më e mirë e vitit në Europën Juglindore” nga Finance Central Europe.

nëntor 2010 - BKT feston 10-vjetorin e privatizimit dhe njëkohësisht 85-vjetorin e hapjes së degës së saj të parë në Durrës. Për vitin 2010 BKT merr 2 vlerësime nga prestigjiozet “The Banker” dhe EMEA Finance, të cilat e rendisin BKT-në si bankën më të mirë në Shqipëri.

2011 – BKT vazhdon zgjerimin e rrjetit të saj duke arritur në 81 degë, nga të cilat 58 në Shqipëri dhe 23 në Kosovë. Njëkohësisht BKT sërish vlerësohet nga “The Banker” dhe EMEA Finance si banka më e mirë e vitit në Shqipëri.

2012 - Rritja e vazhdueshme dhe e sigurt në të gjithë treguesit e bankës vazhdon: në këtë vit agjencia ndërkombëtare e vlerësimit JCR Eurasia Rating i jep BKT-së notën AAA (Alb) për të tretin vit rradhazi, ndërkohë që revista britanike Euromoney rendit BKT-në si banka më e mirë e vitit në Shqipëri.

Drejtues të bankës në vite:

Ardian XHYHERI

janar 1993 – dhjetor 1993

Everest MUSTA

dhjetor 1993 – shkurt 1995

Eduard YPI

shkurt 1995 – mars 1997

Spiro BRUMBULLI

maj 1997 – tetor 2000

Seyhan PENCABLIGIL

tetor 2000 – në vazhdim

BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË

Banka e Kreditit të Shqipërisë sh.a është një kompani aksionere shqiptare. Aksionerët e saj, vëllezërit Al-Kharafi (Kharafi Group) përfaqësojnë një grup Kuvajtian me pjesëmarrje dhe aktivitete të ndryshme në të gjithë botën. I themeluar si një kompani tregtare më shumë se 100 vjet më parë, ky grup u zhvillua në një kompani shumëkombëshe dhe ka qenë aktiv në Shqipëri që në vitin 1992, duke krijuar këtu kompani të mëdha, në fushat e investimeve, kontraktimeve, pjesëmarrjes në tenderë infrastrukture, rrugësh, spitalesh, urash, aeroportesh e projektsh të mëdha në Inxhinierinë Civile



Data Historike:

28 korrik 2002 – Banka e Kreditit të Shqipërisë merr licencën nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e aktiviteteve bankare në Shqipëri.

01 mars 2003 – Banka fillon aktivitetin e saj operacional në tregun bankar.

2012 – Banka operon me zyrat qendrore në Tiranë dhe dy degët e saj, në Tiranë dhe Sarandë, me një staf prej 31 punonjësish.

Drejtues të bankës në vite:

Kamal Abdel MONEIM

mars 2003 – nëntor 2009

Sherine KAMEL

dhjetor 2009 – në vazhdim

BANKA NDERKOMBETARE TREGTARE

Banka Ndërkombëtare Tregtare është një nga bankat private në Shqipëri, e cila e filloi veprimtarinë e saj në vitin 1997. Sot Banka operon si pjesë e Grupit Bankar ICB. ICB Financial Group Holdings AG është një grup që kontrollon banka të ndryshme që operojnë në Afrikë, Azi dhe Evropë.



Data Historike:

janar 1996 – Themelohet shoqëria aksionere Banka Ndërkombëtare Tregtare SH.A., e vendosur në Tiranë

20 shkurt 1997 – Banka merr licencën nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e aktiviteteve bankare në Shqipëri.

2012 – Banka ka një rrjet on-line të 8 degëve të shpërndarë në 8 vendndodhje gjeografike, në 4 rajone të ndryshme, e cila siguron 24 orë/ditë lehtësi bankare për klientët e saj.

Drejtues të Bankës ndër vite:

Kamariah Mohd SOM

Alias Bin BAHARI

Mohana Dass KRISHNASAMY

Alex Lee CHONG PA

Ooi Kooi KEAT

Rocky TAN

Mahendra Singh RAWAT

Gideon van den BROEK

janar 1996 - shkurt 1998

shkurt 1998 - qershor 2000

korrik 2000 - maj 2001

qershor 2001 - qershor 2004

qershor 2004 - qershor 2006

qershor 2006 - shtator 2006

tetor 2006 - nëntor 2011

nëntor 2011- në vazhdim

BANKA E PARË E INVESTIMEVE

Banka e Parë e Investimeve Shqipëri (Fibank – Albania) është pasardhëse e degës së First Investment Bank, Tirana Branch. Dega ka operuar në tregun shqiptar që prej vitit 1999, duke u specializuar fillimisht në tërheqjen e depozitave dhe në ofrimin e shërbimeve bankare ndaj kompanive bullgare që operonin në tregun shqiptar.



Data Historike:

1999 – First Investment Bank Bullgari hap në Tiranë degën e saj Tirana Branch.

2007 – Fibank liçensohet nga Banka e Shqipërisë si bankë e pavarur shqiptare, bankë bijë e First Investment Bank Bullgari. Po në këtë vit, banka zgjerohet me tre degë të reja në Elbasan, Vlorë dhe Korçë, si dhe prezanton një gamë të gjerë produktesh bankare inovatore për të gjitha grupet e klientëve.

2008 – Rrjeti i degëve shtohet edhe me degë të tjera me qëllimin e prezencës në qytetet kryesore të vendit duke u ofruar produkte e shërbime të dedikuara si klientëve individë edhe bizneseve në këto qytete.

2009 – Fibank pati një rritje prej 200% në investime dhe 160% në depozita ndërkohë që rriti asetet me 77%.

2010 – Rritja në investime arriti në rreth 370%, në depozita 75% dhe në kredi 99%.

2011 – Vazhdojnë rritjet në treguesit kryesorë financiarë në rreth 30% si në depozita edhe në kredidhënie.

Drejtues të Bankës në vite:

Aleksander STOYANOV

dhe Evtim ORMANOV

Evgeni LUKANOV

Petar KRASTEV

Martin BOGDANOV

Svetoslav MOLDOVANSKY

Bozhidar TODOROV

maj 1998 – tetor 1999

tetor 1999 – prill 2002

prill 2002- mars 2005

prill 2005 – mars 2007

prill 2007 – tetor 2007

tetor 2007 dhe në vazhdim

CREDINS BANK

CREDINS Bank është e para Bankë private Shqiptare e cila hyn kështu në historikun e zhvillimeve të rëndësishme ekonomike financiare të ndodhura në Shqipëri. Në vitin e saj të parë Banka ushtron aktivitetin e saj në 1 degë në Tiranë, 2 agjenci në Tiranë dhe Durrës me një personel prej 25 punonjësish duke ofruar një gamë të gjerë produktesh e shërbimesh bankare që nga më tradicionalet deri tek ato më bashkëkohoret. Aktualisht, CREDINS Bank ushtron aktivitetin e vet në 16 qytete të Shqipërisë përmes 47 degëve dhe agjencive të saj.



Data Historike:

- 31 mars 2003** - Banka e Shqipërisë licencon për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë Bankën Credins.
- 2004** - CREDINS Bank ofron shërbimin e Çeqeve të Udhëtarit “American Express”, zgjeron aktivitetin duke çuar në 7 numrin e degëve dhe agjencive, si dhe dyfishon numrin e punonjësve. Në fund të këtij viti banka numëron 12.000 klientë.
- 2006** - Ofrohet shërbimi bankar **Credins Online**, i cili u jep mundësi klientëve të kryejnë veprime nëpërmjet internetit ose celularit, nga llogarite e tyre Bankare dhe njëkohësisht me një siguri maksimale. Në fund të vitit 2006 Banka mbyll aktivitetin me 36.740 klientë, 17 degë dhe 170 punonjës.
- 2008** - CREDINS Bank feston 5 vjetorin e saj si dhe shton 2 aksionerë të rinj: Balkan Financial Sector Equity Holding B.V. (BFSE Holding B.V), Holandë, i përfaqësuar nëpërmjet Development Financial Equity Partners (DFE) si dhe aksioneri tjetër State Secretariat for Economic Affairs (SECO), i përfaqësuar nëpërmjet Swiss Investment Fund for Emerging Markets (SIFEM AG).
- 2009** - CREDINS Bank nënshkruan marrëveshjen e Kredisë me European Fund for South East Europe (EFSE).

tetor 2010 - Banka zgjeron aktivitetin me Liçencën për tregtimin e Arit dhe monedhave të çmuara. Gjatë këtij viti CREDINS Bank nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me Postën Shqiptare si një mundësi e jashtëzakonshme për bashkëpunim reciprok me përfitime të ndërsjella.,

2011 - CREDINS Bank renditet në vendin e tretë në sektorin bankar referuar qarkullimit vjetor, duke e rritur xhiron me rreth 30% ose me 7.6 miliard lekë. Për herë të parë, Credins Bank u jep mundësi të gjithë investitorëve të investojnë në Ar.

2012 -Për herë të parë në Shqipëri, CREDINS Bank hedh treg në kartat e parapaguara Visa. Mbyllet 6 mujori i parë i 2012 me një fitim prej 1.47 miliard lekë neto. Rrjeti zgjerohet duke çuar në 47 nr. e degëve dhe agjencie dhe 182 000 numrin e klientëve.

Drejtues të bankës ndër vite:

Artan SANTO

mars 2003 dhe në vazhdim

CRÉDIT AGRICOLE

Banka **Crédit Agricole** filloi udhëtimin e saj në vitin 1999 në emrin e Banka Ndërtregtare e Greqisë, si një nga bankat e para private në Shqipëri. Kontributi i saj është i rëndësishëm në dy aspekte kryesore: stabilizimin e tregut të trazuar dhe shumë të varfër financiar, dhe përfshirjen e Shqipërisë në epokën e re të financave ndërkombëtare.

Crédit Agricole Group numëron sot 54 milion klientë dhe 160,000 mijë punonjës.



Data Historike:

1999 – Fillon aktivitetin Banka Ndërtregtare e Greqisë.

2003 – Banka ndryshon emrin e saj në Banka Emporiki – Shqipëri, po ashtu dhe logon, ndërsa bëhet pjesë e Grupit Emporiki Greqi.

2004 – Banka Emporiki – Shqipëri fillon zgjerimin e saj me degë të reja, të cilat mbulojnë 90% të territorit të vendit.

2006 – Grupi francez Crédit Agricole blen 72% të aksioneve të Grupit Emporiki.

2009 – Banka Emporiki Shqipëri feston 10 vjetorin e bankës në Shqipëri, ndërkohë që numëron 23 degë në të gjithë vendin në shërbim të 33,800 klientëve.

2010 – Crédit Agricole Group bëhet zotërues 100% i aksioneve të Grupit Emporiki.

14 qershor 2012 - Crédit Agricole SA njofton firmosjen e kontratës për blerjen e Bankës Emporiki Shqipëri. Tashmë Banka Emporiki Shqipëri është e interguar plotësisht në Grupin Crédit Agricole.

3 shtator 2012 – Banka Emporiki Shqipëri merr zyrtarisht nga Banka e Shqipërisë aprovimin e brandit të ri Crédit Agricole. Brandi i ri përforcon mbështetjen e plotë të Grupit Crédit Agricole ndaj bankës dhe ndaj ekonomisë së vendit.

Drejtues të Bankës në vite:

George CARACOSTAS

nëntor 1999 – qershor 2011

Luc BEISO

korrik 2011 – në vazhdim

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Intesa Sanpaolo Bank Albania lindi në 2008 nga shkrirja e dy bankave shumë të rëndësishme të vendit: Banka Italo-Shqiptare - BIA dhe Banka Amerikane e Shqipërisë – ABA të blera nga Intesa Sanpaolo Group.

BANKA ITALO-SHQIPTARE (BIA)



Data Historike:

16 dhjetor 1992 – Miratohet ligji nr. 7649 datë “Për krijimin e Bankës Italo Shqiptare (BIA)” si shembulli i parë i një “joint-venture” 50% me 50% të krijuar midis Banca di Roma (tashmë Unicredit) dhe Qeverisë Shqiptare (nëpërmjet Banka Kombëtare Tregtare) me një kapital fillestar prej USD 10.000.000.

korrik 1993 - BIA fillon aktivitetin me Degën e Tiranës në Rrugën e Barrikadave me një staf prej 15 vetash nga të cilët 5 të huaj.

1995 - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim blen 20% të aksioneve duke kontribuar në një rritje kapitali me USD 2.500.000.

tetor 1996 – BIA caktohet nga Banka e Shqipërisë për të administruar një hua që Banka Evropiane për Investime i kishte akorduar asaj në shumën 5 milion EUR të destinuar për projekte financiare të realizuara nga njësi publike ose private, ekskluzivisht në sektorin industrial, agro-industrial apo të ngjashme, dhe turizëm.

shtator 1999 – Fillon aktivitetin Dega e Durrësit, dhe përfundon nënshkrimi i dy marrëveshje të rëndësishme: asaj midis BIA dhe BERZH, me objektivin kryesor për të ndihmuar zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; dhe asaj midis BIA dhe DEG- përfaqësuese e Republikës Federale Gjermane dhe Ministrisë së Financave për aplikimin e një fondi kredie qarkulluese (revolving) dhe fondi garancie për projektin “Përmirësimi i biznesit fillon në Shqipëri”.

dhjetor 2002 - Hapet një Degë e re në qytetin e Vlorës, që të lehtësojë e mbështesë klientët në Jug të Shqipërisë. Totali i aktivitetit në fund të vitit 2002 kap shifrën prej 121.5 milionë USD ndërsa numri i punonjësve 71.

10 maj 2006 - Grupi Sanpaolo IMI blen 40% të aksioneve të Ministrisë së Financave dhe 40% të aksioneve tek Capitalia S.p.a, ndërsa 20% të aksioneve vazhdon të zotërojë BERZH. Në të njëjtën datë SIMEST blen 3.94% të aksioneve të Sanpaolo IMI. Nënshkruhet marrëveshja midis Sanpaolo IMI dhe BIA-s për shërbimin e ri “Get money to family” për të mbështetur emigrantët shqiptarë në dërgimin e pagesave drejt familjarëve në Shqipëri.

Drejtues të Bankës ndër vite:

Roberto PANCANI

Giancarlo RIZZOLA

Giovanni BOGANI

Ardian FULLANI

Luigi MASTRAPASQUA

dhjetor 1992 – qershor 1995

shtator 1995 – dhjetor 2000

maj 2001 – prill 2006.

2000 - 2004

maj 2006 – dhjetor 2007

BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË (ABA)



Zyrat qendrore të Bankës Amerikane të Shqipërisë; sot, zyrat qendrore të Bankës Intesa Sanpaolo Albania.

24 shtator 1998 – Hap dyert për klientët shqiptarë Banka Amerikane e Shqipërisë e themeluar nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (FSHAN), një fond privat investimesh i themeluar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara nën Aktin SEED të vitit 1989.

1999 – ABA vendos në funksionim WEBCAS (më pas i njohur si ABAflex), sistem internet banking, i pari i këtij lloji në tregun shqiptar.

janar 2001 – ABA hap degën e saj në Durrës, qyteti port më i rëndësishëm i vendit. Po këtë vit banka nënshkruan marrëveshjen për ndarjen e riskut të kredive për SME në IFC me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në vend.

2003 – Me nënshkrimin e marrëveshjes me kartën Visa, banka fillon instalimin e bankomateve si dhe lëshimin e kartave në kohë rekord falë personalizimit të tyre në vend. ABA zgjeron rrjetin e saj me degë në Elbasan dhe Fier.

qershor 2004 – Me hapjen e degës së saj në Athinë, Greqi, ABA bëhet institucioni i parë bankar shqiptar me degë në një nga vendet e Komunitetit Evropian. Po këtë vit banka nënshkroi një marrëveshje të rëndësishme me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke u ofruar qytetarëve shqiptar me banim në Greqi, mundësinë e pagesës së sigurimeve vullnetare.

2005 – ABA hedh në treg kartat për klientët individë, biznes dhe Gold MasterCard duke trefishuar numrin e përgjithshëm të kartave në përdorim. Po këtë vit, ABA nënshkruan marrëveshje me ATE Bank (Bankën Agrare në Greqi) për të lehtësuar pagesat bankare të shtetasve shqiptar që punojnë në zonat rurale të Greqisë. ABA bëhet bankë kryesuese për shumë kredi të sindikuara në mbështetje të projekteve të mëdha të infrastrukturës duke përfshirë Aeroportin e Tiranës apo Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare.

29 qershor 2007 – Zyrtarizohet marrëveshja me Grupin prestigjioz Intesa Sanpaolo për “Pjesëmarrjen e Intesa Sanpaolo në Bankën Amerikane të Shqipërisë” për shitjen e 80% të aksioneve.

28 shtator 2007 – Asambleja e jashtëzakonshme e Aksionerëve miraton projektplanin e bashkimit me përthithje të Bankës Amerikane të Shqipërisë me Bankën Italo Shqiptare. Duke i shtuar rrjetit të saj 7 degët e BIA-s, ABA e mbylli vitin 2007 me 34 degë, 110,000 klientë dhe 500 punonjës.



Nënshkrimi i marrëveshjes me Grupin Prestigjioz Intesa Sanpaolo, 29 qershor 2007



Hapja e degës së Bankës Amerikane në Athinë, Greqi qershor 2004

28 nëntor 2007 – Aktiviteti i suksesshëm i bankës u kurorëzua me marrjen e cmimit “Banka më e mirë e vitit” nga The Banker në një ceremoni në Londër, UK.

13 tetor 2008 - ABA dhe BIA fillojnë punën si një bankë e vetme nën emrin Intesa Sanpaolo Bank Albania, me një strukturë aksionere që kryesohej nga Intesa Sanpaolo me 79.59% të aksioneve dhe tre pjesëmarrës të tjerë: Fondin Shqiptaro Amerikan të Ndërmarrjeve (11.24%), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (7.78%) dhe SIMEST (1.39%).

2009 – Inicohen projekte të rëndësishme për optimizmin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit. Një ndër to ishte “Ju dëgjojmë 100%”, një program ndërkombëtar i Grupit Intesa Sanpaolo që përfshiu për herë të parë dhe Shqipërinë, dhe që vendos një lidhje të drejtpërdrejtë me klientët.

2011 – Totali i aktiveve të bankës arriti në 8.4 miliard lekë dhe fitimi kapi shifrën më të lartë në vite 2.5 miliardë Lekë. Gjate këtij viti inaugurohet Qendra e trajnimit në Laprakë, dhe Banka përfshihet në “Programin bankar për drejtuesit” një iniciativë e Grupit Intesa Sanpaolo dhe SDA Boconi Shkolla e Menaxhimit në Milano për forcimin e motivimit të talenteve dhe promovimin e tyre në organizatë.

Drejtues të Bankës në vite:

Lorenzo RONCARI

shtator 1998 – dhjetor 2008

Stefano FARABBI

janar 2009 - tetor 2012

Alexander RESCH

tetor 2012 e në vazhdim

PROCREDIT BANK

ProCredit Bank Shqipëri u themelua në vitin 1995 si “Fondacioni për Sipërmarrje, Financë dhe Zhvillim” (FEFAD), ku 100% e kapitalit aksioner sigurohej nga KfW. Fokusi i institucionit ishte të siguronte mundësi financimi për bizneset shqiptare të vogla dhe shumë të vogla. Pavarësisht nga trazirat politike dhe ekonomike në vend, në vitin 1997 FEFAD-i arriti të ketë një performancë financiare të suksesshme dhe morri licencën bankare në vitin 1999, duke u kthyer kështu në FEFAD Bank. Aksionerët themelues të bankës ishin Fondacioni FEFAD, ProCredit Holding (atëherë e njohur si IMI), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), si dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare.



Stafi i FEFAD Bank dhe pamje e një dege të kësaj banke.

Data Historike:

- 1996** - Filluan veprimet e fondacionit Fefad. KfW, në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare dhe pas një studimi të sektorit financiar vendosën të themelojnë një institucion të ri financiar (FEFAD).
- 15 mars 1999** - Liçensohet FEFAD Bank, e cila fillon të operojë si një anëtare e plotë e komunitetit bankar në Shqipëri me degë në Tiranë, Durrës dhe Fier me një numër total prej 62 punonjësish.
- 2000** - Zgjerohet rrjeti me hapjen e degëve të reja në Elbasan dhe Korçë. Banka krijon për herë të parë një mbështetje për agrobiznesin përmes kredisë **për ProAgro**. ProCredit Bank hap degë të reja në Fier dhe Durrës.
- 2003** - Bëhet unifikimi i emrit të bankës nga FEFAD Bank në ProCredit Bank, si pjesë e Grupit ProCredit. ProCredit Bank hap degë të reja në Gjirokastrë dhe Korçë, Lezhë, Pogradec, Vlorë dhe Berat. Emetohet për herë të parë në treg karta e debitit CashTronic..
- 2004** - Banka lançon ProPay (Transfertat brenda rrjetit të bankave ProCredit thjeshtohen në kohë dhe në kosto, duke favorizuar shkëmbimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve).
- 2005** - Banka feston 10 vjetorin duke zgjeruar aktivitetin dhe shtrirjen me degë të reja në Lushnjë dhe Gjirokastrë. ProCredit Bank vlerësohet nga Fitch Ratings me B, duke u bërë banka e parë që vlerësohet në Shqipëri. Vlerësohet gjithashtu edhe nga Finance Central Europe si banka më e mirë në rajon (për treguesit ROE dhe ROI)
- 2006** - Vlerësohet nga Fitch Rating me B+ si dhe Finance Central Europe si banka më e mirë në Shqipëri (për treguesin ROA).
- 2009** - Ofrohet për herë të parë në treg kredia “Eficiencia e Energjise”, një kredi për individët, të cilët dëshirojnë të investojnë në shtëpi duke kursyer më tepër energji dhe duke krijuar ambiente më komode për jetesën e tyre.
- 2011** - Banka ofron **Programin Bankierët e Rinj**, të gjithë kandidatëve profesionistë që kanë përfunduar studimet e larta, me ose pa eksperiencë pune, u ofrohet një periudhë 6 mujore praktike për të mësuar mbi sistemin bankar dhe të zhvillojnë karrierën e tyre si bankierë të përgjegjshëm në Bankën ProCredit.

Drejtues aktual të bankës :

Prej vitit 2011, ProCredit Bank drejtohet nga

Flutura VEIPI

Drejtuese e Bordit Drejtues

Anila DENAJ

Anëtare e Bordit Drejtues

Violeta HAXHILLAZI

Anëtare e Bordit Drejtues

RAIFFEISEN BANK

Banka e filloi aktivitetin e saj si Banka Kursimeve, krijuar në bazë të Ligjit nr 7505, datë 31.07.1991 “Për Bankën e Kursimeve”, si vazhdim i Institutit të Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve.

Me një pozicionim agresiv ndaj tregut bankar të fillimit të viteve '90, arriti që shumë shpejt të ofrojë në treg një gamë të gjerë të produkteve tradicionale bankare si depozita, kredi, sisteme pagesash me brenda dhe jashtë, shërbimet me çeqe, karta krediti, këmbime valutore, etj. Duke patur avantazhin e trashëgimit të një rrjeti shërbimesh bankare në të gjithë vendin, shumë shpejt u bë banka më e madhe në vend për totalin e aseteve dhe numrin e klientëve. Potencialet njerëzore të Bankës së Kursimeve u bënë burimet njerëzore kryesore për bankat private që u krijuan në vitet në vazhdim.

Drejtues të Bankës së Kursimeve në vite:

Edvin LIBOHOVA	gusht 1991- janar 1995
Bedri ÇOLLAKU	janar 1995 – korrik 1997
Artan SANTO	korrik 1997 – shkurt 2001
Edvin LIBOHOVA	shkurt 2001 – shtator 2002
Ardian KAMBERI	shtator 2002 – prill 2004

Sot Raiffeisen Bank Shqipëri disponon rrjetin më të gjerë të degëve prej 103 degësh në të gjithë vendin, 193 Bankomate, 1300 terminale shitjesh (POS) dhe më shumë se 210, 000 Karta Debiti Visa Electron të hedhura në treg. Ndërkohë, më shumë se 126 000 persona marrin pagën e tyre nëpërmjet Raiffeisen Bank. Totali i aseteve të saj është afro 2 miliardë Euro. Raiffeisen Bank Shqipëri është banka më e madhe në vend dhe ofron shërbime të plota që i shërbejnë të gjithë sektorëve të biznesit dhe klientëve individë, me një gamë procesesh, sistemesh dhe infrastrukturë degësh që krahasohen me standardet Evropiane të shekullit 21-te.

Data Historike:

- 2004** – Raiffeisen Zentralbank Osterreich Aktiengesellschaft blen 100% të aksioneve të Bankës së Kursimeve në Shqipëri. Ndryshon emërtimi nga Banka e Kursimeve në Raiffeisen Bank SHA
- 2005** – Raiffeisen Bank hedh në treg kreditë konsumatore, pas rreth 8 vjetësh mosdhënie kredish për individë nga Banka e Kursimeve. Po këtë vit banka hedh në treg rreth 50 mijë karta Visa Electron dhe numëron rreth 50 bankomate në të gjithë Shqipërinë. Raiffeisen Bank nderohet me çmimin “Banka më e Mirë” në Shqipëri nga Global Finance.
- 2006** – Raiffeisen International hap degën e saj të 3000-të, Raiffeisen Bank hap degën e saj të 95-të në Shqipëri. Raiffeisen Bank nderohet me çmimin “Banka më e Mirë” në Shqipëri nga Euromoney dhe Global Finance.
- 2007** – Raiffeisen Bank nderohet përsëri me çmimin “Banka më e Mirë” në Shqipëri nga Euromoney. Banka fillon të hapë degët e saj për klientët edhe ditën e shtunë, dhe po këtë vit nënshkruan një marrëveshje financimi me EFSE dhe PSHM për mikrokreditë.
- 2009** – Raiffeisen Bank feston 5 vjetorin e aktivitetit të saj në Shqipëri. Këtë vit, ndër iniciativat



Nënshkrimi i Marrëveshjes me KfW



Ceremonia e hedhjes në treg të Të Fondit të Parë të Investimeve, Raiffeisen Prestigj, 2012

e tjera, banka nënshkruan një marrëveshje me KfW për mbështetje në financimin e Hidrocentraleve të vegjël në Shqipëri.

2010 – Raiffeisen Bank vazhdon të përshtatë teknologji të reja në ofrimin e shërbimeve bankare. Raiffeisen Bank prezanton shërbimin më të ri Raiffeisen Direkt/Internet banking për klientët individë, i cili mundëson aksesin në shërbimet bankare nëpërmjet internetit.

dhjetor 2011 – Raiffeisen Bank nderohet me Çmimin e Filantropisë për kontributin e dhënë në mbështetje të zhvillimit të arsimit dhe kulturës. Po këtë vit banka prezanton shërbimin më të ri të bankngut elektronik – Mobile Banking. Gjithashtu, për të shtatin vit radhazi, Euromoney ka zgjedhur Raiffeisen Bank në Shqipëri si “Banka më e Mirë” në vend.

shkurt 2012 - Raiffeisen Bank prezanton Raiffeisen Invest, kompaninë e parë në Shqipëri për menaxhimin e aseteve të licencuar nga Autoritetit i Mbikëqyrjes Financiare si dhe hedhjen në treg të Fondit të Parë të Investimeve që quhet Raiffeisen Prestigj, i cili i jep mundësinë të gjithë klientëve të investojnë në letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare.

Drejtues të Raiffeisen Bank në vite:

Steven GRUNERUD

prill 2004 – janar 2008

Oliver J. WHITTLE

shkurt 2008 – tetor 2010

Christian CANACARIS

tetor 2010 – në vazhdim

SOCIÉTÉ GÉNÉRALE ALBANIA

Banka fillon aktivitetin si Banka Popullore, krijuar me kapital 100 % privat shqiptar, me aksionerë disa nga bizneset më të spikatura në vend. Me mbështetjen e aksionerëve dhe e menaxhuar profesionalisht, Banka Popullore ofroi menjëherë në treg një gamë shërbimesh konkurruese. Société Générale Group bleu në korrik 2007 shumicën e aksioneve të Bankës Popullore duke e kthyer atë në anëtare të një prej grupeve më të famshëm në botë. Société Générale Albania ka rritur prezencën e saj duke zgjeruar rrjetin e degëve të saj në të gjithë Shqipërinë, dhe duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh kombëtare dhe ndërkombëtare për të gjitha kategoritë e klientëve.



Data Historike:

16 shkurt 2004 – Banka Popullore merr licencën nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarive bankare.

1 mars 2004 – Banka Popullore fillon veprimtarinë e saj për klientët

2004 – 2006 – Gjatë 3 viteve të para të veprimtarisë së saj banka pati një dinamikë rritje të pashembullt. Me një rrjet prej 30 degësh ajo u bë shpejt faktor i rëndësishëm në tregun bankar shqiptar, çka influenoi edhe në tërheqjen e vëmendjes së investitorëve të huaj (OTP-Hungari, NLB-Slloveni, Société Générale – Francë, etj.).

18 korrik 2007 – Përmbillet procesi i blerjes së 75 % + 1 aksione të bankës nga Société Générale Group dhe banka në vazhdim do të quhet Banka Popullore – Société Générale Group.

2008 – Banka Societe Generale Albania zgjeron aktivitetin e saj duke hapur degë të reja në: Golem, Peshkopi, Tiranë, Ersekë, Roskovec.



Dega e Bankës Popullore, Elbasan.



Ceremonia e shitjes së Bankës Popullore tek Société Générale Group, 18 korrik 2007, Tiranë.

2010 - Për herë të parë, në historinë e Bankës Societe Generale Albania, punonjësit e saj u profilizuan si Bankierët Personal të klientëve të tyre. Po gjatë këtij viti banka u zgjerua me 23% rritje të portofolit të kredisë për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe Korporatat, dhe 138% rritje të portofolit të depozitave për të njëjtin segment.

korrik 2010 - Grupi Societe Generale vlerësohet me çmimin “Banka më e Mirë” në Evropën Qendrore dhe Lindore, në Çmimin e Përsosmërisë të prestigjiozes Euromoney

4 gusht 2010 – Banka e Shqipërisë aprovon ndryshimin e emrit të bankës nga Banka Popullore Sh.a në Banka Societe Generale Albania sh.a.

2012 – Banka ka 43 degë dhe 391 punonjës që i shërbejnë 128.000 klientëve në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë.

Drejtues të Bankës në vite:

Edvin LIBOHOVA

shkurt 2004-korrik 2007

Henri Maus de ROLLEY

korrik 2007- shtator 2009

Hubert de SAINT JEAN

shtator 2009 - në vazhdim

TIRANA BANK

Tirana Bank është banka e parë me kapital tërësisht privat në Shqipëri. Ajo u themelua me 1996 dhe gjatë kësaj periudhe ka patur një zhvillim të madh, duke shtrirë degët e saj në të gjithë Shqipërinë. Pas 16 vjetësh në tregun shqiptar, ajo është konsoliduar, duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh.

Tirana Bank është anëtare e Piraeus Bank Group dhe operon në bashkërendim me objektivat dhe synimet e Grupit. Ajo vazhdon të rritet dhe zgjerohet, por ruan me rigorozitet filozofinë e saj për të qenë pararojë në ofrimin e produkteve të reja bankare në Shqipëri.



Data Historike:

1996 – Tirana Bank liçensohet dhe bëhet banka e parë private në vend.

1997 – Viti i themelimit zyrtar.

1999 – Banka prezanton shërbimet e blerjes me kartën VISA si dhe arrin rezultatet e para pozitive financiare.

2000 - Tirana Bank hap degë të reja në Gjirokastrë dhe Korçë, përveç atyre të hapura më parë në Fier dhe Durrës.

2001 – Banka ndërmerr një rritje të vullshme duke zgjeruar aktivitetin e saj dhe duke trefishuar vlerën e aktiveve të saj në krahasim me vitin 1997.

2002 – Tirana Bank emeton kartën e parë të kreditit VISA. Gjatë këtij viti zgjerohet ndjeshëm edhe rrjeti i bankës.

2004 – Hapen shtatë degëve të tjera, rrjeti i Tirana Bank arrin në 22 degë, duke u bërë Banka me rrjetin e dytë më të madh në vend.

2006 – Rriten në mënyrë të ndjeshme si shërbimet për biznesin e madh ashtu edhe për klientët e vegjël, shoqëruar me prezantimin e produkteve të reja. Rrjeti arrin në 36 degë, bankomate të vendosura janë 43, ndërsa banka numëron 377 punonjës.

2009 – Banka i nënshtrohet një riorganizimi të plotë, me fokus te klienti dhe biznesi. Hapen tri degë të reja, ndërsa rinovohen 22 degë ekzistuese. Fitimet arrijnë në 13.2 milionë euro, pavarësisht krizës. **2011** – Rrjeti është zgjeruar tashmë në 56 degë pavarësisht shfaqjes së shenjave të para të krizës në tregun lokal, e cila sigurisht që sjell zhvendosje të prioriteteve. Fokusi përqendrohet në forcimin e kapitalit dhe ndjekjen e një linje korrekte dhe efektive menaxhimi të likuiditeteve.

Drejtues të Bankës në vite:

Viron PITSILIDIS	nëntor 1995 – prill 1998
Dimitris KARAVIAS	prill 1998 – tetor 2004
Dimitris FRANGETIS	tetor 2004 – maj 2008
Bedri ÇOLLAKU	maj 2008 – shkurt 2009
Dimitris SANTIXIS	shkurt 2009 – mars 2011
Georgios CHARALAMPAKIS	mars 2011 – tetor 2012
Savvas THALASSINOS	tetor 2012 e në vazhdim

UNION BANK

Union Bank, u themelua si një bankë private me kapital 100% shqiptar dhe lindi nga njëri prej Institucioneve më të suksesshëm të sistemit financiar shqiptar - Unioni Financiar Tiranë sh.p.k. përfaqësues i Western Union Financial Services Inc. për Shqipërinë, Kosovën e Maqedoninë.

Vlerat dhe përvoja pozitive që UFT përçoi tek klientët e tij, bënë të mundur që Union Bank në një kohë mjaft të shkurtër të zgjeronte rrjetin e degëve në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke hapur 31 degë të reja në 3 vjet



Data Historike:

9 janar 2006 - Union Bank merr licencën për ushtrimin e aktiviteteve bankare dhe që në vitin e parë të aktivitetit fillon lëvrimin e spektrit të plotë të produkteve bankare: depozita, kredi, transfertat, pagesa, karta U-Card, etj. dhe zgjeron rrjetin me 7 degë në qytetet e Tiranës, Durrës, Elbasan, Fushe Kruje, dhe Fier.

2008 - Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) bëhet aksionere duke blerë 12.5% të aksioneve të Union Bank. Këtë vit banka hedh në treg kartën Maestro dhe MasterCard dhe shërbimin e internet banking "UB Online", si dhe zgjeron rrjetin duke shtuar 6 degë të reja.

2009 - Union Bank nis zbatimin e Planit për Zhvillimin Institucional - një program 2-vjecar i asistencës teknike të EBRD me synim forcimin e kapaciteteve organizative të Union Bank. Me hapjen e degëve në Kavajë dhe Vlorë dhe dy degëve të reja në Tiranë, numri i degëve arrin në 30. Pas mbylljes së tre viteve të investimit dhe zgjerimit të aktivitetit, Union Bank e mbyll vitin me fitim.



Ceremoni e blerjes së aksioneve nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

2010 - Union Bank aktivizon marrëveshjen për linjën e kreditit me EBRD për mbështetjen e SME-ve, si dhe përmbyll procesin e strukturimit të ri organizativ, duke u orientuar njëkohësisht drejt forcimit të rritjes së bankës në treg edhe drejt kontrollit më të mirë të riskut. Këtë vit Union Bank bëhet Sponsor Zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit për sezonin 2010-2012.

2012 - Union Bank, investon në platformën CHIP për kartat Maestro dhe MasterCard si dhe hedh në treg produktin e ri mobile banking “UB-Mobile”. Banka rinovon me Federatën Shqiptare të Futbollit (FSHF) marrëveshjen e sponsorizimit të Kombëtares Shqiptare të Futbollit, si Sponsor Zyrtar i Kombëtares edhe për sezonin e ri 2012-2014 të vlefshme për ndeshjet kualifikuese “Kupa e botës – Brazil 2014.

Drejtues të Bankës në vite:

Z. Gazmend KADRIU

janar 2005 e në vazhdim

VENETO BANKA

Në vitin 2005 Banca Popolare Pugliese së bashku me familjen Mariano nga Lecce (Itali), blejnë aksionet e bankës “Dardania Bank”. Banka merr emrin Banca Italiana di Sviluppo (Banka Italiane e Zhvillimit ose BIS Banca), një bankë që do të shërbente si urë bashkëpunimi mes biznesit Italian dhe atij shqiptar.

Blerja e bankës nga Grupi Veneto Banka solli dyfishimin e prezencës së saj me filiale si edhe pesëfishimin e kapitalit. Sot Veneto Banka i shërben klientëve të saj me 12 filiale dhe një rrjet prej 13 ATM-sh në qytetet kryesore të vendit.



Data Historike:

- 2005** - Banka ka një rrjet modest prej 2 filialesh, dhe implementon shërbimin e kartave lokale BIS Banca, për tërheqjen e parave cash nga ATM-të e vendosura nga banka, e dedikuar vetëm për klientët e saj.
- 2007** – BIS zgjeron rrjetin e saj me dy filiale të tjerë, përkatësisht atë të Vlorës dhe Durrësit, si dhe investon për Internet Banking, për t’u ardhur në ndihmë klientëve të kryejnë operacione online nëpërmjet internetit.
- 2008** - Banka vazhdon zgjerimin e rrjetit të filialeve kryesisht në Shqipërinë Perëndimore, 2009 - Banca Popolare Pugliese dhe Familja Mariano vendosin një akord shitjeje me Gruppo Veneto Banca (Trevizo – Itali), në atë kohë një grup ambicioz që kërkonte zgjerimin e rrjetit të tij. Grupi kontrollonte rreth 4 banka në Itali dhe 3 banka në Evropën Lindore, si në Rumani Banca Italo-Romena, në Moldavi Eximbanka dhe në Kroaci Veneto Banka d.d., si dhe kishte disa zyra përfaqësimi si në Irlandë dhe në Kinë.

- 2009** - Zyrtarizohet edhe ndryshimi emrit të bankës nga Banca Italiana e Zhvillimit (BIS Banca), në Veneto Banka Albania, ku Gruppo Veneto Banca zotëron 95% të aksioneve. Rrjetit të filialeve në Shqipëri i shtohet edhe filiali i ri i Shkodrës.
- 2010** – Banka prezanton shërbimin VISA për kartat e debitit dhe të kreditit për klientët e Veneto Banka, si dhe investon në “adoptimin” me këtë sistem duke unifikuar të gjithë ATM-të aktualë si dhe blerjen e ATM-ve të tjera. Po këtë vit implementohet sistemi i ri E-banking.
- 2011**- Grupi Veneto Banka autorizon fillimin e projektit të zgjerimit të rrjetit edhe me dy filiale të tjera të reja. Përurohen filialet e Lezhës dhe filiali i Kavajës.
- 2012** - Veneto Banka zgjeron aktivitetin e saj me tre filiale të tjerë, dy prej të cilëve në Tiranë dhe rezulton prej tre vjetësh një nga bankat me rritje më të madhe të aktiveve në sistem.

Drejtuesi aktual i Bankës :

Dr. Lucio GAITA

2011 e në vazhdim

BIBLIOGRAFI

- Albert Calmes, “*La situation economique et financiere de l’ Albanie*”, Genève, September, 1922
- Alessandro Roselli, “*Italy and Albania : Financial Relations in the Fascist Period*”, I.B.Tauris & Co.Ltd, London, 2006
- Aradian Civici, “*Bankat qendrore, fajtores për krizën? Kur u themeluan, çfarë funksionesh kanë dhe në ç’mënyrë drejtojnë financat e një vendi?, Çfarë roli kanë luajtur dhe luajnë në situatën ekonomike globale?*”, artikull - Gazeta “*Shqip*”, 22 maj 2008.
- Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, “*Studim për veprimtarinë e Bankës Kombëtare të Shqipërisë*”, Fondi IARA, D. Nr. 17, 1947
- Banka e Shqipërisë, “*Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri*”, Tiranë, 2003
- Banka e Shqipërisë, *Raportet Vjetore 1993 – 2011*, publikime të Bankës së Shqipërisë
- Banka e Shqipërisë, *Ligje, Rregullore dhe Udhëzime*, vitet 1993 - 2011
- Bernd J. Fischer, “*Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*”, Çabej MÇM, 1996
- Chris Jarvis, “*The Rise and Fall of the Pyramid Schemes in Albania*”, IMF Staff Papers, Vol. 47, No. 1, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Washington, 2000
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të shtetit, “*Ismail Qemali, përmbledhje dokumentesh (1888-1919)*”, Tiranë, 1982
- Elona Dushku, “*Zhvillimi financiar dhe rritja ekonomike: Rasti i Shqipërisë*”, Banka e Shqipërisë, Tiranë, 2009
- Giuseppe di Nardi, “*Le finanze pubbliche dell’ Albania*”, në librin “*Principi di economia albanese*”, Padova, 1941
- Haxhi Shkoza, “*Financat e Shqipërisë (1839-1934)*”, Tiranë, 1935
- Iljaz Fishta, “*Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri (1925-1944)*”, botim i Universitetit të Tiranës, Tiranë, 1971
- Iljaz Fishta, “*Ndërhyrja e kapitalit të huaj dhe pasojat e saj skllavëruese për Shqipërinë (1925-1931)*”, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1979
- Iljaz Fishta dhe Mihal Ziu, “*Historia e Ekonomisë së Shqipërisë, 1944-1960*”, Shtëpia Botuese “Dita”, Tiranë, 2004
- Indro Montanelli, “*Shqipëria një dhe njëmijë, Homeri ka qënë në Shkodër*”, Shtëpia Botuese Letrat, Tiranë, 2004

- Kostaq Postoli, “*Sistemi bankar në Shqipëri*”, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1983
- Kristo Frashëri, “*Monedha, krediti dhe banka në Shqipëri gjatë shekujve*” botimi Toena, Tiranë, 2011
- M.H.H. McCartney dhe P. Cremona, “*Italy’s Foreign and Colonial Policy*, Oxford University Press, London, 1928
- Orhan Zarshati, “*Historiku i Bankës Kombëtare Tregtare – BKT*”, Banka Kombëtare Tregtare, 2011
- Pietro Pastorelli, “*Italia e Albania (1924-1927)*”, Firenze, 1967
- Sejfi Vllamasi, “*Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897-1942, (Kujtime dhe vlerësime historike)*, Tiranë 1995
- Suzana Sheqeri, “*Tronditjet e sistemit bankar shqiptar dhe politikat e Bankës së Shqipërisë*”, Banka e Shqipërisë, Material diskutimi, Nr. 2(13) 03, 2003
- Shkëlqim Cani dhe Ilir Vika, “*Kriza e konfidencës – Shkaqet prapa hemorragjisë së depozitave bankare*”, Banka e Shqipërisë, Tiranë, Korrik 2002
- Shoqata Shqiptare e Bankave, *Raporti Vjetor 2011*, AAB, Tiranë 2012
- Veniamin Toçi, “*Ndërhyrja e kapitalit të huaj në Shqipëri dhe qëndrimi i qarqeve demokratike (1921-1925)*”, Instituti i Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1974
- Zhivko Avramovski, “*Italijanska ekonomska penetracija v Albaniju 1925 do 1939 godina*”, në Istorija XX veka, publikim i Departamenti i Shkencave historike, Instituti për Historinë Bashkëkohore, Beograd, 1963